



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT
DHE UJIT

MIRATOHET

KRYETAR I K.K.T.U-së
Z. EDI RAMA

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGIJËS

Zni. BEJNIDA BALLUKU

Kryetar i Këshillit Bashkiak
Z. ARBEN GUMENI

Miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak
Nr. 60 Datë 31.10.2024

Kryetar i Bashkisë
Z. TËRMET PEÇI

PLANI I PËRGJITHSHËM VENDOR I BASHKISË TEPELENË
STRATEGJIA TERRITORIALE

Miratuar me Vendim të Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit
Nr. 52 , Datë 24.12.2024

Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit: Z. LORENC BAMI

STUDIO KONSULENTË: B.O.E "ARCHISPACE sh.p.k." & "Sferastudio sh.p.k" & "A&I Design sh.p.k"
Përfaqësuesi B.O.E ligjor



REF: Kontrate Nr. 10490/5 date 27.09.2018

TABELA E PËRMBAJTJES

1. STRATEGJIA TERRITORIALE	5
1.1. Qëllimi i Strategjisë Territoriale.....	5
1.2 Baza për hartimin e Strategjisë Territoriale	6
1.2.1 Parashikimet që rrjedhin nga Plani i Përgjithshëm Kombëtar.....	6
1.2.2. Parashikimet që rrjedhin nga Plani i Integruar Ndër-Sektorial.....	11
1.2.3. Parashikimet qe rrjedhin nga Strategjia Sektoriale e Transportit 2016-2020 dhe Plani i Veprimeve .	11
1.2.4. Parashikimet qe rrjedhin nga Strategjia Kombetare te Energjise 2018-2030	14
1.2.5. Parashikimet qe rrjedhin nga Strategjia Kombetare e Menaxhimit te Mbetjeve	16
1.2.6. Parashikimet qe rrjedhin nga Strategjia Kombëtare e Sektorit te Furnizimit me Ujë dhe Kanalizime	21
1.2.7. Parashikimet qe rrjedhin nga Strategjia Kombëtare të Menaxhimit të Integruar të Burimeve Ujore, 2018–2027.....	24
1.2.8. Parashikimet qe rrjedhin nga Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015-2020.....	27
1.2.9. Parashikimet qe rrjedhin nga Strategjia Kombëtare Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore 2015-2020	33
1.2.10. Parashikimet qe rrjedhin nga Strategjia Ndersektoriale e Mjedisit 2015-2020.....	35
1.2.11. Parashikimet qe rrjedhin nga Strategjia Kombëtare e Turizmit 2019 – 2023.....	39
1.3. Permbledhje e Analizës së përgjithshme të territorit	42
1.3.1. Bashkia Tepelenë – të dhëna të përgjithshme	42
1.3.2. Karakteristikat kryesore natyrore te Bashkise Tepelenë.....	43
1.3.3. Karakteristika te zhvillimit urban te Bashkisë Tepelenë	49
1.3.4. Shërbimet dhe Infrastrukturat.....	54
1.3.5. Degjesa Publike	59
1.4. Analiza SWOT Bashkia Tepelenë	63
1.4.1. Pikat e forta	63
1.4.2. Dobësitë	63
1.4.3. Mundësitë.....	64
1.4.4. Rreziqet	64
1.5. Vizioni dhe Strategjia e zhvillimit të territorit	65
1.5.1 Vizioni i zhvillimit të territorit.....	65
1.5.2. Prognoza demografike	66
1.5.3. Propozime per Sistemin Urban.....	67
1.5.4. Propozimet per Sistemin Natyror	69
1.5.5. Propozime për Sistemin Bujqësor.....	70
1.5.6. Propozim për Sistemin Ujor.....	71
1.5.7. Propozime për Sistemin Infrastrukturor	73
1.5.8. Propozimet per shërbimet	75
1.6. Drejtimet kryesore strategjike të zhvillimit të Bashkisë Tepelenë.....	76
1.6.1. Drejtimi Strategjik 1 - Kualifikimi i parametrave territorialë të Bashkisë Tepelenë në funksion të orientimit të rritjes urbane dhe levizjeve demografike në të ardhmen;	76
1.6.2. Drejtimi Strategjik 2 - Zhvillimi Ekonomik i Bashkisë Tepelenë nëpërmjet shfrytëzimit në mënyrë efektive te kapaciteteve dhe potencialeve ekzistues të kesaj Njesie Vendore;.....	80
1.6.3. Drejtimi Strategjik 3 - Përmirësimi i rrjeteve te infrastrukturave dhe shërbimeve në mbështetje te transformimeve strategjike territoriale:.....	91
1.7. Konvertimi i Sistemeve Territoriale.....	100
1.8. Skedat e Projekteve Pilot	103
1.9. Plani i Veprimit Për Zbatimin e Strategjisë	133



TABELA E FIGURAVE

Fig. 1 - Sistemi Urban – Hierarkia e qendrave urbane dhe nderlidhja hapesinore e zonave funksionale sipas PPK 2030 Burimi:AKPT	8
Fig. 2 - Poli i zhvillimit rajonal Gjirokastër Sarandë,.....	9
Fig. 3 Transporti Rrugor dhe Nyjet Multimodale sipas PPK 2030 Burimi: AKPT	11
Fig. 4-Harta indikative e shtrirjes se rrjetit te transportit ne Rajonin e Ballkanit, sipas TEN-T.....	13
Fig. 5 - Rrjeti i korridoreve rrugore rajonale si dhe i korridoreve hekurudhere	14
Fig. 6 - Skema e hierarkise se mbetjeve	18
Fig. 7 Skema e shperndarjes se Landfilive Rajonale, si dhe pikat potenciale per Landfille te reja..	21
Fig. 8 Shtyllat kryesore te Strategjise Kombetare per Menaxhimin e Integruar te Burimeve Ujore.	27
Fig. 9 Harta Administrative – Bashkia Tepelene	44
Fig. 10 Korridori i lumbit të Bënçës, ku evidentohet reliivi i thyer malor i Bashkise se Tepelenës ...	45
Fig. 11- Harta gjeologo-inxhinierike e bashkise Tepelene.....	46
Fig. 12-Pamje panoramike e lumbit Vjose qe rrjedh ne prane qytetit te Tepelenes	47
Fig. 13 - Harta E Reziqeve Gjeologjike Bashkia TepeleneHarta e Reziqeve Gjeologjike Bashkia Tepelene	48
Fig. 14 -Territore prane fshatit Luzat – reliivi I thyer i territorit te Bashkise krijon mundesine per zhvillimin e ekosistemeve te ndryshme natyrore	49
Fig. 15 -Pamje ajrore me dron e qytetit te Tepelenes	51
Fig. 16 - Pamje e rivitalizimit te qendres se fshatit Nivice, ne kuader te projektit “100 fshatrat”.....	51
Fig. 17 -Hyrja lindore e Kalase se Ali Pashe Tepelenes	52
Fig. 18 - Pamje ajrore e fabrikes se prodhimit te ujit te ambalazhuar “Tepelena”	54
Fig. 19 -Pamje te pikes se depozitimit te mbetjeve ne verilindje te qytetit te Tepelenes, prane lumbit te Vjosës	55
Fig. 20 - Akset kryesore rrugore te Bashkise Tepelene	56
Fig. 21 -Ruga Kombëtare Interurbane Kombetare Levan – Tepelene - Gjirokaster	57
Fig. 22Aksi rruge Dukaj – Salari - Dhëmblan.....	58
Fig. 23 -Spitali i qytetit “Përparim Tepelena“.....	58
Fig. 24 -Pamje e ujesjellesit te Bençës, struktura me e vjeter e furnizimit me uje ne Bashkine Tepelene.....	59
Fig. 25 -Harte e Vizionit te zhvillimit te Bashkise Tepelene	67
Fig. 26 -Skema e riorganizimit sipas prognозes demografike te Bashkise Tepelene	69
Fig. 27 - Zona veriore e qytetit te Tepelenes, e cila do te akomodoje rritjen e qytetit per periudhen 15 vjeçare te Planit	70
Fig. 28 -Njolla e Gjelber – Propozime per Ndryshim	71
Fig. 29 -Siperfaqe buqesore perballe fshatit Turan, Bashkia Tepelene.....	72
Fig. 30 -Foto e lumbit Drinos, prane ures se Leklit, si korridor me vlera panoramike dhe turistike ...	73
Fig. 31 -Skeme e propozuar e integrimit te zones veriore, me strukturen ekzistuese te qytetit te Tepelenës.....	75
Fig. 32 -Skeme grafike e sistemeve te propozuara te filtrimit te ujerave ne zonat rurale	76
Fig. 33 -Skeme propozim per riorganizimin e strukturave arsimore ne Bashkine Tepelene.....	77
Fig. 34 -Pamje e pllajes se Kurveleshit	79
Fig. 35 -Pamje e fushes ne veri te qytetit te Tepelenes, e cila propozohet qe te akomodoje rritjen urbane kryesore te Bashkise ne 15 vitet ne vazhdim	80
Fig. 36 -Pamje e zones se propozuar per ndertimin e thertores se re – zona eshte e pozicionuar per gjate rruges Tepelene – Dukaj – Salari, ne krah te ures se Veliqotit	82
Fig. 37 -Brezi ujor per gjate Drinosit, prane ures se Leklit, i pershtatshme per ngritjen e vaskave per kultivimin e troftes	84
Fig. 38 - Pamje e rezervuarit te Turanit, me kapacetet per ujitjen e te gjitha territoreve buqesore per gjate perroit te Turanit	85
Fig. 39 -Pamje e kalasë se Tepelenes, ne qendër te qytetit	86
Fig. 40 -Pamje ballore e muzeut të qytetit të Tepelenës të propozuar për ristrukturim.....	86
Fig. 41 -Pamje e gjendjes se shkaterruar te shtepise se Selam Musait ne fshatin Salari	87
Fig. 42 -Pamje e gjendjes ekzistues te qendres se fshatit Dukaj	88
Fig. 43 -Pamje e gjendjes ekzistues te fshatit Matohasanaj – Njësia Administrative Lopës	88
Fig. 44 -Pamje te hapesirave te brendshme te fshatit Beçisht	89




Fig. 45 -Pamje e lagjes se poshtme të fshatit Dhemblan, pjese e itinerarit turistik Tepelene - Lopës	90
Fig. 46 -Pamje e kanioneve pergjate rruges Bençe - Lekdush	91
Fig. 47 -Paraqitje skematike e itinerarit Teperele – Maja e Fajkoit	91
Fig. 48 -Pamje e ures se Leklit mbi lumin Drinos	93
Fig. 49 -Pamje e ures se paperfunduar mbi lumin Vjose, prane grykes se Kalivaçit.....	94
Fig. 50 -Rrjeti i linjave nderqytetese te Bashkise Tepelene – miratuar nga Ministria e Infrastruktures dhe Energjise	95
Fig. 51 -Pamje e shkollës 9-vjeçare “Selam Musa” ne fshatin Sinanaj në Njësinë Administrative Lopës.	99
Fig. 52 -Pamje e ish qendres shendetesore ne fshatin Dukaj – Njesia Qender	100
Fig. 53 -Harta e Projekteve Strategjike te Zhvillimit te Bashkise Tepelene	100



1. STRATEGJIA TERRITORIALE

1.1. Qëllimi i Strategjisë Territoriale

Qëllimi i hartimit të këtij dokumenti është prezantimi i një vizioni dhe qasje të re strategjike te zhvillimit te ardhshem të Bashkisë Tepelenë, duke marrë në konsideratë mangësitë, problematikat, kufizimet si dhe potencialet qe disponon kjo njësi vendore, me synimin final mire-administrimin e territorit, përmirësimin e shërbimeve dhe infrastrukturave si dhe promovimin e zhvillimit ekonomik, social dhe kulturor.

Për përbushjen sa më te mire te këtij qëllimi strategjik evidentohet si domosdoshmeri përcaktimi i objektivave te qarte te zhvillimit, nëpërmjet perdonimit sa me eficient dhe te qendrueshem të burimeve natyrore te Njesise Vendore. Nderkohe, Vizioni i Zhvillimit te Bashkise Tepelenë duhet të transpozoje në nivel vendor aspiratat e politikave kombëtare mbi dinamikat territoriale, duke promovuar ndërveprime dinamike, te balancuara dhe te koordinuara midis pjesëve të ndryshme të territorit qe administron. Ne pjesen e analizës se per gjithshme të territorit të Bashkisë janë identifikuar shumë problematika që kanë të bëjne pikerisht me integrimin dhe bashkefunksionimin midis qëndres se Bashkise si dhe zonave rurale. Pikerisht, eliminimi i ketyre problematikave eshte edhe filozofia kryesore e propozuar e dokumentit strategjik.

Nga pikëpamja institucionale, Strategjia Territoriale është dokumenti kryesor zyrtar, i cili permbleh te gjithe kuadrin e propozuar rregullator, duke siguruar per çdo komponent udhëzimet dhe principet strategjike për zhvillimet e ardhshëme te Bashkisë Tepelenë. Si i tillë, dokumenti duhet te bazohet ne projekzionet e nevojscheme demografike, ekonomike dhe infrastrukturore deri në vitin 2030, duke marre ne konsiderate permbysjen e trendeve aktuale te renies se popullsise si dhe tejkalimin e veshtiresive per financimin e nderhyrjeve ne infrastructure dhe sherbime.

Strategjia Territoriale do të shoqerohet me Planin e Investimeve, ne te cilin përcaktohen ne menyre te detajuar fazat, prioritetet, përgjegjësitë si dhe treguesit e monitorimit. Paralelisht, ne kete dokument, do te identifikohen çështjet e rëndësisë së veçantë, ku zhvillimi, lloji i investimit apo nderhyrja institucionale nga ana e Bashkise Tepelenë duhet të jetë prioritet. Te gjitha keto projekte prioritare do të koordinohen me propozime specifike mbi investimet e rëndësishme.

Projektet pilote formojnë një aspekt shumë të rëndësishëm të metodologjisë së planifikimit dhe një mjet të vlefshëm në duart e Bashkisë Tepelenë për zbatimin e Strategjisë Territoriale. Ato adresojne investimet e rendesishme publike, te cilat duhet te orientohen me përparësi duke krijuar bazen e nevojshme mbështetetese per zhvillimin e e te gjithe komponenteve te perfshire ne Strategjinë territoriale. Projektet pilot do të ndihmojnë në përcaktimin e mënyrës se si e gjithë kjo do të realizohet. Kjo metodologji tashmë është testuar në kontekstin e iniciativave të fundit në nivel kombëtar dhe mund të aplikohet edhe në nivel vendor.



1.2 Baza për hartimin e Strategjisë Territoriale

1.2.1 Parashikimet që rrjedhin nga Plani i Përgjithshëm Kombëtar

Plani i Përgjithshëm Kombëtar "Shqipëria 2030" përfaqëson harmonizimin e qasjes së integruar të proceseve te zhvillimit urban me sektorë të tjera strategjikë të zhvillimit si turizmi, bujqësia, energjia, transporti, strehimi, ne sherbim te synimit final për zhvillimin e qëndrueshëm dhe afatgjatë të vendit.

Ky dokument themelor është shtylla orientuese e zhvillimit të territorit ne nivel kombetar për 15 vitet e ardhshme, duke vodosur metodologjine dhe treguesit per administrimin dhe kontrollin e tokes mbi parime dhe kritere të qëndrueshme. Plani Kombëtar siguron harmonizim të zhvillimit në të gjithë territorin dhe një mundësi reale të kombinimit të interesave në përputhje me veçoritë e terrenit, lëvizjet demografike, ndryshimet klimatike dhe faktorë të tjera, që ndikojnë zhvillimin e sotëm. Synimi kryesor i dokumentit eshte zhvillimi i balancuar nepermjet promovimit te menaxhimit te përgjegjshëm të burimeve natyrore, mbrojtjes se mjedisit dhe përdorimin racional të tokës.

Vizioni i propozuar nga PPK për Shqipërinë është:

Shqipëria një qendër e integruar në sistemin ekonomik dhe infrastrukturor European, një ekonomi e shumëllojshme dhe konkurente në hapësirën Ballkanike, një shtet që synon barazinë në akses, infrastrukturë, ekonomi dhe dije. Siguron mbrojtje të trashëgimisë natyrore, historike dhe kulturore me synimin për t'u shndërruar në një destinacion autentik.

PPK-ja nxit kohezionin territorial ne nivel kombetar nëpërmjet zhvillimit të balancuar ekonomik dhe social të rajoneve dhe përmirëson konkurrencën midis tyre. Plani promovon:

- Zhvillimin e formave urbane mikse brenda territoreve te banuara si dhe përmirëson marrëdhënien mes zonave urbane dhe zonave rurale,
- Permiresimin e aksesibilitetit midis qendrave si dhe midis zonave periferike me qendrat urbane
- Zvogëlimin e dëmet apo nderhyrjeve jo te balancuara mjedisore si dhe mbrojtjen dhe përforcimin e burimeve natyrore dhe të trashëgimisë kulturore, (referuar Ligjit të ndryshuar, Nr. 27/2018 "Per tashegjime kulturore dhe muzete"),
- Zhvillimin dhe mire-administrimin e trashëgimisë kulturore si faktor I rendesishme zhvillimi
- Zhvillimin dhe diversifikimin e burimeve energetik, duke u fokusuar ne zhvillimine burimeve te rinovueshme,
- Turizmin cilësor dhe të qëndrueshëm;

PPK-ja nxit riorganizimit e sistemit urban kombetar sipas principit te policentrizimit, duke promovuar zhvillimin e rajoneve te forta ekonomike që komunikojnë dhe kanë marredhenie komplementare me njëra-tjetren. Plani propozon klasifikimin e meposhtem te qëndrave urbane ne nivel kombetar:

- I. Metropoli
- II. Qëndra Primare Urbane

- III. Qëndra Sekondare Urbane
- IV. Qëndra Terciare Urbane
- V. Qëndra Lokale
- VI. Lokalitetet.

Bazuar ne kete klasifikim, Bashkia Tepelenë kategorizohet ne rendin hierarkik IV – Qendër Terciare Urbane. Nderkohe, llojet e nderhyrjeve baze ne qendrat urbane sipas klasifikimit te tyre jane:

- Për Metropolin, qëndrat primare urbane: Konsolidim dhe Përforëcim
- **Për Qëndrat Terciare Urbane qëndrore: Përforcim dhe Rigjenerim**
- Për qytetet porta dhe qendrat urbane lindore: Fuqizim dhe Rigjenerim
- Në nivel kombëtar: Kooperim




Fig. 1 - Sistemi Urban – Hierarkia e qendrave urbane dhe nderlidhja hapesinore e zonave funksionale sipas PPK 2030 Burimi: AKPT

Për zhvillimin e Bashkise Tepelenë si Qender Terciare Urbane, PPK identifikon drejtimet si ne vijim:

- fuqizimi ekonomik permes zbatimit te masave dhe nderhyrjeve miqesore ndaj zhvillimit te biznesit si ne fushen bujqesore ashtu edhe ne turizem dhe agroturizem. Ky fuqizim duhet mbeshtetet ne nje transport publik efikas, pa demtuar vlerat e pejsazhit natyror dhe kulturor te zones.
- Rigjenerimi i zonave te urbanizuara me potencial historik por jo vetem, si dhe te hapesirave publike, te shoqeruar me nje kornize te detajuar mbi kodin e ndertimit, i cili duhet te jete lethesht i kuptueshem dhe i implementueshem nga zhvilluesit dhe komuniteti. Rekomandime specifike jepen për llojet e ndryshme të vendbanimeve. Densifikimi mund te arrihet pa komprominentuar cilesine dhe komoditetin e jetes urbane.



- Konservimi i të gjitha parqeve natyrore dhe hapesirave te gjelbra ekzistuese duke nxitur rritjen e numrit si dhe sipërfaqen e gjelber te tyre.
- Vlerësimi i mundesise per rizhvillimin e ish zonave industriale dhe te magazinimit per aktivitete te reja ekonomike, rekreative social - kulturore.

Drejtimet e zhvillimit të Rajonit Jug-Perëndimor




Fig. 2 - Poli i zhvillimit rajonal Gjirokastër - Sarandë,

Ky poli zhvillimi rajonal përbëhet nga 9 bashki dhe 32 njësi administrative. Sipas shifrave të popullsisë nga INSTAT-i, rajoni në vitin 2001 numëronte 120.784 banorë, ndërsa në vitin 2011 numëronte 99.209 banorë, duke pësuar humbje në popullatë me 17.9%. Pozita gjeografike dhe pasuritë e shumta kulturore, natyrore dhe historike që karakterizojnë këtë rajon ekonomik nxjerrin në pah potencialin e lartë të tij për të qenë një rajon denjësish konkurrues për zhvillimin e fushave të ndryshme ekonomike.

Bashkia Tepelene pozicionohet ne menyre te favorshme ne qender te Rajonit, dhe pikerisht ne kryeqezim te akseve te rendesishme te komunikimit, duke krijuar keshtu mundesi shume te mira per mbeshtetjen dhe promovimin e rritjes urbane.

Në mbeshtetje te zhvillimit te Sistemit Bujqesor ne Bashkine Tepelenë, propozimet e PPK-së përfshijnë krijimin e:

- **Strukturave ndërtimore** me kapacitet të mjaftueshëm për grumbullimin, përpunimin dhe paketimin e produkteve të ndryshme bujqësore të grumbulluara nga fermerët vendas.

- Krijimin e **tregjeve lokale** për promovimin dhe tregtimin e produkteve bio- organik,
- Ruajtjen e zonave të thella malore, pyjeve, foragjerëve si dhe të hapësirave të tjera të përshtatshme për kultivimin e Bimeve Aromatike, të cilet kanë përdorim të gjerë në tregun farmaceutik.
- **Qendrave të inovacionit dhe të përpunimit** të produkteve ushqimore me qëllim formimin e pikave/poleve bujqësore në vend, te cilat gjithashtu mund te funksionojë si një nxites për zhvillimin e turizmit bujqësor në vend.

Për **Sistemin Natyror** PPK-ja propozon zgjerimin e përqindjes totale të zonave të mbrojtura në Shqipëri nga 15% në 20% dhe zhvillimin e korridoreve të gjelbra. Në zonën në studim janë parashikuar zhvillimi dhe promovimi mjedor i dy korridoreve natyrore përgjatë lumit të Vjosës dhe të Shushicës. Aktualisht, Plani propozon:

- Rritjen e siperfaçes se zonave të mbrojtura natyrore si dhe krijimin e një sistemi të qëndrueshëm e komunikativ mjedor.
- Marrjen në mbrojtje të Lumit Vjosë dhe zonës përreth saj me statusin e Parkut Kombëtar.
- Shtrirjen e korridoreve natyrore përgjatë luginave të lumenjve dhe ekosistemeve të tyre;
- Promovimin e koncepteve te qëndrueshmërisë dhe administrimit të mirë natyrore;
- Integrimin e sistemit natyrore si një vlerë ekonomike e sektoreve te zhvillimit.
- Promovimin dhe krijimin e aksesit të përshtatshëm ndaj zonave natyrore, duke rritur rolin e mjedisit në cilësinë e jetës urbane

Për Sistemin Ujor, Plani i Përgjithshëm Kombëtar propozon:

- Përcaktimin e Vijës Blu dhe respektimin strikt të saj si kufiri i zonave mbrojtëse të të gjitha burimeve ujore, sipas përcaktimeve të legjisacionit sektorial në fuqi dhe Vendimit Nr 686, date 22.11.2017 "Për Miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit" i ndryshuar.
- Hartimin e Planeve të Menaxhimit për Basenet Shkumbin, Seman dhe Vjosë në përputhje me Strategjinë Sektoriale të Mjedisit.
- Mbulimin e plote me shërbimin e furnizimit me uje dhe kanalizime te ujerave te zesa për zonat turistike si dhe ato suburbane.
- Plotësimi i qëndrueshëm i nevojave për ujë vaditës përmes rehabilitimit dhe modernizimit të sistemeve ujitës.
- Menaxhimi i qëndrueshëm i sistemeve të ujitjes, nëpërmjet ndarjes së kompetencave dhe përgjegjësive për mirëmbajtjen dhe rehabilitimin e infrastrukturës së ujitjes, ndërmjet pushtetit qendor, njësive administrative dhe organizatave të përdorimit të ujit.
- Krijimi i një barazie sociale që të sigurohet qasje e barabartë për të gjithë përdoruesit për një sasi dhe cilësi të nevojshme të ujit, për të plotësuar nevojat dhe mirëqenien e tyre.

Referuar Sistemit Infrastrukturor Plani i Përgjithshëm Kombëtar propozon:

Shqipëria qendër ndërlidhëse e rajonit të Ballkanit me Europën dhe faktor stabiliteti në rajon. Ndërtimin e linjave hekurudhore për të përkrahur lëvizjen ndërqytetase për distanca te largëta dhe lëvizjen ndërkufitare.




Për Infrastrukturën e Transportit:

- Promovimin e transportit publik qytetas dhe i transportit alternativ nëpërmjet infrastrukturës "soft", rrugë për biçikleta e këmbësorë.
- Ndërtimin e linjave hekurudhore për të siguruar lëvizjen ndërqtetase
- Mundësimi me lidhje hekurudhore i kufirit me Greqinë si një pikë hyrëse për korridorin hekurudhor ballkanik Jug-Veri.Kjo linje do kaloj dhe nga qyteti i Tepelenes dhe me tutje do te vazhdoj per te krijuar itenerarin e transportit hekurudhor Selanik-Podgoricë dhe më tej.
- Për të gjitha qendrat sekondare të parashikohet një rrjet transporti, që mundëson lidhjen e shpejtë të këtyre qendrave me qendrën primare urbane, e cila është edhe qendra që ofron shërbime publike të specializuara.
- Vendosjen e një rrjeti të integruar të transportit publik që mbështetet nga infrastruktura e terminaleve multimodale në qendrat urbane kryesore lidhëse;

Per Infrastrukturën Energitike:

- Reduktimi i emetimeve të ndotësve (CO₂) nëpërmjet investimeve në teknologji, inovacion dhe ngritje kapacitetesh (targeti i Europës për vitin 2030 është reduktimi i emetimeve deri në 60% për transportin në përgjithësi).
- Nxitja për përdorimin e teknologjive të reja në transport dhe burimeve të energjisë miqësore ndaj mjedisit, si p.sh. përdorimi i elektricitetit, hidrogenit dhe teknologjive hibride për distanca të largëta të transportit të mallrave dhe më gjerë.
- Energjia Diellore eshtë rezerva natyrore më e madhe e energjisë, e cila është e shpërndarë kudo në botë në sasi më të mëdha sesa nevojat tona për energji, është e pastër, nuk kërkon shpenzime të tjera dhe nuk paraqet asnjë rrezik për ndotjen e mjedisit dhe zona ne sdudim I ka te gjitha kushtet natyrore per ta mundesuar shfrytezimin e kesaj energjie.



1.2.2. Parashikimet që rrjedhin nga Plani i Integruar Ndër-Sektorial

Përgatitur gjatë periudhës Shtator 2014 - Janar 2015, PINS prezantohet si kushtetuta e zhvillimit rajonal ne Shqiperi, duke përforcuar tiparet e turizmit sipas karakteristikave lokale të zonave specifike, zhvillimin e bujqësisë, fuqizimin e sipërmarrjeve lokale, fuqizimin dhe diversifikimin e shërbimeve të tyre. Keto nderhyrje synojne që qendrat lokale dhe lokalitetet brenda qyteteve terciare të rrisin rëndësinë e tyre me fokus investimet lokale, zhvillimin e aktiviteteve ekonomike dhe strehimin.

Gjatë hartimit të këtij Plani janë mbajtur parasysh të gjitha sugjerimet dhe parimet bazë të zhvillimit të përcaktuara ne PPK, si dhe në dokumentat e tjera strategjike si planet e menaxhimit të zonave te mbrojtura ekzistuese, duke synuar në mënyrë të veçantë:

- Harmonizimin e vizonit afat-gjatë me strategjitë e zhvillimit rajonal dhe vendor.
- Reduktimin e zhvillimit disproporcional, duke gjallëruar dhe përfshirë në burimet e rritjes, zonat e urbane por edhe zonat rurale.
- Vendosjen e një raporti më të mirë midis kërkesave për investime individuale dhe biznesi me territorin, pasuritë historike, thesaret kulturore, zonat natyrore të mbrojtura.

Duke u bazuar në kërkesat për rritje të punësimit dhe zhvillimit të sektorëve drejt një ekonomie e cila nuk konsumon apo degradon territorin, dokumenti strategjik sugjeron një qasje të politikave integruese që nxisin bashkëpunimin mes sektorit të shërbimeve, atij bujqësor, turistik e energetik, si edhe nxitjen për risi dhe kooperim e specializim të tyre. Shpërhapja urbane, lëvizja e popullsisë nga lindja drejt perëndimit, ndryshimet e thella hapësinore në strukturën e sektorëve ekonomikë kryesorë të vendit, industri, turizëm, bujqësi, etj., kanë ndikuar në ndryshimin thelbësor të peizazhit natyror, historik, kulturor dhe urban të rajonit.

Per territorin e Bashkise Tepelene nuk eshte hartuar një Plan i Integruar Ndër-Sektorial, por eshte ende ne një faze konceptimi plani per Parkun Rajonal te Vjosës.

1.2.3. Parashikimet qe rrjedhin nga Strategjia Sektoriale e Transportit 2016-2020 dhe Plani i Veprimeve

Strategjia Sektoriale e Transportit bazohet ne Paketën e Projekteve Prioritare për sektorin e Transportit, prioritet i rendesishem i Qeverise Shqiptare. Objktivi kryesor i këtij dokumenti strategjik eshte zhvillimi i rrjetit kombëtar të transportit duke përmirësuar ndërveprimin, qëndrueshmërinë dhe integrimin e tij me sistemin rajonal dhe europian të transportit. Ne kete dokument trajtohen 43 politika specifike per transportin per zbatim deri ne vitin 2022

Dokumenti qe bazohet Strategjia Sektoriale e Transportit ne Shqiperia eshte TEN-T –Rrjeti Trans-European i Transportit. Ai ka identifikuar 9 korridore transporti trans-europianë, nga të cilat 3 zgjaten nëpër Ballkan dhe 2 prej tyre në Shqipëri, konkretisht korridoret "Med" dhe "Orient/East Med". Sipas TEN-T, një paketë e tillë gjithëpërfshirëse investimesh në infrastrukturë do të mund të sigurojë një rritje ekonomike me të paktën një pikë përqindje ne



vit për vendet e rajonit për një periudhë prej 15 vjetësh, ndërsa do të krijojë mundësinë e hapjes së 200,000 vende të reja pune.



Fig. 4-Harta indikative e shtrirjes se rrjetit te transportit ne Rajonin e Ballkanit, sipas TEN-T

Vizioni i Strategjisë Sektoriale të Transportit për periudhën 2016-2020 parashikohet të jetë:
“Një sistem efikas transporti, i integruar me rajonin dhe rrjetin e BE-së, i cili promovon zhvillimin ekonomik dhe cilësinë e jetës së qytetarëve”.

Në kuader të SEETO, janë përgjedhur 13 projekte për Shqipërinë, dhe konkretisht:

Të kualifikuara për financim:

1. Ndërtimi i rrugës Fushë-Krujë – Shkodër (dublimi)
2. Ndërtimi i rrugës Thumanë – Kashar/Vorë
3. Ndërtimi i by-pass-it të Tepelenës
4. Ndërtimi i by-pass-it të Lezhës
5. Ndërtimi i by-pass-it të Tiranës
6. Ndërtimi i dublimit të rrugës Milot – Rrëshen
7. Rehabilitimi i hekurudhës Vorë – Shkodër – Hani i Hotit
8. Rehabilitimi i hekurudhës Durrës – Tiranë dhe ndërtimi i hekurudhës së re Tiranë – Dega e Rinasit
9. Rehabilitimi i hekurudhës Durrës – Pogradec – Lin dhe ndërtimi i lidhjes së re hekurudhore me kufirin maqedonas.
10. Përmirësimi i Infrastrukturës së Porteve për rritjen e sigurisë dhe parrezikshmërisë detare dhe mbrojtjen e mjedisit detar

Të kualifikuara për përgatitje:

1. Ndërtimi i hekurudhës së re Pogradec – Korçë – Kufiri me Greqinë (në PBA është studimi);
2. Rindërtimi i Rrugës së Lumit të Vlorës;




Fig. 5 - Rrjeti i korridoreve rrugore rrethore si dhe i korridoreve hekurudhere

Vlera totale e investimeve ne rrjetin e transportit kombetar, sipas parashikimeve që janë bërë së bashku me ekspertët ndërkombëtarë shkon në rreth 1 miliard euro.

Ndër projektet afatgjata, dokumenti i Strategjisë së Transportit propozon:

Për transportin rrugor:


- forcimi i bashkëpunimit me vendet e rajonit, si Kosova, Maqedonia, Greqia dhe Mali i Zi nëpërmjet lidhjeve tokësore, me synimin përfshirë rritur volumin vjetor, mesatarisht me rreth 7% dhe përfshirë pasagjerët me rreth 6.5%.
- Përmirësimi i mirëmbajtjes së rrjetit rrugor, kombëtar, me mbështetjen edhe të sektorit privat. Një tjetër pikë është edhe zbatimi i projektit të Bankës Botërore përmirësimi i rrugave dëshiruese.
- zgjerimi i rrjetit rrugor kombëtar me 45%, me anë të kalimit të pëfjesshëm të rrjetit rural në atë kombëtar (nën administrimin e Autoritetit Rrugor Shqiptar), me qëllim përmirësimin e praktikave të mirëmbajtjes.

Për transportin hekurudhor

- Ndërtimi i linjës hekurudhere Tiranë – Rinas – Durrës,
- Mundesimi dhe zhvillimi lidhjes Vorë – Hani i Hotit, dhe më tej me Greqinë dhe Maqedoninë, Nevojë përmirësimi i rrugave ka edhe në linjën Durrës – Elbasan – Lin.

Për transportin detar:

- Objektivi deri në vitin 2020 synohet rritja me 50% e volumit kargo të përpunuar në porte;
- rritja vjetore me 12% e numrit të pasagjerëve me tragete;
- rehabilitimi i infrastrukturës dhe superstrukturës përfshirë katër porte, përfshirë këtu edhe ato turistike;
- rritja vjetore me 12% e volumit të përpunimit të kontejnerëve;
- ndërtimin e infrastrukturës dhe superstrukturës së portave turistike, përfshirë rritur numrin e anijeve turistike që do të ankorohen, si dhe përfshirë gjeneruar më shumë të ardhura nga turizmi detar.



Për transportin ajror

- Fillimin e operimit në Aeroportin e Kukësit,
- Studim fizibiliteti për ndërtimin e një aeroporti në jug të vendit, që mund të jetë në Sarandë, Vlorë, apo në Gjirokastër.

1.2.4. Parashikimet qe rrjedhin nga Strategjia Kombetare te Energjise 2018-2030

Parimet kryesore te Strategjise Kombetare te Energjise jane:

- Ristrukturimi i pote i sektorit energjitik kombetar bazuar ne parimet e ekonomise se tregut dhe ne zhvillimin e nje politike bashkohore energjitike.
- Rritja e sigurise dhe besueshmerise ne furnizimin me energji ne per gjithesi dhe energji elektrike ne vecanti si ne nivel kombetar ashtu edhe ne ate rajonal;
- Krijimi i nje sektori energjtik te afte si nga ana financiare ashtu edhe nga ajo teknike.
- Krijimi i nje kuadri efektiv institucional dhe rregulator dhe ristrukturimi i pote i kompanive te Energjise.
- Rritja e eficiencies se energjise, si gjate prodhimit ashtu dhe gjate perdonimit te burimeve energjtike, me synim ndotjen minimale te mjedisit.
- Optimizimi i sistemit te furnizimit me burime energjtike duke u mbeshtetur ne konceptin e planifikimit me kosto me te ulet dhe ndikim minimal ne mjedis.

Strategjia synon ne krijimin e nje tregu elektrik konkurrues bazuar ne kerkesat e Bashkimit European per reformimin e sektorit elektroenergjtik (Direktiva 96/92 EU) dhe detyrat e Shqiperise ne kuadrin e Memorandumit te Mirekuptimit te Athines, (15 Nentor 2002), per integrimin e sektorit elektroenergjtik shqiptar ne Treg.

Dokumenti i Strategjise Kombëtare e Energjisë 2018 – 2030 është hartuar që të ketë një ndikim minimal në shpenzimet publike, duke projektuar investimet e këruara nga burime private, donatorët, bankat e zhvillimit si dhe bankat lokale dhe së fundmi nga Buxheti i Shtetit.

Ajo synon te finalizoje tranzicionin e sistemit energetik kombetar nga nje sistem i planifikuar drejt një sistemi me bazë tregu.

Nje nga objektivat madhore te Strategjise eshte integrimi i tregut të energjisë Shqipëri-Kosovë, duke shfrytëzuar më mirë kapacitetet transmetuese ndërkufitar, dhe duke nderthurur ne menyre eficiente burimet e energjisë termike në Kosovë me burimet hidrike në Shqipëri. Deri në vitin 2030, të dy sistemet e kombinuara do të gjeneronin kursime vjetore financiare nga shpenzimet e reduktuara të importit prej më shumë se 1 miliardë euro, duke vendosur edhe themel e bashkëpunimit dhe krijimit të një burse të përbashkët për sektorin elektroenergetik.

Investimet potenciale për përbushjen dhe zbatimin e të gjitha objektivave të strategjisë janë rrëth 2.7 miliardë euro për tërë periudhën 2018-2030. Nderkohe, nepermjet zbatimit te skenareve te propozuar, kontributi final i Buxhetit të Shtetit të planifikuar për sektorin e energjisë, përfshirë kapitalin e kompanive publike do të jetë vetëm 0.5% e vleres se kerkuar te investimit.

Strategjia Kombetare e Energjisë eshte bazuar ne iniciativat dhe masat e rendesishme te ndermarra nga Qeveria Shqiptare, dhe konkretisht:

- reduktimi i humbjeve te sistemit nga 45.04% në 2013 në 26.41% në fund të vitit 2017;
- rritja e arkëtimeve ne sistem nga 38.6 miliard lekë në 2013 në 64.1 miliard lekë në 2017;
- realizimi i investimeve permiresuese në sektorin e shpërndarjes me vlerë prej 160 milion euro;
- Përfundimi i linjës së interkonjekzionit elektroenergetik 400 kV të Shqipërisë me Kosovë;
- Përfundimi I linjes 110 kV të Unazës së Jugut;
- Fillimi i ndërtimit te linjës së interkonjekzionit 400 kV mes Shqipërisë dhe Maqedonisë;
- Rritja me 400 Megavat e kapaciteteve gjeneruese te energjise ne nivel kombetar nepermjet kaskadës së Devollit, HEC-it te Banjës si dhe shume njesive te tjera prodhuese;
- Fillimi i projektit TAP – si projekt me I rendesishem kombetar dhe rajonal per furnizimin me gaz;

Ndërkohe, sipas dokumentit strategjik, sfidat e ardhme me të cilat ballafaqohet aktualisht sektori shqiptar i energjisë përfshijnë:

- mbështetjen e zhvillimeve ekonomike në sektorë të ndryshëm ekonomik-shoqëror;
- rritja e sigurisë së furnizimit me energji në përgjithësi dhe energji elektrike në veçanti duke marrë pjesë aktive në tregun rajonal energjetik, përmirësuar eficiencën e energjisë, rritur pjesën e burimeve të rinovueshme të energjisë dhe burimeve të tjera konvencionale të energjisë dhe në të njëjtën kohë duke masa të rëndësishme përmbrojtjen e mjedisit,
- gazifikimin e sektorin energjetik duke shfrytëzuar në maksimum projektin TAP, IAP dhe lidhjen e mundshme të Shqipërisë me Kosovën edhe me linjën e gazit natyror;

Në këtë kontekst Strategjia Kombëtare e Energjisë ka përcaktuar objektivat e mëposhtme:

- Vazhdimin e reduktimit të humbjeve teknike dhe jo-teknike të shpërndarjes së energjisë elektrike nga 26.4% në vitin 2017 në 10% në vitin 2030 – nivel ky i krahasuar me të gjitha vendet europiane;
- Vazhdimin e rritjes së arkëtimeve të energjisë elektrike nga 90% në vitin 2018 në 98% në vitin 2030 – nivel ky i krahasuar me të gjitha vendet europiane;
- Rritjen e kontributit të burimeve primare të energjisë kundrejt furnizimit total me burime primare të energjisë në nivelin 52.5% në vitin 2030;
- Shkalla e hapjes së tregut të energjisë elektrike të arrijë 100% në vitin 2025 duke ndërtuar njëkohësisht një skemë të thjeshte dhe të zbatueshme në drejtim të mbrojtjes së konsumatorëve familjarë me të ardhura të ulta. Në këtë kuadër Qeveria e Shqipërisë në bashkëpunim me Qeverinë Kosovës, me mbështetjen shumë të madhe të USAID-it dhe Sekretariatit të Energjisë po punojnë përi integrimin e tregjeve të energjisë elektrike të Shqipërisë dhe Kosovës, krijimin e Bursës Shqiptare të energjisë elektrike me objektiv afatgjatë integrimin e tregjeve tona në tregun european
- Ekonomia dhe shoqëria shqiptare të arrijë një nivel kursimi të energjisë kundrejt konsumit total me 15% në vitin 2030;



- Targeti i energjive të rrinovueshme kundrejt konsumit total të arrijë në nivelin 42% në vitin 2030;
- Reduktim i emetimeve GHG kundrejt totalit të arrijë 11.5% në vitin 2030;
- Penetrimi i gazit natyror kundrejt furnizimit total me burime primare të energjisë të arrijë në nivelin 20% në vitin 2030; Sigurisht që kjo të bëhet e mundur me investime të rëndësishme në ndërtimin dhe zgjerimin e rrjetit të shpërndarjes së gazit në vend.
- Ngritja e kapaciteteve dhe forcimi i shoqërisë Albgaz, e ngritur vetëm rreth një vit më parë, si dhe bashkëpunimi i saj me partnerë strategjike dhe me eksperiençë në sektorin e gazit përbën një premisë të mirë për gazifikimin e ekonomisë shqiptare në të ardhmen e afërt.

Përcaktimet e Strategjise Kombetare te Energjise kane efekt ne kontekstin social ekonomik si dhe ate territorial te Bashkise Tepelene. Konkrektisht, duke iu referuar ketyre percaktimeve, Strategjia Territoriale e Tepelenes dhe Plani I Pergjithshem Vendor duhet te marrin ne konsiderate:

- rikualifikimin e rrjetit te shpërndarjes se energjise, me qellim rritjen e performances si dhe humbjeve ne rrjet.
- Konsolidimin e qendrave urbane dhe rurale – ky nacion ka te beje me rritjen e eficiencës se shfrytezimit te rrjeteve te energjise. Teknikisht, furnizimi me energji I zonave urbane te vogla apo grupeve te vogla te banesave periferike kerkon investime te medha kapitale dhe mirembajtjeje te rrjeteve te shpërndarjes se rrymes. Keto procese te bartjes dhe shpërndarjes se rrymes shoqerohen me humbje përkatëse të fuqisë dhe energjisë. Vlera e këtyre humbjeve në sistemet elektroenergetike është e konsiderueshme dhe rëndom gjendet diku në intervalin prej 8-14% të bruto sasisë së energjisë së prodhuar elektrike, pjesa më e madhe e të cilave shkaktohet në rrjetin distributiv, ndërsa ajo më e vogël në rrjetin bartës. Per kete problematike Strategjia Territoriale Tepelene propozon konsolidimin dhe dendesimin e qendrave urbane, duke evitar njesite e vogla periferike, apo shtepite e shkeputura nga blloket konvencionale te banimit;
- Aplikimin dhe promovimin e teknologjive te energjive te rrinovueshme si panele diellore, sidomos ne zonat periferike te Bashkise. Keto propozime duhet te gjejne edhe mbështetjen teknike dhe financiare te institucionit te Bashkise Tepelene.
- Strategjia Territoriale Tepelenë propozon qe te gjitha projektet rugore te marrin ne konsiderate shtrirjen ne perspektive të rrjetit te furnizimit me gaz ne te gjithe territorin e Bashkise.

1.2.5. Parashikimet qe rrjedhin nga Strategjia Kombetare e Menaxhimit te Mbetjeve

Strategjia Kombëtare e Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve është dokumenti kryesor planifikues në fushën e menaxhimit të mbetjeve. Strategjia rregullon menaxhimin e rrymave të ndryshme të mbetjeve në territorin e Republikës së Shqipërisë nga gjenerimi deri tek asjesimi përfundimtar mbi bazën e një qasje të integruar që do të strukturohet në përputhje me mundësitë reale që ka vendi për të përshtatur në kohë standardet më të mira Evropiane, në mënyrë që të shmangë dhe zvogëlojë në masën më të madhe ndikimet negative në shëndetin e njeriut, mbrojtjen e mjedisit dhe përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike.

Strategjia është strukturuar që të përmbushë parimet bazë të BE të cilat janë harmonizuar në legjislacionin që mbulon fushën e menaxhimit të mbetjeve.

Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI) përcakton si vizion të menaxhimit të mbetjeve

“Krijimi i një kuadri strategjik dhe rregullator në Shqipëri, për të ulur sasinë e mbetjeve të gjeneruara dhe menaxhuar në mënyrë të integruar mbetjet e gjeneruara në linjë me objektivat e Direktivës Kuadër të Mbetjeve të BE dhe marrëveshjet ndërkombëtare”

Si dokumenti kryesor i politikave të zhvillimit për vendin, për adresimin e vështirësive të menaxhimit të mbetjeve, SKZHI përcakton tre objektiva kryesore strategjikë:

- Menaxhimin gjithëpërfshirës dhe në mënyrë strategjike të mbetjeve të ngurta urbane;
- Përmirësimin e performancës së përgjithshme të menaxhimit të mbetjeve, deri në vitin 2020 dhe përtetj këtij viti.
- Përmirësimin e llogaridhënieve përmirësimin e mbetjeve.
- Sipas parashikimit te PPK do te do te propozohet qe per zonen e Tepelenes te krijohet një landfill tranzit pra jo permanent per te mundesuar akumulimin dhe mbledhjen e mbeturinave ne një landfill te perkohshem per tu zhvendosur me tej ne një landfill rajonal.
- Eliminimi ne menyre kategorike I depozitimit te mbetjeve per gjate koridoreve te trupave ujor

Këto drejtime të SKZHI janë marrë në konsideratë dhe përbëjnë shtyllat kryesore të Strategjisë së Mbetjeve. Këto objektiva strategjikë do të janë përcaktues në hartimin e objektivave specifikë përmirësimi i mbetjeve, dëshmorët e zhvillimit të plotë kombëtar të menaxhimit.

Parimet bazë të menaxhimit të mbetjeve

Strategjia Kombëtare e Menaxhimit te Mbetjeve është strukturuar që të përmbushë parimet bazë të BE të cilat janë harmonizuar në legjislacionin që mbulon fushën e menaxhimit të mbetjeve, dhe konkretisht:

- **Hierarkia e mbetjeve**

Sic përcaktohet dhe në ligjin Nr.10463, datë 22.9.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar, menaxhimi ndjek radhën e mëposhtme, në zbatim të hierarkisë:




Fig. 6 - Skema e hierarkise se mbetjeve



Parimi i Zhvillimit të Qëndrueshëm

Zhvillimi i qëndrueshëm i menaxhimit të integruar të mbetjeve nënkuption se burimet natyrore do të përdoren me eficiencë, duke nxitur zvogëlimin e gjenerimit të mbetjeve, ripërdorimin e materialeve të riciklueshme, përdorimin e burimeve të rinovueshme të energjisë, duke shkaktuar ndikimin më të vogël të mundshëm mbi mjedisin

Përdorimi i teknologjisë më të mirë të mundëshme bazuar mbi efektivitetin e kostos dhe pranueshmërinë mjedisore.

Shkarkimet nga objektet e trajtimit të mbetjeve dhe landfill-et, duhet të zvogëlohen maksimalisht dhe në mënyrën me eficiente ne aspektin teknik dhe ekonomik.

Parimi i përgjegjësisë së zgjeruar të prodhuesit të mbetjeve

Gjeneruesve të mbetjeve iu kërkohet që të mbajnë përgjegjësi për koston e parandalimit, dhe depozitim, si dhe të gjitha kostot e menaxhimit të mbetjeve të cilat nuk mbulohen nga të ardhurat që mund të krijohen prej riciklimit të mbetjeve. Këta gjenerues janë gjithashtu përgjegjës për zbatimin e masave parandaluese dhe cdëmtuese në lidhje me dëmet që shkaktojnë ose që mund të shkaktojnë në mjedis nga mbetjet që ata gjenerojnë.

Parimi “Ndotësi paguan”

Ata që ndosin mjedisin, përfshirë dhe ekonomitë familjare, do të janë përgjegjës për mbulimin e kostove për menaxhimin e mbetjeve, përfshirë edhe pranimin e masave për parandalimin dhe eleminimin e dëmeve që shkaktohen nga mbetjet që ata shkarkojnë në mjedis.

Parime të tjera për menaxhimin e integruar të mbetjeve zbatohen në përputhje me dispozitat e ligjit 10431 datë 09.06.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit” i ndryshuar dhe ligjit 10463 datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” i ndryshuar. Përafrimi me BE në fushën e mjedisit dhe menaxhimit të mbetjeve

- Parimi i parandalimit dhe marrja e masave paraprake
- Parimi i zëvendësimit dhe/ose kompensimit
- Parimi i qasjes së integruar
- Parimi i përgjegjësisë së ndërsjelltë dhe bashkëpunimit
- Parimi i së drejtës për informimin dhe pjesëmarrjen e publikut
- Parimi i nxitjes së veprimtarive për mbrojtjen e mjedisit

Strategjia dhe Rol i Bashkive për Menaxhimin e Mbetjeve – Bashkia Tepelenë

Roli i Bashkive në lidhje me menaxhimin e mbetjeve është përcaktuar nga ligji 139/2015 “Për vet-qeverisjen vendore” i ndryshuar. Forcimi i rolit të bashkive është një domosdoshmëri e cila do të vijë nga harmonizimi i ligjit për menaxhimin e integruar të mbetjeve me dispozitat e ligjit për vet-qeverisjen vendore.

Roli i Bashkise Tepelene përcaktohet më qartë në përputhje me përgjegjësitë institucionale dhe manazheriale në kuadër të Zonave të Mbetjeve. Ne kete kuader, Strategjia percakton qe Bashkia duhet te hartoje periodikisht planet për menaxhimin e integruar të mbetjeve në kuadër të Zonës së Mbetjeve.

Bashkia Tepelene eshte përgjegjëse për ofrimin dhe administrimin e shërbimit të pastrimit, mbledhjen dhe transportin e bashkiakë¹ në pikat e peraktuara te grumbullimit (stacionet e

¹ European Commission, Eurostat “Guidance on municipal waste data collection”, May 2017

transferimit). Ne kete kontekst, institucioni i Bashkise mund te ngreje dhe operoje qendra specifike brenda territorit qe administron, me qellim grumbullimin e diferencuar të mbetjeve urbane, përfshirë ketu mbetjet e proceseve te ndertimit, mbetjet e riciklueshme si dhe mbetjet e biodegradueshme për qëllimin e kompostimit. Per financimin e ketij sherbimi, Bashkia Tepelene vendos tarifa për grumbullimin, transportin dhe trajtimin e mbetjeve.

Proceset e grumbullimit, depozitimit dhe menaxhimit te mbetjeve përfshijnë:

- Mbetjet shtëpiake dhe të ngashme, përfshirë:
 - Mbetjet e vëllimshme (mbetjet e bardha, mobilje te vjetra etj)
 - Mbetjet e kopshteve, gjethet, prerjet e pemeve nga krasitjet, mbetjet nga pastrimi i rrugeve dhe i tregjeve publike;
- Mbetjet nga aktivitetet komerciale dhe bizneset e vogla, zyrat dhe institucionet
- Mbetjet nga shërbime të tjera bashkiakë si parqet, lulishtet etj.

Sipas dokumentit te Strategjise, Bashkia Tepelene eshte e lire të zgjedhe te menaxhojnë mbetjet vetëm ose në bashkëpunim, duke përdorur një nga format:

- ndërmarrjeve për shërbimet publike, sipas legjislacionit në fuqi;
- kontraktimit të dhënies së shërbimeve me palë të treta;
- përdorimit të instrumenteve të përshtatshme të partneritetit publik dhe privat, sipas legjislacionit në fuqi;
- krijimit të shoqërive tregtare në pronësi apo bashkëpronësi të njësisë vendore, sipas legjislacionit në fuqi.

Në çdo rast, pavarësisht nga instrumenti i përzgjedhur, Bashkia do të jetë përgjegjëse për hartimin dhe vodosjen e një sistemi administrimi dhe sistemi treguesish të performancës së shërbimit bazuar mbi standarde specifike. Po ashtu Bashkia Tepelene duhet te krijoje një njësi të posaçme në strukturën e saj, e cila do të jetë përgjegjëse për prezantimin, mbikëqyrjen dhe monitorimin e performancës e të shërbimit.

Landfillet Rajonale

Bazuar në Planin Kombëtar të Menaxhimit të Mbetjeve 2010-2025 është parashikuar që menaxhimi dhe trajtimi i mbetjeve të bëhet në nivel rajonal për 12 qarqet. Objektivi kryesor është vodosja në gjendje sigurie të venddepozitimeve ekzistuese, dhe ndërtimi i venddepozitimeve rajonale sipas standardeve të BE.

Per shkak te pozicionit gjeografik te Bashkise Tepelene, skema e grumbullimit, depozitimit dhe transportit te mbetjeve do te bazohet objektivin final te trajtimit dhe depozitimit te mbetjeve ne dy pika specifike:

1. Landfilli Bajkaj Bashkia Delvine - Financimi i këtij projekti mundesohet nga Shoqata Ndërkombëtare për Zhvillim (IDA). E pozicionuar per gjate rruges Sarande Kardhiq, kjo pike eshte variant I pare I marre ne konsiderate per depozitimin final te mbetjeve te Bashkise Tepelene
2. Landfill Gjirokaster - Në zbatim të VKM Nr. 333 dt. 26.1.2011 "Për administrimin e venddepozitimeve rajonale të mbetjeve urbane", është e domosdoshme hartimi i studimeve, projekt zbatimeve, si dhe ndërtimit të venddepozitimeve të reja rajonale, një prej te cilave do te jete dhe Landfilli ne Gjirokaster.



ZONAT E MRETJEVE



Fig. 7 Skema e shperndarjes se Landfilave Rajonale, si dhe pikat potenciale per Landfille te reja

1.2.6. Parashikimet qe rrjedhin nga Strategja Kombëtare e Sektorit te Furnizimit me Ujë dhe Kanalizime

Vizioni i Strategjise

Hartimi i politikave të përshtatshme dhe angazhimi i fondeve të mjaftueshme për të përmirësuar dhënien e shërbimeve të ujësjellësit dhe -kanalizimeve, dhe për të ecur në mënyrë të qëndrueshme drejt përputhjes me standardet e Bashkimit Evropian dhe me Objektivin e Zhvillimit të Mijëvjeçarit për qëndrueshmërinë e mjedisit

OBJEKTIVAT E SEKTORIT TE UJIT DHE KANALIZIMEVE

Zgjerim dhe përmirësim i cilësisë së shërbimeve të sektorit të ujësjellës-kanalizimeve.


- Rritja e aksosit të popullsisë urbane dhe rurale në furnizimin me ujë të pijshëm të sigurt.
- Rritja e lidhjeve të popullsisë urbane dhe rurale me rrjetet e grumbullimit të ujërave të zeza.
- Shtim i orëve të shërbimit për popullsinë urbane dhe rurale.
- Rritja e përqindjes së popullsisë të lidhur me rrjetin e grumbullimit të ujërave të zeza, i cili është i lidhur me një impiant përpunimi.
- Hartimi dhe realizimi periodik i vrojtimit të nevojave kombëtare për të përcaktuar projektet prioritare për investime.

Strategja Territoriale e Bashkisë Tepelene duhet te analizoje dhe te propozoje furnizimin me uje te te gjithe popullates se Njesise Vendore, nepermjet shfrytezimit te qendrueshem te burimeve ujore qe disponon. Te gjitha planet dhe investimet per furnizimin me uje dhe kanalizimet e ujërave te zeza duhet te bazohen ne riorganizimin hapesinor të njesive urbane te propozuara sipas Planit, duke minimizuar ndikimet negative ne terrenet natyrore apo zonat e ndjeshme mjedisore.

Orientimi i shërbimeve të ujit drejt parimeve të kontrollit dhe rikuperimit të plotë të kostove.

- Orientimi i shërbimeve në mënyrë të tillë që të rikuperohen plotësisht kostot operacionale dhe të mirëmbajtjes, shlyerja e borxhit, dhe shpenzimet kapitale për riparime dhe zëvendësime
- Fokusimi i investimeve në reduktimin e konsumimit të ujit dhe energjisë që nuk gjeneron të ardhura.
- Krijimi i një programi sipas së cilit të gjitha shërbimet e licencuara të ujit duhet të kenë një sistem menaxhimi asetesh plotësisht të dokumentuar.
- Të gjitha shërbimet e licencuara të ujit duhet të zhvillojnë dhe të përditësojnë vit pas viti një plan biznesi pesë vjeçar.
- Zhvillimi dhe zbatimi i një programi subvencionimi për familjet e varfra.

Edhe pse Bashkia Tepelene disponon burime te konsiderueshme te ujit, eshte e nevojshme qe konsolidohen praktika eficiente te shfrytezimit dhe administrimit te aseteve, duke evituar shperdorimet e panevojshme. E gjithe kjo duhet te bazohet ne vleresimin dhe inventarizimin e kujdeshem te burimeve ujore, analizen e gjendjes se tyre si dhe shfrytezimin sipas planeve te mirefillta te biznesit. Nderkohe, per sa permendur me lart lidhur me burimet, institucionin I Bashkise mund te perballoje me sukses nevojat per uje qe kane familjet e varfra dhe ne nevoje



Përmirësim i drejtimit dhe rregullimit të sektorit.

- Forcim i mëtejshëm i rolit të Entit Rregulator të Ujit.
- Zgjerim i aktiviteteve licencuese të Entit Rregulator të Ujit me synim licencimin e të gjithë sistemeve të ujësjellës-kanalizimeve.
- Hartimi dhe përhapja e një Kontratë Tip për Dhënien e Shërbimeve që të negociohet ndërmjet ndërmarrjeve të ujësjellës-kanalizimeve dhe njësive të qeverisjes vendore.
- Forcimi i Drejtorisë së Përgjithshme të Administrimit të Ujërave në rolin e vet si Sekretariat Teknik nën varësinë e Këshillit Kombëtar të Ujërave, si dhe I mbikëqyrjes së Agjencive të Baseneve të Lumenjeve.

Investime për rritjen e kapaciteteve të fuqisë punëtore të sektorit.

- Hartimi i një programi kombëtar trajnimi dhe certifikimi, sipas kërkesave për trajnim të gjithë shërbimeve të ujit.
- Të gjithë anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës të shërbimeve të licencuara të ujit t'u kërkohet të marrin pjesë dhe të përfundojnë trajnimin për rolet, detyrat, autoritetet dhe përgjegjësitë e tyre.

Lidhur me kete objektiv, Bashkia Tepelene, si aksionere e Ndermarrjes Ujeselles Kanalizime sha. duhet te garantoje kualifikimin periodik dhe rritjen e kapaciteteve te stafit te ndermarrjes, ne funksion te rritjes se nivelit te performances se sherbimit ne te gjithe zonat qe mbulon.

Progresi drejt harmonizimit të legjislacionit të brendshëm me Direktivat e BE-së për Ujin

- T'i propozohet parlamentit legjislacion për ujin që është i harmonizuar me Direktivat e BE-së për Ujin.
- Hartimi i një ligji të ri specifik për shërbimet e ujësjellës-kanalizimeve.
- Fillimi i një programi që inkurajon bashkimin e ndërmarrjeve të ujësjellësit.

Politika Nr. 1: Juridiksoni i Politikave Tarifore

Strategjia identifikon politika tarifore përfshin të gjithë ofruesit e licencuar të shërbimeve të ujësjellës kanalizimeve pa përjashtim, me qëllim që të rregullojë me efikasitet shërbimet si në zonat urbane ashtu edhe në ato rurale.

Politika Nr. 2: Diferencimi dhe Strukturat e Tarifave

Është e pranueshme që tarifat të mos janë të njëjta për të gjithë ofruesit e shërbimeve, pasi kjo reflekton kostot e ndryshme të shërbimit. Operatorët mund të zgjedhin midis një game të gjerë strukturash tarifash, megjithatë duhet të synohet drejt kalimit gradual në tarifa uniforme që janë transparente, të barabarta dhe lehtësish të kuptueshme për konsumatorin. Mund të shqyrtohet vendosja e tarifave sezionale për rajonet bregdetare turistike, ku kërkesa maksimale në verë e rrit pamjaftueshmërinë e ujit. Do të ishte e preferueshme një strukturë tarifash që bazohet në vlera fikse dhe në volum, pasi kështu operatorit i garantohen hyrje të parashikueshme parash gjatë të gjithë periudha të vitit.

Ne kuader te mbeshtetjes sociale, sidomos ne zonat periferike qe administron, Bashkia Tepelene mund te planifikoje zbatimin e politikave mbeshtetese apo te subvencionimit per familjet e varfra dhe ne nevoje. Nderkohe, kjo politike mund te mbeshtetet duke e balancuar me taksat edhe tarifat ndaj kompanieve qe shfrytezojne burimet e bollshme ujore te Bashkise.

Politika Nr. 3: Subvencionimet e kryqëzuara ndërmjet kategorive të konsumatorëve

Në përputhje me parimin e trajtimit të barabartë të konsumatorëve si edhe për të arritur eficencën afatgjatë të sektorit, tendenca e çmimvëniës duhet të jetë për aplikimin e tarifave të njëjtë për njësi për të gjitha kategoritë e klientëve. Kjo duhet të bëhet gradualisht në periudhën 7-vjeçare.

Politika Nr. 4: Rikuperimi i kostos nga ofruesit e shërbimeve

Për ofruesit e shërbimeve të ujësjellës-kanalizimeve duhet të aplikohet parimi i rikuperimit të plotë të kostos, gjë që është në përputhje me Direktivat e BE-së për Ujin. Ky është proces gradual, bazuar në të dhënat përfshirë e konsumatorëve për të paguar në të gjitha zonat e shërbbyera të vendit, dhe duhet të zbatohet kurdo dhe kudo që është i mundur. Është detyrë e Entit Rregulator të Ujit që të bëjë vlerësim periodik të mundësisë praktike të rikuperimit të plotë të kostos nga tarifat dhe të përfshijë vlerësimin dhe rekomandimet e veta në Raportin Vjetor.

Politika Nr. 5 – Aplikimi i Subvencioneve të Shënjestruarra

Shërbimet bazë të furnizimit me ujë dhe kanalizime duhet t'u sigurohen të gjithë qytetarëve të Republikës së Shqipërisë, aty ku është ekonomikisht rentabël ose për mbrojtjen e shëndetit publik. Familjet e varfra që nuk mund të paguajnë koston e shërbimit, duhet të kenë akses në shërbime bazë përmes mekanizmave subvencionues adekuat. Aktualisht, subvencionimi realizohet në dy mënyra: subvencionim i kryqëzuar i strukturës tarifore, dhe subvencionim i drejtpërdrejtë i operatorëve nga Qeveria përmes pushtetit vendor. Gjatë periudhës së planifikimit, Qeveria do të punojë që të përgatitë dhe të zbatojë një program subvencionimi të shënjestruar në favor të familjeve në nevojë, me qëllim që të ndërpritet praktika e subvencionimit të humbjeve të ofruesve të shërbimeve. Qeveria është e vetëdijshme që ky ndryshim në subvencionime kërkon kritere të përshtatshme për të përfituar subvencionim dhe ngritjen e përditësimin e një baze të dhënash për familjet që përfitojnë, si edhe ngritjen e një mekanizmi të mirëmenduar për shpërndarjen e subvencioneve; mekanizmi duhet të jetë i zhvilluar mirë që t'i bëjë ballë përpjekjeve përfavorizim, abuzim dhe korruzion.

Politika Nr. 6: Inventarizimi i Aseteve dhe Vlerësimi i Sistemave të Ujësjellës-Kanalizimeve

Brenda një periudhe të caktuar, duhet të kryhet inventarizimi i aseteve dhe vlerësimi i të gjitha sistemave të ujësjellës-kanalizimeve urbane e rurale të licencuara, përfshi sistemin e një NjQV-je të vetme apo sistemin e shumë NjQV-ve. Ky proces inventarizimi dhe vlerësim duhet të kryhet në bazë të kriterieve që përcakton Enti Rregulator i Ujit dhe pastaj t'i dorëzohet Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZQRPP). Të gjitha ndryshimet në inventar duhet të pasqyrohen dhe të raportohen çdo vit në ZQRPP.

Politika Nr. 7: Hartimi i një ligji të ri specifik për shërbimet e ujësjellës-kanalizimeve

Qeveria ka marrë vendim të nxitë bashkimin e zonave të shërbimit me ujësjellës-kanalizime për të arritur ekonominë e shkallës në këtë sektor. Në këtë drejtim, duhet shqyrtuar hartimi i një ligji organik për shërbimet e ujësjellës-kanalizimeve, që të përcaktojë: statutet dhe pronësinë e ndërmarrjeve rajonale të ujësjellësit si edhe të ndërmarrjeve rajonale të trajtimit të ujërave të ndotur, parimet për inventarin dhe vlerësimin e aseteve, ndarjen e titujve të përdorimit nga e drejta e përdorimit, të drejtat dhe detyrimet e secilit aktor kryesor,



pronësinë e përzier publik-privat, strukturat e shërbimeve të bashkuara të shitjes me pakicë, si edhe hyrjen dhe daljen nga tregu.

Politika Nr. 8: Licencimi i Ofruesve të Shërbimeve të Ujësjellës-Kanalizimeve

Të gjithë ofruesit e shërbimeve të ujësjellës-kanalizimeve që operojnë përmes sistemeve të tubacioneve publike formale, duhet të marrin licencë nga Enti Rregullator i Ujit, sipas kriterieve të përcaktuara nga Enti. Politika Nr. 9: **"Autorizimi për të Zëvendësuar një Operator Dështues"**. Mandati i Entit Rregullator të Ujit duhet të forcohet duke i dhënë të drejtën të ndërhyjë kur operatorët nuk përmblushin standartet, duke autorizuar zëvendësimin e operatorit në fjalë me një tjetër operator (publik apo privat). Operatori alternative duhet të paguhet nga të ardhurat prej përdoruesve, plus kontributet e pushtetit vendor që përfiton shërbimet, nëse të ardhurat nga tarifat e përdoruesve janë të pamjaftueshme. Pra, nevojitet reagim i menjëhershëm i Qeverisë kur format e tjera të penalitetave shpërfillen ose rezultojnë joefikase. Enti Rregullator i Ujit duhet të zhvillojë dhe të publikojë procedurat që duhen ndjekur për zëvendësimin e operatorit

1.2.7. Parashikimet qe rrjedhin nga Strategja Kombëtare të Menaxhimit të Integruar të Burimeve Ujore, 2018–2027

Menaxhimi i Integruar i Burimeve Ujore perkufizohet si **"nje proces që nxit zhvillimin dhe menaxhimin e bashkerendar te ujtit, tokes dhe burimeve perkatese, per te rritur ne maksimum mireqenien sociale, ne menyre te barabarte dhe pa kompromentuar qendrueshmerine e ekosistemeve jetesore"**. Si e tille, Strategja sherben si një udhezues per politikat per ujin, si dhe te nxise zhvillimet operacionale dhe investime ndermjet te gjithe sektoreve brenda afatit 10 vjeçar. Strategja eshte hartuar ne menyre te tille qe te ofroje një kornize gjitheperfshire te burimeve ujore, duke perbere keshtu ne një kuader mjaft relevant per zhvillimin dhe administrimin e territoreve te Bashkise Tepelene, bazuar kjo ne burimet ujore qe kjo njesi disponon.



Vizioni I Strategjisë

Deri ne vitin 2017, Shqipëria do te jete një vend me efikasitet ne perdorimin e ujtit, me menaxhim te integruar e funksional te burimeve ujore qe perfshin dhe një sistem te plote monitorimi dhe menaxhimi te rreziqeve nga permbytjet dhe pamjaftueshmeria e burimeve ujore. Perdorimi i burimeve ujore bazohet ne parimin e barazise dhe qendrueshmerise per perfitime te barabarta socio-gjinore-ekonomike, dhe drejtesi mjedisore per brezat e sotem dhe te ardhshëm.

Politikat kryesore dhe objektivat e Strategjisë

1. Sasia e Ujtit perdorimi i drejtë dhe i balancuar i te gjitha burimeve ujore, qe i sherben interesave te te gjitha aktoreve
 - a. Menaxhimi i burimeve ujore ne nivel baseni
 - b. Percaktimi i masave te rezistences ndaj ndryshimeve klimatike
 - c. Permiresimi i shperndarjes se ujtit dhe marrja e masave konservative per depozitimini efikas dhe me barazi

- d. Shperndarja e barabarte e perfitimeve
 - e. Perfshirja publike, shperndarja e informacionit
2. Cilesia e Ujit ruajtja dhe permiresimi i cilesise se te gjitha burimeve ujore ne nivel kombetar, duke arritur statusin e "gjendjes se mire te ujit"
- a. Percaktimi I masave parandaluese ndaj ndryshimeve klimatike
 - b. Percaktimi I "gjendjes se ujit me cilesi te mire", si dhe I objektivave te perputhshmerise
 - c. Hartimi dhe zbatimi I Planeve te Menaxhimit te Baseneve Ujore si dhe Programet e Masave
 - d. Perfshirja publike, shperndarja e informacionit
3. Reziqet nga uji ulja e rreziqeve qe kane lidhje me ujin si permbytjet apo thatesirat, permes investimeve serioze dhe afatgjata
- a. Menaxhim I integruar I pasurise ujore ne rang kombetar dhe rajonal, duke marre parasysh katastrofat e ndryshme natyrore
 - b. Sigurimi I mbrojtjes nga permbytjet
 - c. Pergatitja per thatesirat dhe mungesen e ujit
 - d. Program masash per siguri efektive dhe rezistente ne perputhje me ndryshimet klimatike
4. Informacion mbi ujin krijimi dhe mirembajtja e sistemeve te perditesuara te informacionit per burimet ujore ne nivel kombatar
- a. Sigurimi I sistemeve te monitorimit te ujit
 - b. Lehtesimi I sistemeve te kerkimit dhe rritja e kapaciteteve per te zhvilluar njojurite e nevojshme per monitorimin, vleresimin e burimeve ujore dhe formulimin dhe marrjen e zbatimin e masave
 - c. Permiresimi I aksesit ne informacion dhe ne mbledhjen e te dhenave
 - d. Ngritja e nje strukture organizative dhe koordinuese te ujit dhe klimes
5. Administrimi I ujit menaxhimi i burimeve ujore ne menyre te qendrueshme dhe gjitheperfshirese
- a. Percaktimi I roleve dhe objektivave te qarta per Menaxhimin e Integruar te Burimeve Ujore
 - b. Arritura e perputhshmerise se plote me parimet e BE per ujin dhe mjedisin, ne lidhje me parandalimin, subvencionimin, proporcionalitetin dhe solidaritetin qe duhet te zbatohet
 - c. Zhvillimi I vazhdueshem I kapaciteteve, roleve dhe perjegjesive ndaj çeshtjeve qe kane te bejne me menaxhimin e burimeve ujore
 - d. Konsolidimi I bashkerendimit dhe planifikimit ndersektorial
 - e. Krijimi I institucioneve ekonomike dhe financiare per rikuperimin e kostove
 - f. Praktikimi I integritetit dhe transparences ne te gjitha politikat ujore, institucioneve te ujit dhe kuadrove te qeverisjes se ujit, duke rritur perjegjshmerine dhe besimin ne vendimmarrje
 - g. Sigurimi I pjesemarrjes se te gjitha paleve te interesit ne trajtimin e çeshtjeve qe kane te bejne me menaxhimin e burimeve ujore dhe promovimi I perfshirjes publike dhe ndryshimi shoqeror ne lidhje me kulturen e perdonimit te integruar te ujit.
 - h. Arritura e marreveshjeve te pershtatshme kufitare
 - i. Zbatimi I monitorimit dhe vleresimit te adminstrimit te ujit aty ku eshte e pershtatshme, ndarja e rezultateve me publikun e gjere



Buxheti i planifikuar për përbushjen e objektivave strategjike per burimet ujore, me gjithë ndryshimet potenciale te politikave dhe masave perkatese, perllogaritet ne 1.1 miliarde Euro. Strategjia bazohet ne 4 shtylla strategjike, te paraqitura si ne skemen grafike ne vazhdim




Fig. 8 Shtyllat kryesore te Strategjise Kombetare per Menaxhimin e Integruar te Burimeve Ujore

Sfidat kryesore te sektorit te ujit qe adreson Strategjia jane

1. Permiresimi i furnizimit me uje dhe kanalizimeve, si dhe rritja e aksesit tek uji;
2. Permiresimi i efikasitetit te sherbimeve ne zonat urbane dhe rurale duke zbatuar parimin e rekuperimit te plote te kostove;
3. Rritja e vemendjes per identifikimin, formalizimin dhe diferencimin ne strukturen tarifore;
4. Orientimi i investimeve ne sektorin e infrastruktures drejt perdonimit optimale dhe efikas te energjise elektrike qe prodhohet prej ujit;
5. Forcimi i kapaciteteve te per gjithshme ne mbrojtje e burimeve ujore;
6. Reduktimi i kostove te ofrimit te sherbimeve;
7. Ristrukturimi i per gjithshem i sektorit;

Ne kuader te zbatimit te politikave dhe Strategjise Kombatare te Menaxhimit te Integruar te Burimeve ujor, Strategjia Territoriale dhe Plani i Pergjithshem Vendor i Bashkise Tepelene duhet te trajtoje ujin jo si ne lende te pare konsumi, por si nje element thelbesor ne zhvillimin dhe ruajtjen e balancave zhvillimore midis sistemeve te ndryshme territoriale. Per shkak te pozicionit gjeografik dhe karakteristikave natyrore, Bashkia Tepelene disponon nje fluks uji te konsiderueshem, e cila nuk nuk duhet trajtuar kurrsesi si nje aset lokal dhe i rendesise sekondare.

Masat apo menyrat e trajtimit te ujit ne Tepelene kane nje efekt te konsiderueshem ne territorret e njesive vendore fqinje si dhe ekosistemet. Dhe kjo nuk ka te beje me konsumin e ujit (Bashkia Tepelene ka nje konsum te reduktuar te ujit per shkak te numrit te vogel te popullsise) sesa me efektet njerezore ndaj trupave ujore. Konkretnisht, mireadministrimi strategjik i territorit te Bashkisë konsiston ne eliminimin e efekteve negative ndotese ndaj aseteve pozitive dhe potenciale qe ky territor disponon, si dhe maksimalizimin e perfitimeve qe rrjedhin. Eshte pikerisht eliminimi i efekteve negative ndotese apo demtuese ndaj trupave

ujore ajo qe duhet te parashikoje dhe te propozojne menyre te detajuar dokumenti i Strategjise Territoriale te Bashkise Tepelene, te koordinuar me masat e nevojshme administrative dhe ligjore.

1.2.8. Parashikimet qe rrjedhin nga Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015-2020

Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI) përfaqëson dokumentin themelor strategjik që kombinon Agjendën e integrimit në Bashkimin Evropian me zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik e shoqëror të vendit, përfshirë edhe ndërlidhjen me Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm.

Vizioni i Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015-2020:

"Shqipëria – një demokraci në forcim, në rrugën drejt integrimit të saj në Bashkimin Evropian, me një ekonomi konkuruese, të stabilizuar dhe të qëndrueshme, që garanton të drejtat themelore dhe liritë e njeriut"

SKZHI II synon ne:

- Ndërtimin e politikave që rrisin konkurrueshmërinë dhe rritjen ekonomike të vendit, krahasuar me vendet e rajonit dhe më tej
- Nxitjen e ritmeve të zhvillimit të vendit, duke gjeneruar rritje ekonomike të qëndrueshme, përmes një stabiliteti makroekonomik dhe financiar.
- Arritjen e standardeve që u shërbejnë qytetarëve, rritjes së mirëqenies dhe sigurimit të mbrojtjes së të drejtave të tyre.
- Transformimin e Shqipërisë në një vend me standarde, që mundësojnë anëtarësimin në Bashkimin Evropian;

Shtyllat Kryesore te SKZHI II

- 1 Rritja përmes Stabilitetit MakroEkonomik & Fiskal
- 2 Rritja Ekonomike përmes Shtimit të Konkurruesh mërisë
- 3 Investimi tek Individu & Kohezioni Social
- 4 Rritja përmes Përdorimit të Qëndrueshëm të Burimeve & Zhvillimit Territorial


Strategjia Territoriale dhe Plani i Pergjithshem Vendor i Bashkise Tepelene bazohet pikerisht ne zbatimin korrekt te objektivave te shtylles 4 te SKZHI II "Rritja përmes Përdorimit të Qëndrueshëm të Burimeve & Zhvillimit Territorial", dhe konkretisht:

Energjia

"Një sistem energetik i bazuar në parimet e tregut, që është në gjendje të plotësojë kërkesën për energji, për zhvillim të qëndrueshëm të ekonomisë, që garanton mbrojtjen e mjedisit dhe rritjen e mirëqenies me kosto minimale sociale"

Rezultatet e pritshme që aplikohen për të gjithë nën-sektorët energetikë janë:

- Siguria e furnizimit për një zhvillim të qëndrueshëm energetik,



- Një treg konkurues për prodhimin dhe furnizimin e energjisë dhe integrimi rajonal dhe evropian i Shqipërisë në sektorin energetik.
- Një kuadër i konsoliduar ligor dhe institucional sipas standardeve evropiane. Kjo përfshin sigurimin e përafrimit të kuadrit ligor dhe regulator në nënsektorin e energjisë elektrike dhe nënsektorin e gazit, me *acquis* të BE-së, dhe realizimin e detyrimeve të Paketës së Tretë të tregut të brendshëm energetik të BE-së.
- Integrimi i sektorit shqiptar të gazit në iniciativat rajonale dhe evropiane të gazit, bazuar në një koncept gjithëpërfshirës të sigurisë së energjisë në kuadrin e Bashkimit Evropian.
- Realizimi i kërkesës energjitike duke diversifikuar prodhimin dhe kombinuar rritjen e përdorimit të gazit, prodhimin e energjisë nga burimet e rinovueshme dhe energjinë elektrike.

Transporti - "Një sistem efikas transporti, i integruar në rajon dhe në rrjetin e BE-së që nxit zhvillimin ekonomik dhe cilësinë e jetës së qytetarëve"

1. Forcimi i bashkëpunimit me Kosovën, Maqedoninë, Greqinë dhe Malin e Zi përmes lidhjeve tokësore me qëllim rritjen e volumit vjetor mesatar të mallrave dhe atë të pasagjerëve.
2. Përmirësimi i mirëmbajtjes dhe performancës së rrjetit kombëtar rrugor, me kompani të sektorit privat përmes sistemit të menaxhimit të aseteve rrugore dhe zbatimit të Projektit të Bankës Botërore për mirëmbajtjen dhe sigurinë rrugore.
3. Fuqizimi i bashkërendimit, kapaciteteve dhe financimit të institucioneve të ndryshme të sigurisë rrugore, që do të çojë në një ulje të numrit të aksidenteve rrugore deri në vitin 2020.
4. Zgjerimi i rrjetit kombëtar të rrugëve përmes rrugëve të pjesshme të kalimit të rrjetit me atë kombëtar të rrugëve (nën administrimin e Autoritetit Shqiptar të Rrugëve), me qëllim përmirësimin e mirëmbajtjes së rrugëve të bazuar tek performanca.
5. Hartimit të një databaze qendore për pasagjerët, operatorët e transportit rrugor dhe mallrave, duke bërë të mundur monitorimin e plotë të gjithë operatorëve të transportit rrugor.
6. Garantimi i funksionimit të tregut të transportit rrugor të pasagjerëve në përputhje me standardet e BE-së.
7. Garantimi i krijimit dhe funksionimit të një mekanizmi të vetëm përgjedhjeje për evidentimin e investimeve prioritare për një përzierje të granteve të IPA II me kredi të institucioneve ndërkombëtare financiare, në përputhje me strategjitet dhe planet ekzistuese të transportit (që zbatohet për të gjitha modalitetet e transportit).

Menaxhimi i integruar i ujërave - "Një sistem i besueshëm mbarë kombëtar për furnizimin me ujë dhe kanalizime që plotësojnë nevojat e një ekonomie në zhvillim dhe të shoqërisë në përgjithësi, duke ruajtur dhe mbrojtur mjedisin, shëndetin dhe sigurinë e qytetarëve"

Objektivat strategjikë që lidhen me "Ujin për ushqim"

1. rritjes së sipërfaqes së tokës së ujitur, që matet me numrin e hektarëve që mbulohen nga sisteme plotësisht funksionale të ujitjes;
2. përmirësimi cilësor të funksionimit të sistemit të kullimit, të matur me hektarët që mbulohen plotësisht nga sisteme plotësisht funksionale kullimi;

3. infrastrukturës së rehabilituar dhe moderne që lidhet me ujiten, kullimin dhe mbrojtjen nga përmbytjet;
4. hartimit dhe zbatimit të mekanizmave për menaxhimin e qëndrueshmërit të sistemeve të ujites, kullimit dhe mbrojtjes nga përmbytjet (që përmendet gjithashtu në Seksionin 5.3 për priorititetet e qeverisë në lidhje me ujiten dhe kullimin);
5. rishikimit dhe përforcimit të mandatit të njësive të qeverisjes vendore;
6. forcimit të rolit të bordeve të kullimit

Objktivi strategjik që lidhet me "ujin për mjedisin"



1. krijimit dhe mirëmbajtjes së kadastrës elektronike kombëtare të ujit;
2. hartimit dhe zbatimit të planeve të menaxhimit të baseneve, me qëllim sigurimin e mbrojtjes dhe menaxhimit të duhur të baseneve të lumenjve.
3. përforcimit të rolit, mandatit dhe përgjegjësive të institucioneve në nivele vendore;
4. lidhjes dhe koordinimit të përdorimit të ujit me aktivitetet për zhvillimin e turizmit;
5. koordinimit dhe menaxhimit të përdorimit të ujit në kuadrin e ndryshimeve klimatike/aspekteve që kanë të bëjnë me zbutjen e tyre; dhe
6. rehabilitimit të shtretërve të dëmtuar lumorë.

Objktivi strategjik që lidhet me "Ujin për Industrinë"

1. identifikimit dhe vlerësimit të potencialit të burimeve ujore që do të përdoren për prodhimin e energjisë elektrike; identifikimit të hartës së potencialit të identifikuar; dhe
2. një përcaktimi të qartë dhe dallim të roleve, mandateve, detyrate dhe përgjegjësive të institucioneve që kanë lidhje me përdorimin e ujit industrial, sidomos ato që kanë të bëjnë me prodhimin hidroenergjetik, minerar dhe forma të tjera të përpunimit etj.

Menaxhimi i integruar i mbetjeve - "Një sistem eficient dhe efikas i menaxhimit të integruar të mbetjeve, i cili kontribuon në mbrojtjen dhe ruajtjen e mjedisit, mbrojtjen e shëndetit dhe sigurisë së njerëzve dhe mbështet përdorimin me racionalitet të burimeve natyrore përmes ri-përdorimit, reduktimit, riciklimit dhe rikuperimit"

1. azhornimi dhe zbatimi i plotë i "Strategjisë Kombëtare Ndërsektoriale për Menaxhimin e Mbetjeve, 2010-2025" dhe "Planit Kombëtar për Menaxhimin e Mbetjeve, 2010-2025";
2. hartimi i master planit për menaxhimin e integruar të mbetjeve të ngurta urbane;
3. kryerja e studimeve dhe projekteve për mbylljen dhe rehabilitimin e pikave të hedhjes së mbetjeve (waste dumps) për 15% nga zonat më rrezikshme;
4. kryerja e studimeve dhe projekteve për krijimin e landfill-eve të reja rajonale që do tu shërbejnë 50% të gjithë territorit
5. rritja e sasisë së mbetjeve që do të shkojnë landfill-e;
6. rritja e sasisë së mbetjeve që shkon për riciklim dhe kompostim;
7. zbatimi i planeve të rehabilitimit për 9 "hotspote" prioritare dhe përpilimin e planeve për "hotspot"-et e mbeturë;
8. ndërtimi dhe vënia në funksionim të dy landfill-eve;
9. rehabilitimi i 5 landfill-eve ekzistuese;
10. planifikimi për ndërtimin e së paku 1 impjanti për trajtimin e mbetjeve të rrezikshme;
11. ngritja e një autoriteti qendror/rajonal për rishikimin dhe miratimin e tarifave për heqjen e mbetjeve në pikat e landfill-eve;
12. shqyrtimi dhe përmirësimi i shërbimit dhe kontratave koncessionare;
13. forcimi i kapaciteteve të institucioneve përgjegjëse për menaxhimin e mbetjeve;



Mjedis i qëndrueshëm - "Për një zhvillim të qëndrueshëm social dhe ekonomik të vendit, duke mbrojtur burimet natyrore nga ndotja dhe degradimi, përmes menaxhimit të integruar"

1. ulja e nivelit të ndotjes në zonat urbane;
2. ulja e nivelit të ndotësve të ajrit bazuar tek shëndeti i njeriut;
3. ulja e emetimit të gazit serë, në krahasim me skenarin bazë të reduktimin të emetimeve të dioksidit të karbonit në 2030
4. ulja e sasisë së HCFC-ve (hidroklorofluorokarbon).
5. rritja e sipërfaqes së zonave të mbrojtura përmes rritjes dhe menaxhimit të integruar të zonave të mbrojtura;
6. krijimi i rrjetit ekologjik "Natura 2000";
7. sigurimi i statusit të konservimit të specieve dhe habitateve të kanosura/rrezikuara;
8. ulja së prerjeve të paligjshme të pyjeve deri në vitin 2020;
9. hartimi i planeve të mbarështimit për të gjitha ekonomitë pyjore në vend;
10. rehabilitimit i zonave të degraduara;
11. miratimi i Strategjisë Kombëtare të menaxhimit të integruar të burimeve ujore;
12. krijimi i Kadastrës Kombëtare për Burimet Ujore;
13. krijimi i një inventari të burimet ujore;
14. hartimit dhe zbatimit të planit të menaxhimit të baseneve ujore;
15. plotësimi i niveleve të cilësisë së ujit
16. rehabilitimi i shtrateve të dëmtuara të lumenjve;
17. plotesimi i përputhshmërisë së legjislacionit vendas me atë të BE-së;

Planifikimi hapësinor dhe zhvillimi urban i qëndrueshëm - "Planifikim territorial dhe zhvillim i qëndrueshëm në çdo nivel, dhe integrim i plotë me çdo sektor përmes rigjenerimit urban dhe modeleve të reja; legalizimi, zhvillimi dhe urbanizimi i zonave informale, unifikimi dhe miratimi i standardeve urbane, sigurimi i akomodimit të përshtatshëm për grupet me të ardhura të ulta dhe ato vulnerabël"

1. hartimi dhe zbatimi i Planit të Përgjithshëm Territorial Kombëtar deri në vitin 2020;
2. hartimi dhe zbatimi i Planit të Integruar Ndërsektorial për Bregdetin dhe Planit të Integruar për Zonën Ekonomike Tiranë-Durrës;
3. mbulimi i te gjithe territorit me Planet perkatese territoriale;
4. legalizimi i të gjitha ndërtimeve informale me vetë-deklarim deri në vitin 2020;
5. konsolidimin e standarteve gjithë-përfshirëse për projektimin, ndërtimin dhe kontrollin e materialeve të ndërtimit deri në vitin 2020;
6. përmirësimi i kushteve të strehimit dhe uljes së nevojave për strehim;
7. rinovimi i banesave dhe rritja e eficiencës së energjisë për apartamentet e privatizuara në vitin 1993;
8. përmirësimi i kushteve të strehimit të komuniteteve rome dhe egjiptiane;

Reforma per menaxhimin e Zhvillimit Rajonal - "Zhvillim i balancuar dhe bashkëpunim mes qarqeve/rajoneve të vendit, duke rritur kështu konkureshmërinë globale të vendit"

1. sigurimi i mbrojtjes së nevojshme për zhvillimin ekonomik, krijimin e vendeve të punës dhe ofrimit të arsimit profesional, si reagim ndaj nevojave të tregut të punës;
2. përmirësimi i lidhjeve të infrastrukturës brenda dhe midis rajoneve;
3. zgjerimi i funksioneve zonale dhe diversifikimit të ekonomive rurale;
4. përmirësimi i standardeve të infrastrukturës publike dhe rrjeteve utilitare;

5. sigurimi i mbrojtjes së integruar rajonale të mjedisit;
6. sigurimi i rritjes së investimeve publike në rajonet më pak të zhvilluara;
7. ndërtimi i kapaciteteve për zhvillimin rajonal në të gjitha nivelet e qeverisë;
8. krijimi i mekanizmave efikasë dhe eficientë për menaxhimin e zhvillimit rajonal;
9. forcimi i kapaciteteve të Departamentit për Zhvillim, Financim dhe Ndihmës së Huaj (DDFFA), si institucioni kryesor për menaxhimin e Fondit të Zhvillimit të Rajoneve;
10. përmirësimi i bashkëpunimit ndërdikasterial;
11. përmirësimi i koordinimit gjate hartimit të strategjive dhe përfshirja së aktorëve rajonalë;
12. krijimi i një sistemi monitorimi të kombinuar me zbatimin e strategjive rajonale;

Bujqësia dhe Zhvillimi Rural - "Një sektor efikas, novator dhe i qëndrueshëm agroushqimor, që është në gjendje të përballet me trysninë konkuruese në tregun e BE-së dhe zona rurale produktive që sigurojnë aktivitete ekonomike dhe mundësi punësimi, përfshirje sociale dhe cilësi për jetën e banorëve në zonat rurale"

1. nxitja e prodhimit të qëndrueshëm ushqimor dhe cilësisë përmes zhvillimit të një sektori agroushqimor konkurues dhe novator që është në gjendje t'i bëjë ballë trysnive nga konkurenca
2. rritja vjetore të prodhimtarisë së krahut të punës në bujqësi, për njësi vjetore pune (NjVP) /punonjësit me kohë të plotë;
3. garantimi që fermat dhe operatorët e regjistruar të agropërpunimit të janë në përputhje të plotë me standartet e BE-së;
4. rritja e madhësisë mesatare të fermave dhe rritjes së madhësisë mesatare të fermave tregtare;
5. përmirësimi i organizimit të zinxhirit të vlerave me anë të krijimit të shoqatave dhe grupeve të prodhuesëve dhe lloje të ngjashme bashkëpunimi midis fermerëve;
6. përmirësimi të raportit eksport-import;
7. sigurimit të menaxhimit të përgjithshëm të qëndrueshëm të burimeve natyrore dhe bujqësore përmes zhvillimit të GAP-ve kombëtare që marrin në konsideratë specifikat e peisazhit, dheut dhe klimës në Shqipëri.
8. menaxhimi më të mirë të pyjeve dhe ujërave dhe aplikimit të metodave të prodhimit bujqësor duke mbrojtur mjedisin dhe zbutjen e ndryshimeve klimaterike;
9. rritja e numrit të fermave organike të çertifikuara;
10. rritja e numrit të fermerëve që përfitojnë nga infrastruktura uijtëse;
11. krijimi i vendeve të reja të punës në aktivitetet e agropërpunimit;
12. ngritja e mikro ndërmarrjeve të reja bashkë me krijimin e vendeve të reja të punës në zonat rurale përmes diversifikimit të aktiviteteve që gjenerojnë të ardhura;
13. krijimi i vendeve të reja të punës në aktivitete jobujqësore dhe shërbime të tjera;
14. rritja e numrit të fermerëve me të ardhura jo nga fermat;
15. promovimi i vetëpunësimit dhe aktiviteteve sipërmarrëse tek migrantëve e rikthyer në zonat rurale dhe formalizimi i aktiviteteve të tyre.

Peshkimi

1. përpilimi i një plani shumëvjeçar për menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve të gjalla të ujërave detare dhe atyre të brendshme;
2. krijimi i një sistemi efikas për mbledhjen e të dhënave mbi flotën e peshkimit, sasinë e peshkimit, statusin biologjik të popullatave në ujërat dhe akuakulturën shqiptare;




3. ndërtimi i një porti peshkimi në Durrës, bashkë me markatat e peshkut për tregtinë me shumicë;
4. instalimi i infrastrukturës së nevojshme për riparimin e mjeteve të peshkimit në të katër portet;
5. forcimi i kapaciteteve njerëzore dhe atyre të infrastrukturës për kontrollin e veprimtarive të peshkimit dhe akuakulturës;
6. rritja e nivelit te bashkëpunimit me organet rajonale dhe ndërkombëtare të peshkimit dhe akuakulturës;
7. menaxhimi dhe mbrojtja e burimeve të peshkimit në përputhje me Politikën e Përbashkët për Peshkimin të BE-së;

Zhvillimi i turizmit - "Shqipëria- një destinacion atraktiv, autentik, mikëpritës turizmi në Evropë, bazuar në përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore, kulturore dhe historike, lehtësishët e aritshme nga tregjet ndërkombëtare"

1. rritja e numrit te nete-qëndrimeve për ndërkombëtarët dhe rritje modeste e emigrantëve dhe shqiptarëve etnikë;
2. rritja e kontributit direkt të turizmit në PBB;
3. rritja e kontributit direkt të turizmit në punësim.
4. Zhvillimi i një strategjie "Branding Albania" me një logo dhe slogan të unifikuar për investimet në turizëm;
5. miratimi dhe zbatimi i "Strategjisë kombëtare për zhvillimin e turizmit";
6. zhvillimi dhe zbatimi i një Plani Kombëtar për zhvillimin e turizmit, të integruar me Planin e Përgjithshëm të Territorit Kombëtar;
7. krijimi i produkteve të reja kulturore, natyrore dhe të turizmit bregdetar.

Sektor minerar dinamik dhe i qëndrueshëm - "Një industri minierash dinamike, e qëndrueshme dhe në harmoni, që kontribuojnë begatinë e vendit dhe në mirëqënen e popullit, duke krijuar mundësi më të mira punësimi dhe garantuar mbrojtjen dhe ruajtjen e mjedisit, në përputhje të plotë me të gjitha standartet për integrim në BE"

- 
- 
- 
1. përcaktimi i kushteve dhe regullave për ndryshimin e sipërfaqeve të lejeve minerare;
 2. përcaktimi dhe menaxhimi i garancive financiare;
 3. forcimi i bashkëpunimit ndërinstitucional në procedurat për nxitjen e investimeve në sektor.
 4. hapja e thellësive të minierës së Bulqizës;
 5. rritja e shfrytëzimit të mineraleteve të tjera, si p.sh. magnezit, bashkë me rritjen e nivelit të përpunimit dhe vlerës përkatëse të tregut;
 6. përdorimi me efikasitet të stokut të mineraleteve dhe mbetjeve të depozituara pranë minierave dhe uzinave të pasurimit;
 7. rritja e nivelit të riciklimit, për të ulur kostot e prodhimit;
 8. riaktivizimi i objekteve minerare të bllokuara për arësyte të ndryshme;

1.2.9. Parashikimet qe rrjedhin nga Strategja Kombëtare Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore 2015-2020

Dokumenti i (SKNDQV) paraqet vizionin e Qeverisë Shqiptare për forcimin e qeverisjes dhe demokracisë vendore dhe përparimin e procesit të decentralizimit sipas standardeve më të përparuara evropiane. Ai prezanton një përqasje gjithëpërfshirëse ndaj decentralizimit dhe forcimit të qeverisjes vendore në përputhje me parimet e Kartës Evropiane për Vetë-Qeverisjen Vendore, si edhe me ato e Hapësirës Administrative Evropiane për qeverisjen vendore, me synim sigurimin e decentralizimit politik, administrativ dhe fiskal.

Vizioni i kesaj Strategjie eshte "**Fuqizimi i qeverisjes vendore dhe i procesit të decentralizimit me qëllim që të sigurohet një efikasitet më i lartë i vetë qeverisë vendore**", i cili mbështetet në një kuadër politikash strategjike, si në vazhdim.

1. Rritja e efikasitetit të strukturave të qeverisjes vendore, përmes;

- Realizimi me sukses i reformes administrativo-territoriale duke synuar konsolidimin territorial të njësive vendore të nivelit të parë dhe nivelit të dytë, në përputhje me praktikat më të mira në vende të BE;
- Përbillyja e procesit të decentralizimit të kompetencave në funksionet e përbashkëta dhe të deleguara ndërmjet qeverisë qendrore dhe vendore, qe bazohet në parimin e subsidiaritetit. Përparësi do t'i jepet rasteve kur qeverija vendore nuk është në gjendje të arrijë plotësimin e standardeve kombëtare dhe qeveria qendrore do ta mbështesë atë financiarisht;
- Harmonizimi dhe bashkërendimi i kompetencave te përbashkëta midis nivelit të dytë të qeverisjes vendore dhe organeve të dekoncentruara në nivel rajonal permes krijimit te strukturave të afta menaxheriale në bashkitë e reja;

Lidhur me kete politikë, Strategjia Territoriale e Bashkise Tepelene konceptohet si dokumenti baze ne duart e administratës vendore ne orientimin, zhvillimin dhe konsolidimin e proceseve te administrimit te territorit. Ne kete kontest, te gjitha objektivat, politikat dhe plani i veprimeve te propozuar ne Strategjinë Territoriale duhet te synojne ne zhvillimin e strukturave dhe kapaciteteve te afta dhe te orientuara per administrimin e te gjithe elementeve te zhvillimit në perspektive te kesaj Njesie Vendore.

2. Forcimi i financave vendore dhe rritja e autonominë fiskale

- Ndërmarrja e nismave të rëndësishme ligjore, duke përfshirë hartimin e ligjit të ri integral për financat e qeverisjes vendore;
- Rivleresimi i paketës së decentralizimit fiskal, i cili do të përfshijë zbatimin e konceptit të ndarjes së taksave kombëtare;
- Përmirësimi i kritereve të ndarjes së transfertës së përgjithshme nga buxheti i shtetit për qeveritë vendore;
- Rishikimi i mekanizmit finanziar te transfertave të kushtëzuara nga buxheti i shtetit, duke synuar financime të integruara sipas instrumentit të Politikës së Zhvillimit Rajonal, duke siguruar transparencë dhe efikasitet në shpërndarje, si dhe bashkërendim me objektivat kombëtare;

Propozimet e Strategjisë Territoriale te Bashkise Tepelene duhet te synojne rritjen e nivelit te aktivitatave ekonomike ne te gjithe hapesirene administrative, duke rritur keshetu bazen fiskale



si dhe mundesite financiare te Njesise Vendore per me shume investime apo sherbime cilesore ndaj banoreve. Propozimet strategjike me karakter ekonomik nuk do te kufizohen vetem ne Sistemin Urban, por do te duhet te prekin te gjitha sistemet e tjera territoriale, per te garantuar nje shfrytezim sa me balancuar dhe efiçient te burimeve.

3. Forcimi i qeverisjes se mirë në nivel vendor

- Ndërtimi i një modeli të ri të harmonizuar të zhvillimit social-ekonomik dhe territorial, duke synuar uljen e pabarazisë në zhvillim midis zonave dhe territoreve të ndryshme të vendit dhe mbështetjen e qeverisjes vendore në nismat për zhvillim vendor;
- Hartimi dhe zhvillimi i Planeve Strategjike të Zhvillimit, të hartuar nga çdo njësi e qeverisjes vendore në përputhje me politikat kombëtare dhe rajonale të zhvillimit, si dhe te mbeshtetura financiarisht nga politikat e decentralizimit fiskal;

Vete dokumenti i Strategjise Territoriale perfshin ne brendesi konceptin e instrumentit te Planit Strategjik te Zhvillimit. Si i tille, duke iu referuar udhezuesit zyrtar per hartimin e dokumenteve strategjike, dokumenti i Strategjise Territoriale do te analizoje dhe referoje te gjitha politikat kombetare te zhvillimit te sektoreve te ndryshem, te cilet kane ndikim ne zhvillimet perspektive te Bashkise Tepelene.

4. Nxitja e zhvillimit te qëndrueshëm vendor

- Forcimi i transparencës dhe pjesëmarrjes së komuniteteve, biznesit dhe shoqërisë civile në vendimmarjen publike në nivel vendor. Do të rishikohet kuadri ligjor dhe do të ngrihet një sistem i veçantë për "monitorimin e performancës në nivel vendor" si mekanizëm për të garantuar llogaridhënien e administratës publike dhe efikasitetin e shërbimeve në nivel vendor.
- Aktivizimi qytetar do të nxitet nëpërmjet fuqizimit të strukturave komunitare në qytet (ndërlidhësi komunitar) dhe në zonat rurale (kryetarët e fshatrave dhe kryesia e fshatrave). Përfshirja e rinisë në këto struktura komunitare do jetë vendimtare për rritjen e aktivizimit qytetar. Prioritet do të jetë edhe rritja e përfaqësimit të grave dhe vajzave në strukturat qeverisëse vendore në nivel përfaqësues dhe ekzekutiv. Do të nxitet gjithashtu përfshirja e minoriteteve në vendimmarjen publike në nivel vendor dhe forcimi i planeve të veprimit për respektimin e të drejtave të njeriut dhe minoriteteve.
- Fuqizimi i administratës vendore. Qëllimi kryesor në ecurinë e reformës së administratës publike në nivel vendor do të jetë konsolidimi i një administratë vendore të çburokratizuar, të paanshme politikisht, profesioniste dhe transparente. Ajo do të jetë e gatshme t'i përgjigjet pritshmërvive të komuniteteve dhe biznesit për shërbime publike, e aftë që të përballojë sfidat e integrimit evropian të vendit dhe thithjen e fondeve të BE, duke respektuar gjithmonë standartet, të cilët janë njëkohësisht edhe priorititet e reformës së administratës publike në nivel vendor.
- Përmirësimi i marrëdhënieve ndërinstolucionale midis qeverisjes qendrore dhe asaj vendore. Do të ndërtohen mekanizmat formalë dhe funksionalë të dialogut ndërinstacional midis qeverisë qendrore dhe asaj vendore. Vendimmarja me ndikim në qeverisjen vendore do të jetë më gjithëpërfshirëse dhe do të merret duke u konsultuar më parë me përfaqësuesit e qeverisjes vendore. Nga ana tjetër, do të

forcohet bashkëpunimi institucional me shoqatat e të zgjedhurve vendorë dhe organizata të tjera të shoqërisë civile.

- Qeverisja vendore dhe integrimi ne BE Integrimi evropian është një synim strategjik i Shqipërisë. Në këtë kuadër synohet që qeverisja vendore si pjesë e administratës publike të kontribuojë në arritjen e objektivave të integrimit evropian duke zbatuar standarde dhe përvojat e mira të BE-së në nivel vendor si dhe duke rritur kapacitetet për të aplikuar në projekte të finançuara nga fondet e BE-së. Në kuadrin e bashkëpunimit rajonal, edhe njësitë e qeverisjes vendore do të kontribuojnë për forcimin e këtij bashkëpunimi me njësitë simotra në vendet fqinje dhe në kuadrin e programeve ndërkufitarë dhe ndërr-rajonale.

Objektivat specifike të Strategjise Kombëtare Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore 2015-2020 janë:

- Konsolidimi administrativ dhe financiar i 61 bashkive të reja pas miratimit të ligjit të ri për ndarjen administrativo-territoriale;
- Mbështetja institucionale dhe infrastrukturore për 12 qarqet dhe 61 bashkitë e reja pas zgjedhjeve vendore të vitit 2015.

1.2.10. Parashikimet qe rrjedhin nga Strategja Ndersektoriale e Mjedisit 2015-2020

Vizioni i Strategjise eshte "Shqiperia - vend me një zhvillim të qëndrueshem social dhe ekonomik, duke mbrojtur burimet natyrore nga ndotja dhe degradimi, nëpërmjet menaxhimit të integruar të tyre dhe duke promovuar vlerat mjedisore e duke i vendosur ato në perfitim të prosperitetit ekonomik". Politikat mjedisore gjatë periudhës 2015 -2020 do të fokusohen në:

- Përmirësimin e cilesise se ajrit dhe reduktimin e ndotjes;
- Parandalimin e integruar te ndotjes dhe rreziqeve nga aksidentet industriale;
- Menaxhimin e integruar të mbetjeve, trajtimin brenda standardeve dhe rritjen e ndërgjegjes sociale mbi efektet e dëmshme në mjesi;
- Ngritjen e Sistemit Kombtar te Menaxhimit te Kimikateve;
- Mbrojtjen dhe menaxhimin e qëndrueshëm të biodiversitetit,
- Shtimin e sipërfaqes së zonave te mbrojtura, menaxhimin e integruar te tyre dhe ngritjen e rrjetit ekologjik "NATURA 2000";
- Adaptimin ndaj ndryshimeve klimatike dhe reduktimit te gazeve me efekt serre;
- Administrimin e burimeve ujore duke reduktuar ndotjen e ujerave nentokesore dhe sipërfaqesore, demtin e ekosistemeve ujore, si dhe zvogelimin e efekteve nga permbytja dhe thatesira;
- Mbrojtjen e ujerave detare, menaxhimi i ujerave nderkufitarë;
- Mire-administrimin dhe zhvillimin e burimeve pyjore dhe kullosore duke rritur sipërfaqet pyjore dhe aftësinë ripërtëritëse të tyre,
- Mbrojtja e shtresave te tokës dhe e biodiversitetit;



Objektivat e politikave ndërsektoriale të mbrojtjes së mjedisit janë:

- Transpozimi i plete i legjislacionit european ne fushen e mbrojtjes se mjedisit;
- Rritja me 43% e numrit te stacioneve te monitorimit te ajrit urban deri ne vitin 2020.
- Reduktimi i niveleve kombetare te NOx 15%, te PM10 me 25%, te PM2,5 me 25% dhe te ruhen nivelet e SO2 brenda viti 2020 krahasuar me nivelet e viti 2011 perkatesisht: per NOx - 40 µ/ m³, per PM10 - 83 µ/ m³, te PM2,5-33 µ/ m³ dhe SO2-8 µ/ m³.
- Reduktimi i ndotjes akustike me 20% ne zonat kryesore urbane, krahasuar me vitin 2012 (vlerat mesatare të zhurmës gjatë periudhës së ditës te reduktohen nga 70 dB (A) ne 56 dB (A) dhe vlerat mesatare të zhurmës gjatë periudhës së natës te reduktohen nga 55 dB ne 45 dB.
- Garantimi i perputhshmërisë së plete të operatoreve të medhenj industrial, me normat e shkarkimeve ne ajer (PM10, SO2, NOx) dhe uje sipas keresave te ligjit Nr. 10448 datë 14.7.2011 "Per lejet mjedisore", i ndryshuar dhe standardeve te percaktuara ne direktivave IPPC dhe LCP, krahasuar me vitin 2013.

Ne fushen e mbetjeve synohet që të arrihet:

- Ulja me 45% e sasise se per gjithshme te mbetjeve që shkojnë në landfill;
- Riciklimi i mbetjeve urbane në masën 55%,
- Hartimi i planeve rajonale të menaxhimit të mbetjeve dhe zhvillimi i landfilieve rajonale

Ne fushën e **ndryshimeve klimatike**, synohet që të ulet me 16% niveli i emetimit të gazrave serë deri në vitin 2020 krahasuar me vitin 2011. Te reduktohet konsumi i hidro-klorflorkarboneve (HCFC) me 35% ne vitin 2020 krahasuar me vitin 2011;

Ne fushën e **mbrojtjes se natyrës** synohet rritja e siperaqes së zonave te mbrojtura te territorit tokesor me 17 % deri ne vitin 2020 si dhe permiresimi i statusit te ruajtjes per 5 % te llojeve dhe habitateve te kercenuara te mbrojtura deri ne fund te kesaj dekade si dekada e Kombeve te Bashkuara per biodiversitetin 2011-2020.

Ne fushën e pyjeve dhe kullotave, synohet menaxhimi i qëndrueshëm i burimeve pyjore dhe kullosore, gjithperfshirja e aktorve lokale ne menaxhimin dhe zhvillimin e qendrueshem te ketij sektori, vendosja e skemave per pagesa ne ekosistem, forcimi institucional dhe ligjor

Përmirësimi i organizimit e procesit të prodhimit pyjor për pyjet e lartë, me objektiv formimin e njësive te reja territoriale te prodhimit për pyjet e larte prodhues.

- Realizimit i planeve te mbarështimit për 10 njesi te tillë prodhuese dhe te gjithë sipërfaqen e fondit pyjor dhe kullosor prej 1 700 000 ha, azhornimi i Kadastrës Kombëtare te Pyjeve dhe Kullotave,
- Rehabilitimi nëpërmjet pyllëzimit dhe ripyllëzim te sipërfaqeve te djegura si dhe rehabilitimin e kullotave me mbjellje foragjere e drusore në masën deri 15 % te sipërfaqes pyjore dhe kullosore deri ne vitin 2020.
- Parandalimit te gërryerjes se mëtejshme te tokës pyjore dhe kullosore ne 25 % te sipërfaqes, deri ne 2020.
- Brenda viti 2020 ne legjislacionin kombëtar te arrihet transpozimi i plete i plete (100 %) i legjislacionit european, ne fushën e pyjeve krahasuar me 50 % ne vitin 2011; Sigurimi i kuadrit rregulator, institucional dhe ekonomik për zbatimin e menaxhimit te qëndrueshëm te pyjeve.

- Sigurimi i te drejtave tradicionale te përdorimit/pronësisë mbi pyjet, duke vendosur mekanizma për reduktimin e prerjeve ilegale dhe tregtimit te lendes drusore, në masën 100 % si dhe parandalimi i zjarreve ne masën 80 % te sipërfaqes se rrezikuar, krahasuar me 50 % si dhe parandalimi i zjarreve ne masën 37 % te sipërfaqes se rrezikuar në vitin 2011.
- Rritja e efektivitetit ekonomik dhe e eficiencës energjetike nga përdorimi i qëndrueshëm i pyjeve shtetërore, rritjen e sipërfaqes pyjore nëpërmjet pyllëzimit dhe ripyllëzimit me arrore e pyjore ne masën 15% të sipërfaqes me bimësi pyjore dhe djerr, ngritja e një fidanishte pyjore për sigurimin e 4 000 000 fidanëve arrore e pyjor për mbjellje. Kryerja e punimeve silvikulturore për përmirësimin e grumbujve pyjor me ndërhyrje ripërtëritëse për 30000 ha pyje.
- Përmirësim kullotash duke realizuar deri 80% te sipërfaqes se planifikuar. Forcimi i kapaciteteve për menaxhimin e qëndrueshëm dhe shumë funksional të fondit pyjor dhe kulloso ne masën 100%.
- Vendosja deri ne vitin 2020 te sistemit te shërbimeve ne ekosistem dhe adaptimi kundrejt ndryshimeve klimatike ne masën 100%.
- Realizimi i data bazën pyjore (GIS), hartimi dhe miratimi i planeve mbarështimit për 100% të fondit pyjor dhe kulloso krahasuar me vitin 2011 që është 50%, azhurnimi i të dhënave të tyre duke realizuar 100% të objektivit si dhe krijimi i njësive territoriale me funksion prodhues dhe menaxhimi i integruar i tyre nëpërmjet teknikave te avancuara. Forcimi i sistemit të kërkimit, zhvillimit teknologjik dhe inovacionit në pyje.
- Vendosja e marrëdhënieve rajonale e me gjere, për shkëmbimin eksperiencave, aplikime te përbashkëta ne programe ndërkombëtare dhe unifikimin e teknologjive e metodologjive ne masën 80%. Sigurimi i mekanizmave financiare për të përmirësuar statusin e pyjeve dhe zhvillimin e sektorit te pyjeve.
- Vazhdimin e procesit permbylles te transferimit te pyjeve dhe kullotave tek organet e qeverisjes vendore drejt kalimit tek komunitetet te te drejtave te plota mbi përdorimin (uzufrukt), proces i cili rrit rolin e pushtetit vendor ne planifikimin dhe menaxhimin e burimeve natyrore pyjore e kulloso". Dhenia e asistences teknike dhe ligjore nepermjet shërbimit keshillimor per ngritjen e strukturave menaxhuese te pyjeve dhe kullotave ne komune (250 komuna). Perfundimi I procesit te regjistrimit te pyjeve komunale ne AKKP.

Arritjen e nje ekilibri te qendrueshme midis resurseve ujore te gjalla dhe shfrytezimit te tyre nga subjektet e peshkimit me qellim qe gjendja e resurseve te mbetet e qendrueshme dhe ne raport te drejt me numrin e anijeve dhe subjekteve te peshkimit. permiresimit te infrastruktureve mbeshtetese ne peshkim dhe menaxhimin e saj; forcimit te konkurencës dhe luftes ndaj informalitetit dhe zhvillimit ekonomikisht te qendrueshem te subjekteve ne kete sektor; permiresimit te furnizimit te tregut dhe rritjes se vleres se prodhimeve te peshkimit dhe akuakultures; ne rigjallerimin e zonave qe varen nga peshkimi dhe akuakultura; sektori i peshkimit shqiptar te arrije nivelet e zhvillimit te vendeve te BE

- Hartimi i akteve te tjera ligjore e nenligjore, per plotesimin i kuadrit te nevojsphem ligjor ne pergjigje te situatave dhe problematikave qe dalin.
- Forcimi i bashkepunimit me shtetet nderkufitare, qe kane si ekosistem te perbashket detar detet Adriatik e Jon (Pellgu i Mesdheut).



- Ndertimi i 4 merkatove me shumice ne portet e peshkimit, me qellim rritjen e cilesise se prodhimit, vleres se prodhimit dhe luftes ndaj tregut informal, per rritjen e shkalles se konkurences.
- Zgjerimi i porteve egzistues, ndertimi i bankinave te ankorimit te anijeve te peshkimit ne Vlore, Sarande dhe Shengjin si dhe perfundimi i ndertimit te Portit te Ri te Peshkimit ne Durres
- Ngritja e infrastrukturave (shkallev) te riparimit, mirembajtjes te anijeve te peshkimit ne te kater portet e vendit, me qellim rritjen e treguesve te gadishmerise teknike dhe te shfrytezimit ne peshkim te flotes. Permiresimi i ketyre tregueseve te rendesishem ekonomiko-financiare do te çoje ne rritjen e ndjeshme te zenies se peshkut dhe uljen e kostove te prodhimit
- te cilat do ta bejne ate konkurues ne tregun e brendeshem dhe ate rajonal.
- Rritja e shkalles se kualifikimit te peshkatareve, specialisteve, kapiteneve te anijeve, brigadiereve, motoristeve, rrjetapunues etj. Kjo do te realizohet mbi bazen e nje programi te caktuar prane Shkolles se Mesme ne Durres te rikonstruktuar rishtas, si dhe ne kursin me cikel 9 mujor i atashuar prane kesaj shkolle. Specialistet e larte navigator do te vazhdojne te pergaten ne Universitetin e Vlores. Per specialitete te vecanta si ihtiolog, akuakultor, mikrobiolog, armatore anijesh etj. do te synohet perqatitja e tyre ne Universitetet vendase dhe te huaja.
- Perfundimi i ndertimit te Portit te Ri te Peshkimit ne Durres si dhe ndertimi i nje shkalle per riparimin e anijeve te peshkimit.
- Mundesa e financimit per kompensimin e TVSH se çmimit te naftes per anjet e peshkimit.
- Plotesimi i kuadrit te ri ligjor per akuakulturen se bashku me aktet nenligjore
- Forcimi i bashkepunimit rajonal dhe nderkombetar
- Forcimi i konkurences dhe luftes ndaj informalitetit dhe zhvillimit ekonomikisht te qendrueshem te subjekteve te sektorit te akuakultures dhe ujerave te brendshme;
- Permiresimi i aspekteve te tregetimit, certifikimit dhe rritjes se vleres se prodhimeve te akuakultures;
- Ne rigjallerimin e zonave qe varen nga akuakultura ku sektori i akuakultures shqiptare te arrije nivelet e zhvillimit te vendeve te te perparuara te BE ne kete fushe.

Ne fushen e ujerave synohet qe brenda vitit 2020 te arrihet transpozimi i plete 100% i legjizacionit europian ne legjizacionin kombtar ne fushen e ujerave; Miratimi i marreveshjeve te perbashketa me te gjithe vendet kufitare per permiresimin e menaxhimit te rezervave ujore te perbashketa deri ne vitin 2013; Reduktimi i lejeve te shfrytezimit te inerteve lumore deri ne vitin 2014 me 100 % duke lene vetem ato per nevoja te ndertimit te rrugeve kombetare deri ne vitin 2020; Rehabilitimi i shtreterve te demtuar te lumenjeve me 25 % deri ne vitin 2020 krahasuar me vitin 2011; Mbrojtja dhe permiresimi i cilesise se ujerave sipas legjizacionit te transpozuar ne fuqi;forcimi i menaxhimit te basenve lumore nepermjet zbatimit te planeve te menaxhimit 100 % deri ne vitin 2020)

1.2.11. Parashikimet qe rrjedhin nga Strategja Kombëtare e Turizmit 2019 – 2023

Ekonomia turistike po konturohet gjithnjë e më shumë si një nga deget kryesore të zhvillimit ne Shqipëri. Sipas te dhene zyrtare, kontributi total i turizmit ne Shqipëri përbën rreth 26.2% të PBBsë, duke e pozicionuar këtë sektor si një ndër kontribuesit kryesor të zhvillimit të ekonomisë kombëtare. Po ashtu, në sektorin e turizmit janë punësuar rreth 7.7% e të gjithë forcës së punës në Shqipëri, ndërkokë që deri në 2028 parashikohet që ky numër të rritet në nivelin 8.8 %. Referuar raportit të Këshillit Botëror të Udhëtimit dhe Turizmit (WTTC), parashkohet qe investimet në këtë sektor deri në 2028 të rriten në nivelin 8,2% te PBB'se kombetare.

Megjithatë, zhvillimi i turizmit në Shqipëri është ende larg potencialit aktual, i ndikuara kryesisht nga problematika qe lidhen me infrastrukturën, kapacitetet akomoduese, cilësinë e shërbimeve, etj. Keto elemente kane bere qe zhvillimi deri tani i turizmit ne Shqipëri te kete qene kaotik dhe i pakontrolluar, duke rezikuar qëndrueshmërinë e tij në terma afat-gjatë.

Aktualisht, zhvillimi i turizmit ne Shqipëri klasifikohet ne profilet si ne vazhdim:

- Turizmi bregdetar – përfshin turizmin bregdetar dhe turizmin detar.
 - Turizmi bregdetar - i referohet aktiviteteve që zhvillohen në buzë të detit si noti, banjot e plazhit dhe aktiviteteve të tjera rekreative të lidhura
 - Turizmi detar – i referohet aktiviteve që zhvillohen në det, ku përfshihen lundrimi turistik (yachting, sailing, cruising), portet turistike si dhe sportet detare.
- Turizmi natyror –Shqipëria ofron mundësi te medha për zhvillimin e turizmit rural, malor, ekoturizmit dhe veprimtarive në natyrë. Këto te fundit përfshijnë aktivitete si rafting, hedhje me parashutë sportive, çiklizmi malor, peshkimi, trekking, ngjitjet alpinistike, ecja në natyrë-hiking, shëtitja me kuaj, turet studimore, etj.
- Turizmi tematik – Perfshin forma specifike të turizmit, si agroturizmi, turizmi i eveneteve dhe biznesit, turizmi kulturor (trashëgimi, histori, besim etj), turizmi eno-gastronomik dhe turizmi shëndetësor (termal, mirëqënies dhe mjekësor) etj. Ketu duhet theksuar potenciali qe paraqet trashëgimia arkeologjike dhe kulturore ne rritjen e prurjeve turistike, me destinacione si Shkodra, Lezha, Kruja, Durrësi, Tirana, Fieri, Berati, Elbasani, Korça, Përmeti, Gjirokastra, Saranda dhe Vlora.

Sfidat kryesore të industrisë së turizmit ne Shqipëri, te identifikuar nga kjo strategji janë:

- **Krijimi dhe permiresimi i aksesit dhe i infrastrukturave mbeshtetese** në destinacionet turistike, si rrjetet e ujesjellesave dhe kanalizimeve, furnizimi me energji elektrike, interneti, etj. Nje element i rendesishem qe mbeshtet zhvillimin e turizmit eshte transporti publik dhe aksesi i tij në destinacionet turistike. Nderkohe duhet permendur zhvillimi dhe promovimi i infrastrukturës turistike detare, që nga marinat, komplekset e sporteve ujore e dimërore, golfit, qendrat e turizmit të aventurës, etj.
- **Standardizimi dhe certifikimi i strukturave akomoduese dhe shërbimeve të tjera turistike** – ky element ka te beje me garantimin e nivelit te cilësisë së operatorëve turistike



dhe shërbimeve të ofruara prej tyre, si dhe rregullimin e tregut të turizmit duke nxitur tërheqjen e markave ndërkombëtare të hotelerisë e operatorëve turistikë.

- **Promovimi i një produkti të integruar turistik dhe përmirësimi i imazhit të vendit** – synon kombinimin e atraksioneve dhe aktivitetave turistike në produkte turistike të konsoliduara. Kjo lidhet edhe me promovimin e Shqiperise një destinacion turistik i sigurt e mikpritës, me një ofertë turistike të konsoliduar e me produkte autentike.
- **Rritja e cilesise dhe kapaciteteve te burimeve njerëzore në turizëm** – ka te beje me nevojen e ngritjes se një sistemi eficient të formimit profesional për punonjësit e angazhuar ne industrine turistike, si element thelbësor ne ofrimin e produkteve cilesore dhe terheqese;

Vizioni i Zhvillimit te Turizmit sipas Strategjise Kombetare te Turizmit 2019-2023 “**Shqipëria si një destinacion mikpritës, tërheqës, autentik për zhvillimin e potencialeve ekonomike, natyrore dhe sociale të vendit**”. Realizimi i ketij vizioni zberthehet nepermjet katër qëllimeve strategjike, të cilat jane:

1. **Krijimi i poleve (clusters) dhe industrive të reja të zhvillimit si dhe konsolidimi i ofertës turistike dhe krijimi i produkteve të reja** – propozon krijimin e 6 poleve të integruar me potencial turistik, që do të fokusojnë ndërhyrjet e investimeve publike ne te gjithe territorin e vendit, duke zgjeruar shtrirjen gjeografike të destinacioneve, si dhe duke rritur kohe qendrimin per gjate gjithe vitit. Gjithashtu, propozohet përmirësimi i cilësisë së strukturave akomoduese duke mbështetur edhe rigjenerimin e atyre ekzistuese e nxitor investime të reja në struktura më 4-5 yje;
2. **Rritja e vlerës së shtuar dhe e impaktit të sektorit në ekonomi dhe punësim** – synohet që, përmes prioritizimit të investimeve publike dhe nxitjes së investimeve private, tërheqjes së një numri më të madh të turistëve dhe rritjes së netëqendrimeve;
3. **Zhvillimi i produkteve dhe shërbimeve të reja në turizëm, si dhe përmirësimi i cilësisë së tyre** – Synon ne standardizimin dhe çertifikimin e ofruesit e shërbimeve turistike, përmes ngritjes së një sistemi të formimit të vazhdueshëm profesional për gjithë burimet njerëzore në industrinë e turizmit.
4. **Përmirësimi i imazhit të vendit dhe promovimi i produkteve autentike lokale** – Qëllimi eshte ne promovimin e pasurive natyrore, historike e kulturore të Shqipërisë, duke përmirësuar imazhin ndërkombëtar të vendit e duke tërhequr më shumë vizitorë.

Për realizimin e qëllimeve strategjike të sipër-përmendura, Strategjia Kombetare e Turizmit 2019-2023 percakton pesë Objektiva të Politikës, si me vijon:

Objektivi Politik 1: Nxitja e Investimeve Publike dhe Private;

- a) Nxitja e Investimeve Strategjike Private si dhe tërheqja e markave të mirënlohura ndërkombëtare në hoteleri dhe turizëm.
- b) Përcaktimi i zonave me përparësi zhvillimin e turizmit dhe orientimi i investimeve private drejt tyre.
- c) Orientimi i investimeve publike drejt zonave me përparësi zhvillimin e turizmit dhe destinacioneve turistike për përmirësimin e infrastrukturës bazë në to.

Strategjia Territoriale e Bashkisë Tepelene duhet te synoje ne identifikimin e territoreve dhe formave potenciale te investimeve me natyre turistike në territorin e administruar. Kjo duhet

te kryhet pas një analize te thelluar te karakteristikave fizike dhe natyrore te territoreve te klasikuara ne Sistemin Natyror dhe Ujor, duke propozuar keshtu se çfare lloj produktesh turistike mund te akomodohen. Keto propozime duhet te nderthuren me veçorite dhe shtrirjen e Sistemit Urban, per te mundesuar keshtu zhvillime te balancuara dhe investime turistike qe kane efekte pozitive ne territoret e banuara qendrore apo edhe periferike.

Objktivi Politik 2: Konsolidimi dhe Zhvillimi i Produkteve Turistike;

- Zhvillimi i modeleve të reja të vlerësimit, standardizmi, çertifikimi dhe klasifikimi i shërbimeve në funksion të turizmit dhe operatorëve turistikë.
- Krijimi i Kuadrit Rregulator dhe Institucional për zhvillimin e arsimit profesional dhe kualifikimet në turizëm, si dhe trajnimi i burimeve njerëzore të angazhuara në sektor.
- Hartimi i kuadrit rregulator dhe institucional për zhvillimin e shërbimeve dhe mënyrën e operimit të Porteve Turistike dhe aktiviteteve në funksion të tyre

Edhe pse ky objektiv lidhet kryesisht me zhvillime dhe iniciativa rregulatorre ne nivelin qendror, zhvillimi perspektiv i turizmit ne Bashkine Tepelene duhet te bazohet ne sisteme te gendrueshme administritimi vendor. Keto sisteme, te cilat mund te perfshihen edhe ne strukturen administrative te Bashkise, duhet te jene perqejese per vleresimin dhe monitorimin e vazhdueshem te standardeve te produktit turistik qe ofrojne territoret nen administrim. Keto sisteme do te evitonin ne kete menyre, fenomenet tipike te zhvillimit kaotik dhe te pakontrolluar te sektorit te turizmit, te evidentuara si problematika tipike edhe ne nivel kombetar, dhe pikerisht ne dokumentin e Strategjise Kombetare te Turizmit 2019-2023.

Per zhvillimin e ketyre sistemeve te administritimit dhe monitorimit te sektorit te turizmit ne territorin e Bashkise Tepelene, Strategjia Territoriale propozon referencimin ne kuadrin rregulator kombetar, dhe konkretisht Udhezuesin perkates te Ministrit se Mjedisit dhe Turizmit qe trajton elementet si vijojne:

- **Klasifikimi i strukturave akomoduese**
- **Sherbimi – Agjenci udhetimi**
- **Sherbimi – Operator turistik**
- **Sherbimi – Udherrefyes turistik**
- **FAQ Udherrefyesi Turistik**

Objktivi Politik 3: Përmirësimi i Shërbimeve Turistike;

- Zhvillimi i Programit të Turizmit Bregdetar e Detar dhe krijimi i produkteve të reja.
- Zhvillimi i Programit të Turizmit Natyror dhe krijimi i produkteve të reja
- Zhvillimi i Programit të Turizmit Tematik dhe krijimi i produkteve të reja.

Objktivi Politik 4: Ri-orientimi i Promovimit drejt Potencialeve;

- Hartimi i Strategjisë së Brandit dhe Marketingut të Turizmit.
- Promovimi i Produkteve Turistike gjithëvjetore brenda dhe jashtë vendit.
- Mbështetja e Agjentëve Promovues të vendit në Shqipëri dhe Diasporë

Objktivi Politik 5: Mbështetje për Menaxhimin e Destinacioneve.

- Zhvillimi i modelit të Menaxhimit të Destinacioneve.



- b) Konsolidimi i kuadrit ligjor dhe institucional për menaxhimin dhe operimin e Organizatave të Menaxhimit të Destinacioneve.
- c) Monitorimi dhe Mbështetja e Organizatave të Menaxhimit të Destinacioneve

1.3. Permbledhje e Analizës së përgjithshme të territorit

Qëllimi kryesor i kesaj analize është vleresimi i gjendjes aktuale ekzistuese të të gjithë komponenteve perberes te territorit te Bashkise Tepelene si dhe parashtrimi i rekomandimeve përkatese specifike drejt një përdorimi sa më të mirë të sistemeve. Kjo Analize shërben si kontesti baze mbi te cilin formulohet Vizioni i Zhvillimit.

1.3.1. Bashkia Tepelenë – të dhëna të përgjithshme

E krijuar në vitin 2015, pas miratimit të Reformës se re Administrative Territoriale, Bashkia Tepelenë shtrihet në pjesën jug-perëndimore të Shqiperisë, pjesë e Qarkut Gjirokaster. Ka një sipërfaqe prej 431.24 km² dhe kufizohet në Veri me Bashkinë Memaliaj, në Lindje me Bashkinë Këlcyre, në Jug me Bashkinë Gjirokastër si dhe në Perëndim me Bashkitë Himarë dhe Selenicë. Qendra e saj administrative është qyteti i Tepelenës, ku gjenden edhe institucionet kryesore.

Në përbërje të kësaj Bashkie ndodhen 4 njësi administrative: Tepelenë, Qendër Tepelenë, Lopës dhe Kurvelesh, ndërsa fshatrat nën administrim janë si në vijim:

1. **Njesia Administrative Tepelenë** – Qytet Tepelenë
2. **Njesia Qendër Tepelenë** -Dukaj, Salari, Turan, Mamaj, Veliqot, Bënçë, Dragot, Beçisht, Mezgoran, Peshtan, Hormovë, Lekël, Kodër, Luzat
3. **Njesia Administrative Lopës** -Sinaj, Matohasanaj, Dorëz, Dhëmlan, Lab Martaloz
4. **Njesia Administrative Kurvelesh** -Progonat, Lekdush, Gusmar, Nivicë, Rexhin

Sipas Censusit të vitit 2011, Bashkia ka një popullsi prej 8.949 banorësh dhe me densitet 12.1 banore/km². Ndërkohë që sipas Regjistrat Civil, kjo bashki numëron 16.371 banorë me një densitet prej 37.96 banorë/km².




Fig. 9 Harta Administrative – Bashkia Tepelene

1.3.2. Karakteristikat kryesore natyrore te Bashkise Tepelenë

Tiparet fizike te territorit

Morfologjia e territorit te Bashkise Tepelene është malor në pjesen derrmuese te tij, i përshtuar nga lumenjtë e Drinosit dhe Vjosës, te cilet bashkohen ne dalje te grykes se Dragotit. Ne pernjithesi ngritjet e reliefit, si ato malore dhe ato kodrinore, ruajnë orientimin e përgjithshëm albanid nga Juglindja në Veriperëndim. Në relieving malor dallohen qafat e larta, me forma të rregullta erozionale, të cilat përfaqësojnë monumente natyrore me vlera gjeoshkencore. Ne pernjithesi gjinden formacione gjeologjike me permbytje gelqerore.





Fig. 10 Korridori i lumbit të Bënçës, ku evidentohet reliivi i thyer malor i Bashkise se Tepelenës

Terrenet ne perendim te territorit te Bashkise jane pjesa e masivit te Krahines Malore Jugore te Shqiperise, te cilat formojne nje pengese natyrore per lidhjen e Tepelenes me Vloren, Himaren si dhe zonat e tjera te banuara te Rivieres. Pika me e larte e masivit malor ne perendim te Vjoses, si dhe e gjithe territorit te Bashkise Tepelene, eshte mali i Këndrevicës, pjesa e vargmalit te Gribës, me nje lartesi prej 2121 metra. Masivi i vargmalit perfshin rrith 3/4 te gjithe territoreve te Bashkise Tepelene, e cila perfaqeshet nga mjaft shpate malore, gryka, qafa etj, te karakterizuara nga forma te rregullta erozionale. Lartesia mesatare mbi nivelin e detit është 732 mbi nivelin e detit.

Karakteristikat kryesore gjeologjike

Tepelena ka karakteristika gjeo-morfologjike kodrinore ku mbizotëron reliivi kodrinoromalor. Litologja përfaqësohet më së shumti nga gëlqerorët, të cilat herë shfaqen pllakë e herë masive kompakte.

Bazuar në hartën gjeologo-inxhinierike te Sherbimit Gjeologjik Shqiptar, shkëmbinjtë territor-formues në Bashkinë e Tepelenes klasifikohen në:

- Flishe ritmike
- Mollasa argjilore
- Granite
- Mollasa ranoro-konglomeratike

Nderkohe, territoret e Bashkise që përshkohen nga lumi Drinos dhe Vjose kanë përbërje shkëmbore të tipit subargjilor të vendosur mbi zhavorret. Analiza gjeoteknike e territorit te

Bashkise Tepelene identifikon përhapje te gjere te shkëmbinjve dhe dherave me litologji të ndryshme, të moshave nga Triasiku e deri në Kuaternar




Fig. 11- Harta gjeolo-gjuetore e bashkise Tepelene

Nga pikëpamja tektonike kemi të bëjmë me zonë tektono-strukturore, e cila preket nga forcat tektonike orogenike. Shkëputjet tektonike janë shumë aktive, dhe në relief shprehen me kontraste të theksuara. Pasojë e tyre janë dhe lëvizjet e shpeshta sizmike, që trondisin zonën. Si pjesë përbërëse e një strukture neogenike në zhvillim, zona e Tepelenes preket nga forcat tektonike orogenike dhe sidomos nga ato neotektonike.

Burimet ujore

Resurset ujore sipërfaqësore në kete territor janë të lidhur kryesisht me lumenjtë Vjose, Drino si dhe lumi i Bençës.

Vjosa - është lumi më i madh i Shqipërisë Jugore dhe një ndër lumenjtë më të mëdhenj të Shqipërisë. Buron nga malet e Pindit (Greqi) ku rrjedh nëpër një lugine të thellë e cila zgjerohet pasi hyn në territorin tonë. Ka një gjatesi prej 272 km, dhe një pellg ujëmbledhës me sipërfaqe totale prej 6706 km². Ne territorin e Shqiperise, pellgu i Vjosës llogaritet ne 4365 km². Në Vjosë ose në degët e saj tributare përfundojnë edhe shumë burime karstike si ato të grykës së Këlcyrës, të Libohovës, të Viroit, të Gjirokastrës, të Ujit të Ftohtë të Tepelenës, të Poçemit etj. Prurja e ngurtë në derdhje arrin 212 kg/sek, turbullira mesatare 1087 gr/m³ dhe moduli i aluvioneve 997 ton/km² në vit.

Ne territorin e Bashkise Tepelene ndodhet edhe një nga tre stacionet e monitorimit te prurjeve te lumbit Vjose, që eshte stacioni tek ura e Leklit.





Fig. 12-Panje panoramike e lumit Vjose qe rrjedh ne prane qytetit te Tepelenes

Drinos – Bashkia Tepelene perfshin vetem një seksion te vogel te shtratit te lumit Drinos, dhe pikërisht pike takimin e tij me lumin e Vjosës. Lumi pershon krejt fushën e Dropullit, duke mbledhur rruge ujërat e degëve të tij kryesore si: Kseria, Kardhiqi e Suha si dhe përrrenjtë e përkohshëm e të rrëmbyeshëm që zbresin nga vargu i maleve e që rigrihen në të dy anët e saj. Gjithashtu lumi Drinos ushqehet me ujë edhe nga një burim i quajtur Viroi i Gjirokastrës

Lumi i Bënçës – eshte një lume i shkurter, i cili merr uje nga burimet dhe perrenjte e shumte qe e kane originen nga Malësia e Kurveleshit, dhe konkretisht nga perrenjte e Malit te Thate si perroi i Hecatit, përroi i Kalinorit, perroi i Shkozës, Zagonit, per te vazhduar me pas me perrenjte qe rrrjedhin midis Këndrevicës dhe malit te Bejkës, si përroi i Madh, i Miroxixës, perroi i Kozices, etj. Keto perrenj bashkohen ne përruin e Gurës, per tu derdhur me pas ne Lumin e Bënçës. Per shkak te formacionit gjeologjik, përrrenjte kane formesuar një relief te thyer dhe te eroduar, me gryka te ngushta dhe te thella. Tipike ne te kete rast eshte Kanioni i Nivicës me një thelli qe shkon deri ne 700 metra, nderkohe qe gjeresia mesatare eshte 15m.

Klima

Sipas rajonizimit klimatik te Institutit Hidrometrologjik te Akademise se Shkencave, territori i Bashkise Tepelene perfshihet ne nen-zonen jugore te zones me klime mesdhetare paramalore, me dimër te forte me reshje dhe verë e ngrohtë e thatë. Tiparet mesdhetare pasqyrohen qarte ne temperature, karaktertin e çrregullt te rreshjeve, radiacionin diellor dhe elementet e tjere klimatetik. Bashkia e Tepelenes ka rreth 2,100- 2,300 orë në vit me diell dhe, në përgjithësi, ka erëra me shpejtësi të madhe. Temperatura mesatare vjetore është rreth 14°C.




Fig. 13 - Harta E Rreziqeve Gjeologjike Bashkia Tepelene/Harta e Rreziqeve Gjeologjike Bashkia Tepelene

Temperatura maksimale vjetore gjatë ditës është rreth 29.2°C , ndërsa ajo minimale është 4.1°C . Zona e Tepelenes është një nga zonat më të nxehta të vendit, ku temperatura e ditëve të nxehta mund të arrijë edhe $42-45^{\circ}\text{C}$, ndërsa ajo e ditëve të ftohta të dimrit mund të shkojë rreth -7°C . Territori i bashkisë ka erëra me shpejtësi rreth 1.5 m/s dhe vetëm në pjesën perëndimore ka erëra që shkojnë nga 1.6 m/s deri në 2.0 m/s . Gjithashtu, bashkia e Tepelenes ka rreth $2,100\text{-}2,300$ orë në vit me diell. Reshjet mesatare në vit në këtë bashki varojnë nga 900 mm deri në $1,600 \text{ mm}$.

Toka

Toka bujqësore ne kete Bashki eshte e kufizuar e me një rendiment mesatar te ulet. Vetem gjate lumit te Vjosës dhe degezimeve kryesore shtrihen toka are te pershtatshme per grurë, miser, perime, etj. Nje pjese e tokave jane te dobeta, ndersa një pjese nuk ka sasine e nevojshme te ujtit gjate veres ose nuk vaditen. Tokat nen uje zene 80% te siperfaqes te tokave bujqësore te kultivuara, një shifer e mire per zonen kodrinore malore dhe mundesi per rritjen e rendimentit, si rezultat i burimeve të shumta ujore sidomos në zonën e ulet per gjate brigjeve te lumbrit Vjose.





Fig. 14 -Territore prane fshatit Luzat – reliivi i thyer i territorit te Bashkise krijon mundesine per zhvillimin e ekosistemeve te ndryshme natyrore

Habitatet dhe Biodiversiteti

Bashkia e Tepelenës është e pasur me bimësi, si në lloje ashtu dhe në shtrirje. Në të ndeshen nga brezi i shkurreve, qe shtrihet deri ne lartësinë 600-800 metra, brezi i dushkut 800-1200 metra, pyjet fletëgjere, halore e të përzier dhe deri në kullotat alpine me lartësi mbi 1000 m. Territori i Tepelenës ka pozicion gjeografik, relief si dhe veçori specifike qe favorizojne zhvillimin mjaft te madh e te shumellojshem te habitateve natyrore dhe te ekosistemeve komplekse malore qe ofrojne kushte per ekzistencen e shume lloje bimesh te larta ku veç te tjerash, spikatin mjaft lloje relike, endemike dhe subendemike.

Monumentet e Natyrës

- **Shpella Mëma e Ujit, Progonat** - një shpelle karstike te formuar ne gelqeroret ne afersi te fshatit Progonat, 1165 m mbi nivelin e detit;
- **Stera e Çikës** - ndodhet ne lindje te fshatit Gusmar, ne fundin e një hinke karstike, 890 m mbi nivelin e detit;
- **Shpella e Lek Petës** – prane kanionit te Nivicës;
- **Shpella e Ujit Dhëmbel** - ne afersi te fshatit Lekel, 970 m mbi nivelin e detit;
- **Vrima e Shkëmbit** - një shpelle karstike te formuar ne gelqeroret, ne afersi te fshatit Progonat, 1110 m mbi nivelin e detit;
- **Ujëvara e Progonatit** - ne lindje te fshatit Progonat;
- **Shpella e Kasarit** - ne juglindje te fshatit Progonat, ne shpatin e djathte te lugines se perroit;

- **Kanionet e Nivicës** - formuar nga erozioni në shkembinjtë karbonatike të perroit te Nivicës;
 - **Perroi i Nivicës** - poshte fshatit me te njejtin emer, ka formuar një gryke me shtrat tepër te ngushte, me gjatesi rreth 3 km;
 - **Lugjet e Dhëmblanit** - prane fshatit Dhemblan, krijuar mbi konet e depozitimeve te gureve sjella nga pjesa e siperme e shpatit te Malit te Gribës.
 - **Buza e Bredhit, Luzat** - perben një rrepire shkembore me lartesi disa qindra metra dhe gjatesi rreth 800 m.
 - **Rrapi i Selam Musait** – prane Kalase se Tepelenës
 - **Shpella e Mezgoranit** - prane fshatit Mezgoran, ne shpatin verior te Grykes se Kelcyres, rreth 850 m mbi nivelin e detit.
 - **Shpella e Leklit** - ndodhet ne afersi te fshatit Lekel, 400 m mbi nivelin e detit.
 - **Burimet e Ujit të Ftohtë** - pergjate rruges interurbane, ne jug te qytetit;
 - **Tarraca Erozive e Bençës** -pergjate lugines se perroit te Bences;
 - **Shkëmbi i Prerë, Dukaj** - ndodhet prane fshatit Dukaj te Bashkise Tepelene;
 - **Rrapi i Progonatit**
 - **Rrepeat e Ujit të Ftohtë** - gjendet ne te djathte re rruges automobilistike kombetare Tepelene-Gjirokaster, pak pas degezimit te rruges automobilistike per ne Permet.
 - **Lisat e Luzatit**
 - **Rrapi i Hormovës** - ne qender te fshatit Hormovë, me lartesi 20 m dhe diameter te trungut rreth 1,2 m.
 - **Parku Natyror I Zagorisë** – zone e mbrojtur, shpallur me VKM Nr. 354 më datë 02.05.2015. Përfshtin rreth 25 mijë hektarë ku përzihen peizazhe malore, fshatra të vegjël karakteristikë, monumente të trashëgimisë kulturore dhe natyrore dhe vlera të botës bimore dhe shtazore.

1.3.3. Karakteristika te zhvillimit urban te Bashkisë Tepelenë

Në periudhën para viteve 1990 vetëm 12,5% e territorit të tanishëm të Bashkisë së Tepelene ishte e urbanizuar. Deri në vitin 2007 sipërfaqja e zonave urbane arriti vlerën 18.25%, ku zgjerimi më i madh eshte shfaqur ne qytetin e Tepelenes. Duhet permendur fakti qe rritja aktuale urbane ne te gjithe territorin e Bashkise eshte thuajse in-ekzistente, per shkak te procesit te emigrimit.

Struktura urbane e qytetit te Tepelenes eshte e pozicionuar ne shpatin e kodres, me orientim nga lindja dhe qe kulmon me kalane e Ali Pashes. Qytetit ka siperfaqe totale prej 1,15 km², dhe nje strukture urbane te konceptuar ne breza te dukshem, ku shumica e ndertimeve jane banesa kolektive 4-5 kateshe, dhe me tarrace, te ndertuara para viteve 90. Nderkohe, jane ndertuar edhe elemente te rinj urbane, si pallate banimi mbi 5 kate apo njesi te reja sherbimi dhe argetimi. Qyteti ka nje rrjet rrugor te rikonstruktuar ne pjesen me te madhe te tij, si pasoje e investimeve te mundesuar nga Bashkia ne vitet e fundit.






Fig. 15 - Pamje ajrore me dron e qytetit te Tepelenes

Në zonat e banuara rurale, struktura e ndertuar është e patrajtuar prej vitesh. Më përjashtim te **Nivices** dhe **Peshtanit**, ne të cilat se fundimi janë finalizuar nderhyrje te rikualifikimit urban ne kuader te programit “100 fshatrat”, ne asnjë prej fshatrave te Bashkise Tepelene nuk mund te flitet per hapesire publike e menaxhuar apo e trajtuar ne aspektin urbanistik. Objektet e banimit janë 1-2 kateshe, me mure guri dhe çati me rrasa guri apo me tjegulla.




Fig. 16 - Pamje e rivitalizimit te qendres se fshatit Nivice, ne kuader te projektit “100 fshatrat”



Të dhëna historike te vendbanimit

Pozicioni gjeografik përgjatë lugines se lumit te Vjosës, ka bere te mundur ngritjen e shume vendbanimeve, te pozicionuara ne te dy krahet e lumit. Ne kete rreth, fale pozicionit gjeografik, ka pasur shume qendra te banuara, si vende banimi te hapura ne rajonet Dragot, Beçisht, Damës, ashtu dhe vendbanime te fortifikuara me mure masive.

Ne lashtesi, territori i Bashkise Tepelene bente pjese ne treven e Kaonise. Zona e Buzit (brenda pjeses administrative e Bashkise Memaliaj) lidhej me iliret e Antipatrese (Beratit), Krahesi me Bylynet (Mallakaster) dhe Lopesi me Amantinet (Plloca e Vlores). Ne fundin e shekullit te 9-te, Tepelena hyn ne Themen e Nikopojes pastaj ne Despotatin e Epirit. Ne shekullin e XVI, Tepelena bente pjese ne sanxhakun e Vlores.

Fillesa e qendres se Tepelenes perkon me ndërtimin e Kalase keshtjelle në shek IV-VI, të ngritur në kryqëzimin e rrugëve të Vjosës, grykës së Këlcyrës, Drinosit dhe Mallakastrës. Poshtë kështjellës ruhen gjurmë të një ure të madhe, pjesa e pare me harqe të shekullit të dytë. Pesë fazat e tjera janë ngritur nga shekulli VI deri XIX. Forma aktuale e Kalase u rindertua ne Kohen e Ali Pashe Tepelenes, ne vitin 1819, me tre hyrje dhe 3 kulla.


Perveç kalase se qytetit, ne territorin e Bashkise evidentohen edhe gjurme te tjera historike, si kalaja e Leklit, kalaja e Matohasanaj, Kalaja e Nivices, etj. Ndërkohe që një nga elementet me te forte historike te Tepelenes është edhe ujesjellesi i Bënçës,



Fig. 17 -Hyrja lindore e Kalase se Ali Pashe Tepelenes

Lista e monumenteve te kultures ne Bashkine Tepelene

- **Kalaja e Tepelenes** – perben dhe objektin me te rendesishem te trashegimise kulturore si dhe destinacion turistik ne Bashkine Tepelene;



- **Kalaja e Qytezës** – shtrihet mbi kodrën e quajtur “Qyteza” në veri të fshatit Dukaj, 300 m mbi nivelin e detit;
- **Kalaja e Leklit** – gjendet ne lindje të fshatit Lekël, 500m mbi nivelin e detit;
- **Kalaja e Matohasanajt** – ndodhet në majën e një kurrizi shkëmbor, i cili ngrihet në qëndër të luginës së Sinanajt, midis shtratit të lumit Vjosa dhe malit të Gribës;
- **Kalaja e Nivicës** – ndodhet në majën e një kodre në veri të fshatit Nivicë; tre anë të saj kodra rrrethohet nga kanionet e Kurveleshit dhe shpatet e saj bien thikë në përrrenj;
- **Kalaja e Zharrës** – ngrihet në majën te nje kodre shkëmbore, në perëndim të qytetit të Tepelenës, 310 metra mbi nivelin e detit.
- **Ura antiko-mesjetare mbi lumin Vjosë** – ndodhet mbi lumin Vjosë, poshte qytetit te Tepelenës, dhe njihet ndryshe edhe si Ura e Beçishtit;
- **Ujësjellësi i Bënçës** – ndodhet prane fshatit Bënçë dhe eshte një vepër hidraulike e shek. 19, e cila ka shërbyer për të çuar ujin në kalanë e Tepelenës;
- Mulliri në fshatin Nivicë – ndodhet afër lumit të Nivicës dhe është ndërtuar në shekullin 19;
- **Shtëpia e Selam Musait** – ndodhet në fshatin Salari dhe është ndërtuar në fundin e shek. 19;
- **Ura Metalike e Leklit** – ndodhet mbi lumin Drino, dhe eshte ndërtuar në vitin 1925;
- **Ura metalike e Dragotit** – ndodhet prane fshatit Dragot dhe është projektuar e ndërtuar në vitin 1936.
- **Kisha e Profet Ilia** – ndodhet në fshatin Lekël, dhe eshte ndertuar ne shek. 19;
- **Kisha e Shën Thanasit** – ndodhet në fshatin Lekël, dhe është një ndërtesë kulti e shekullit 18, e tipit një nefshe me hajat.
- **Kisha e Shën Mëhillit** – ndodhet në fshatin Lekël, dhe është një ndërtesë kulti e shekullit 18;
- **Rrënojat e kishës së Shën Kollit**
- **Banesa e Myfit Kaçubajt** – ndodhet ne veri të fshatit Nivicë, brenda hapësirës së Kalasë antike të Nivicës.

Profili ekonomik, problematikat dhe mundesitë

Aktualisht aktiviteti ekonomik ne Bashkine Tepelene karakterizohet nga ekzistenza e bizneseve te vogla dhe familjare si dhe nga një nivel i larte informaliteti. Sektori me i zhvilluar eshte ai i sherbimeve, megjithese po evidentohet nga viti ne vit nje rritje e numrit te fermave te subjekteve qe merren me bujqesi dhe blegtori. Rritmi i rritjes së ketij sektori ka qenë konstant edhe gjatë 4-5 viteve te fundit me një normë mesatare prej 1-2% në vit.

Viti	Gjithsej	Fermerë	Person Fizik	Person Juridik
2015	448	39	292	117
2016	680	283	301	96
2017	767	383	286	98

Ndermarrjet aktive ne Bashkinë Tepelenë, sipas formes ligjore (INSTAT)



Fig. 18 - Pamje ajrore e fabrikes se prodhimit te ujit te ambalazhuar "Tepelena"

Ne sektorin bujqesor evidentohet një renie e interesit te kultivimit, ndersa sektori i blegtorise vazhdon te ruaje një lloj konsistence. Aktivitetet ekzistuese bujqësore synojnë më tepër përmbushjen vetëm të nevojave familjare dhe janë të kufizuara në përdorimin e ngastrave jo më të madhe se 1-2 Ha për këtë qëllim. Klima e përshtatshme lejon rritjen e rrith 41 mijë rrënje ullinj dhe 38 mijë rrënje hardhi. Nderkohe, vete terreni malor i Tepelenes ofron mundesi shume te mira per kultivimin e bimeve medicinale. Me poshte jepen standartet e specifikuara nga Ministria e Bujqesise lidhur me tipet dhe format e kultivimit te ketyre kulturave.


Papunësia në Bashkinë e Tepelenës rezulton në nivele të larta: rrith 37%. Shkalla e papunësisë për Bashkinë paraqitet më e lartë se mesatarja e papunësisë në rang vendi (rrith 30%). Indeksi i papunësisë për të rinjtë (mosha 15-24 vjec) dhe për femra paraqiten gjithashtu më të larta se mesatarja e vendit. Respektivisht, norma e papunësisë për të rinjtë është 67.3% (mesatarja kombëtare: 52.9%), ndërsa norma e papunësisë për femrat është 41.8% (mesatarja kombëtare 31.4%). Këta tregues flasin për domosdoshmërinë e marrjes së masave urgjente, nëpërmjet projekteve, që synojnë rritjen e numrit të të punësuarve, pa lënë jashtë vëmendjes edhe fuqizimin e orientimin nga tregu i punës të arsimit profesional të mesëm.

Artizanati si zhvillim

Vitet e fundit ne Tepelene po gjejne zbatim iniciativa te vogla te njesive artizanale, duke marre reference edhe traditen lokale apo shembuj nga iniciativa te ngjashme ne Rajon, si ne Gjirokaster apo Permet. Keto iniciatiava kane kryesisht profil personal dhe familjar, nderkohe qe kontribuojnë jo vetëm ne mbajtjen gjallë të traditës dhe rritjen e vizitueshmërisë trevave te Bashkise Tepelene por edhe për punësimin e banoreve.

Turizmi si Potencial Ekonomik

Bashkia Tepelena ofron shume potenciale te zhvillimit te turizmit, te mbeshtetura keto nga një peisazh i mrekullueshem malor, histori e pasur si dhe ushqime tradicionale. Bukuritë e Malësisë dhe Kanioneve të Kurveleshit po hyjne gradualisht në guidat turistike europiane. Megjithë problemet e trashëguara, tashme ne Tepelenë po ndihen elementet e një transformimi rrënjos fizik, i perkthyer ne investimet per restaurimin dhe promovimin e trashëgimisë kulturore. Iniciativat vitet e fundit per transformimin dhe rindertimin e qendres



historike te qytetit, përmes Programit Kombëtar të Rilindjes Urbane, po hedhin hapat e pare te nevojshem per transformimin e Tepelenes ne nje destinacion turistik të juglindjes së Shqipërisë.

1.3.4. Shërbimet dhe Infrastrukturat

Grumbullimi i mbeturinave

Aktualisht, sherbimi i grumbullimit te mbetjeve urbane ne Bashkine Tepelene ofrohet vetem ne qytetin e Tepelenes, ne Veliqot, si dhe ne nje pjese te korridorit pergjate rruges interurbane Levan – Tepelene – Gjirokaster. Nderkohe pjesa e tjeter e territorit te Bashkise, pra zonat rurale periferike, nuk kane sherbim. Ne keto territore, mbetjet urbane te prodhua thjesht hidhen ne pika te caktuara informale, duke shkaktuar ndotje te mjedisit. Gjithsesi duhet thene se, per shkak te numrit te ulet te popullsise si dhe te nivelit te ulet ekonomik, sasia e mbetjeve te gjeneruara nga zonat rurale eshte relativisht e ulet. Nje pjese e banoreve te zonave periferike i djegin mbetjet, e cila shton rreziqet per ndotjen e ajrit apo per shperthimin e zjarreve sporadike.

Sherbimi i grumbullimit te mbetjeve ne Bashkine Tepelene mundesohet vetem nga nje makine teknologjike, e cila eshte aktualisht ne gjendje te amortizuar. Nderkohe qe problemi themelor ne kete sherbim te kufizuar mbetet pika e depozitimit te mbetjeve, e cila ndodhet ne pjesen veriore te qytetit, dhe buze lumi Vjosë. Eliminimi i kesaj pike eshte evidentuar edhe si sfida kryesore nga ana e Bashkise, perveç zgjerimit te sherbimit aktual edhe ne zonat periferike. Nderkohe, duhet thene se landfilli rajonal me I afert eshte ai I Bajkaj ne Sarande, largesia e të cilit si dhe kostot qe rrjedhin prej kësaj largesie perbejne nje tjeter sfide per administraten e Bashkisë.




Fig. 19 - Pamje te pikes se depozitimit te mbetjeve ne verilindje te qytetit te Tepelenes, prane lumit te Vjosës

Arsimi

Aktualisht, ne territorin e Bashkise Tepelene funksionojne:

- 1 Shkollë e Mesme e Përgjithshme

- 24 Shkolla Nëntë-Vjeçare
- 16 Kopshte

Duhet permendur fakti, se per shkak te largimit te popullsise rurale, nje pjese e mire e shkollave te fshatrave po vuajne mungesen e nxenesve. Vetem tre vitet e fundit, ne territorin e Bashkise jane mbylluar 9 shkolla, per shkak te numrit te ulet te nxenesve.

Nj. Adm	Niveli arsimor i përfunduar			Shkalla e analfabetizmit
	fillor dhe 8/9-vjeçar	i mesëm	universitar dhe pasuniversitar	
Tepelenë	37.33%	41.6%	18.0%	1.7%
Qendër Tepelenë	65.74%	21.5%	4.1%	3.8%
Lopës	60.68%	23.8%	6.0%	3.6%
Kurvelesh	60.64%	29.3%	5.0%	2.7%

Niveli i arsimimit ne Bashkine Tepelene²

Tabela me siper paraqet nje panorame te nivelit arsimor te popullsise ne Bashkine Tepelene. Vihet re se ne zonat rurale mbizoteron arsimi fillor dhe 8/9 vjeçar, me nje mesatare prej 62% te popullsise, ndersa arsimi i mesem luhatet ne mesataren 24,5%. Ne qytetin e Tepelenes situata paraqitet disi me mire ne favor te arsimit te mesem me 41,6% te popullsise, nderkohe qe popullsia me arsim universitar perben 18% te totalit.





Fig. 20 - Akset kryesore rrugore te Bashkise Tepelene

² INSTAT 2018



Ajo qe evidentohet eshte shkalla e ulet e arsimimit ne zonat periferike/rurale, ku niveli i arsimimit universitar kap vleren e 5,2% te popullsise. Nderkohe, ne te gjithe territorin e Bashkise Tepelene nuk evidentohet asnjë shkollë profesionale, nderkohe qe nxënësit që duan të ndjekin deget profesionale i adresohen kryesisht Shkolles se Mesme Profesionale "Thoma Papapano" në Gjirokaster.

Rrjeti Rrugor i Bashkisë

Skema rrugore e Bashkise Tepelene dallohet nga një konfiguracion thuajse radial i saj, ku qendra e ketij konfiguracioni eshte qyteti i Tepelenes, nga l cili marrin rruge dy akse te rendesishme per Bashkine siç jane:

Rruga Inter-Urbane Gjirokaster-Tepelene-Memaliaj

Aktualisht shtrihet per gjate korridorit lumenor te Drinosit dhe Vjosës, si dhe kalon permes qytetit te Tepelenes, duke krijuar sa mundesi ekonomike por edhe probleme te trafikut apo ndotjes. Segmenti prej rreth 2 km qe përshton edhe qytetin e Tepelenes nuk eshte ende i rikonstruktuar per t'iua pershtatur profilin terthor qe ka superstrada ne te dy anet.



Fig. 21 -Rruga Kombëtare Interurbane Kombetare Levan – Tepelene - Gjirokaster

Segmenti Inter-Urban Kombetar Memaliaj – Tepelene, i cili ka qene një aks mjaft problematik per vite te tera per shkak te gjendjes se amortizuar te rruges, eshte rikonstruktuar dhe zgjeruar sipas profilit te superstrades ne vitin 2014. Nderkohe, per pjesen e superstrades qe kalon ne qytet, qe prej Korrikut te vitit 2018 ka nisur puna per ndertimin e By-Passit, nepermjet te cilit do te permiresohet qarkullimi dhe do te devijohet trafiku i rende ne kete pjese problematike te rruges. Megjithë investimet e kryera gjate viteve te fundit, ende një pjese e madhe e rrugeve lokale jane ne një gjendje fizike jo te mire; permendim ketu aksin Dukaj – Salari – Dhemblan.

Sherbimi shendetesor

Sherbimi shendetesor ne Bashkine Tepelenë ofrohet nepermjet Spitalit bashkiak si dhe 32 qendrave shëndetësore primare, nga të cilat 14 prej tyre ndodhen në njësinë administrative Qendër Tepelenë, e motivuar kjo per shkak te numrit me te madh te fshatrave, në krahasim me njesite e tjera administrative. Per shkak te renies se popullsise, një pjese e madhe e qendrave te vogla shendetesore jane mbyllur, ndersa sherbimet jane fokusuar ne qendrat shendetesore ne ish qendrat e Komunave.



Fig. 22 Aksi rrugor Dukaj – Salari - Dhëmblan

Ne mungese te Qendrave Shendetesore banoret detyrohen te shkojne drejt spitalit te Tepelenes, apo te Gjirokastres. Mungesat ne sherbimin shendetesor ndihen kryesishet ne fshatrat Koder, Veliqot, Salari, Beçisht, Turan, Lekël, etj. Ne per gjithesi evidentohet mungesa e specialisteve per shume nga sheremet e kerkuara nga banoret. Ka mungese te mjekeve kirurge, specialisteve ORL, mjekeve te reanimacionit, obstetër etj. Aktualisht spitali i qytetit disponon vetem tetë mjekë të specialitetit te per gjithshem. Ne nivel kombtar, shërbimi i shendetit publik është i organizuar në tre nivele. Ne nivel Qarku funksionojne spitalet dhe ambulancat qendrore, ne ish qendra e rretheve funksionojne spitalet ndersa ne qytezat e vogla funksionojne sheremet ambulatore. Zonat periferike dhe ato te thella rural kanë nga 1 mjek e nga 1 infermier, sa për vizita te per gjithshme, shërbim paresor dhe injeksione.

Normativa e sherbimit eshte (ka qene) mesatarisht 1 mjek dhe 1 infermier për 10 mijë banorë. Sipas skemës se sherbimit shendetesor, spitalet ne qendrat e te 12 Qarqeve do të vazhdojnë të kryejnë këtë funksion shërbimesh komplekse shëndetësore. Ndërsa spitalet e tjere, përfshire spitalin e Tepelenes, do të shërbejnë për rastet e urgjencave. Koncepti ne kete skeme bazohet ne idene e krijimit te niveleve hierarkike te sherbimit shendetesor, duke ulur kostot e sherbimit ne nivel kombtar.



Fig. 23 -Spitali i qytetit "Përparim Tepelena"



Furnizimi me uje

Ndërmarrja Ujeselles Kanalizime Tepelene mundeson furnizimin e një numri popullsie prej 16,800 personash, përfshirë qytetin e Tepelenes, ashtu edhe fshatrat. Ne total, ne Korrik 2017, eshte bere riorganizimi i Ujeselles Kanalizime Sha Tepelene, ne strukturen e te ciles funksionojne rrith 22 rrjete furnizimi me uje per qytetin e Tepelenes dhe te fshatrave.

Nderkohe, per sa i peket sherbimit te kanalizimeve te ujerave te zeza, sherbimi eshte me i kufizuar ne vetem 14,900 persona. Shoqeria nuk disponon impiant dhe si rrjedhim nuk ofron sherbimin e trajtimit te ujerave te ndotura.

Sasia e ujit qe prodhohet dhe qe hyn ne sistemin e shperndarjes eshte rrith 2,178,000 m³ ne vit, qe korrespondon me nje vlere te perafert prej 130 m³ uje per person ne vit, ose 356 litra/person/dite. Kjo eshte nje vlere e konsiderueshme, nderkohë që norma e agreguar e kërkeses per uje llogaritet ne 150 l/person/dite. Sipas te dhenave te Njësise se Monitorimit të Treguesve të Punës dhe Vlerësimit Krahasues prodhimi mesatar i ujit ne nivel kombetar eshte mesatarisht 300 litra për frymë në ditë, nderkohe qe shitja mesatare e ujit ishte 110 litra për frymë në ditë. Diferenca mes këtyre dy shifrave tregon qartë masën e "ujit të pafaturuar" sipas kërkesës, dhe përfaqëson sasinë e ujit "që prodhohet por nuk faturohet" për çdo person të furnizuar.

Rrjeti i Ujesellesit te Tepelenes ka nje gjatesi totale prej 85 km, nga te cilat 25 km jane linja te rrjetit kryesor, ndersa linjat e rrjetit shperndares kane 60 km gjatësi. Ne vitin 2017, eshte llogaritur qe ne te gjithe rrjetin ekzistojne rreht 547 çarje te tubacioneve, ku nje pjese e mire e tyre rezultojne nderhyrje te parregullta.



Fig. 24 -Pamje e ujesellesit te Bençes, struktura me e vjeter e furnizimit me uje ne Bashkine Tepelene

1.3.5. Degjesa Publike

Takimi eshte realizuar ne Bashkine Tepelenë më datë 26.03.2019 në orën 12:30, në fshatin Nivicë, pjesë e Njësisë Administrative Kurvelesh, si dhe pjesë e Programit për Zhvillimin Rural 100+ Fshatrat. Ne kete takim morren pjese perfaquesues te Bashkise Tepelene, perfaquesues te Njesive Administrative, biznesmene te zones se Tepelenes si dhe banore te fshatrave Rexhin, Nivice, Progonat, etj.

Takimi u organizua nga Bashkia Tepelene, me kujdesin dhe pjesemarrjen e kryetarit te Bashkise, Z. Tërmet Peçi. Pasi përshëndeti iniciativen dhe punen e kryer deri tani për hartimin e Strategjise Territoriale dhe Planit të Përgjithshem Vendor te Bashkise, ai theksoi rëndësinë që duhet ti kushtoje ketij procesi gjithsecili nga banorët dhe aktoret kryesore te kësaj Njesie Vendore, me qëllim analizimin sa më të thelluar të çështjeve apo problematikave si dhe identifikimin e programeve dhe strategjive sa me realiste dhe te mundshme per zbatim, si nga ana teknike ashtu edhe financiare. Kokretisht, per procesin e zbatimit te projektit nga Z. Peçi mund të veçojmë çfarë shprehet më poshtë:

- Zona e Kurveleshit është një njësi, e cila ka për synim zhvillimin e gjithë fshatrave të orientuar drejt turizmit rural dhe agroturizmit.
- Është e rëndësishme të krijojmë një qasje tjetër, duke përmirësuar standartin e cilësisë së shërbimit, por dhe mënyrës se si do ti paraprijmë së ardhmes, me listimin e prioriteteve, modelet dhe format e zhvillimit, që plani do të përcaktojë në infrastrukturë dhe gjithçka tjetër, ku përfshihen:
 - organizimi i hapësirave,
 - sistemimi i transportit
 - zonat e mbrojtura
 - rregullimi i të drejtave dhe detyrimeve mbi pronën
 - burimet natyrore, trashëgimi, peisazh, mjedis

dhe çdo gjë tjetër që është nën administrimin e Bashkisë Tepelenë në mënyrë shkencore dhe mbështetur në ligjet kushtetuese dhe konventat ndërkombëtare.

Puna për realizimin e kësaj strategjie mjaft të rëndësishme, po zhvillohet midis institucioneve qëndrore te Agjensise Kombetare te Planifikimit të Territorit (AKPT) si dhe Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë”.

Nga diskutimet lidhur me percaktimet e mundshme te zhvillimit per Bashkine Tepelene, nga Perfaquesuesit e grupit te Konsulentit u theksuan çeshtjet ne vazhdim:

- Pozicionimin e zonave të reja urbane dhe ekonomike të Bashkisë Tepelenë (p.sh, zona ekonomike në veri të qytetit, krijimi i parqeve bashkiake, zonat e reja për ndërtime, etj.)
- Projektet pilot të Agroturizmit - në Kurvelesh, në brezin Turan-Dukaj, apo në Dhëmlan-Sinanaj dhe Matohasanaj, korridori Beçitsh-Dragot, Luzat, etj.
- Përmirësimin e aksesit, aksi Nivic-Kuç, përmirësimi i lidhjes fshatit Dukaj me Memaliaj, apo krijimi i lidhjes Sinanaj-Dorëz-Leshnje-Superstrade (për t'i mundësuar një stimul të ri zonës periferike të Njësisë Administrative Lopës).



- Akse të reja panoramike turistike apo shtigje, si Kodër-Lekël-Hormovë, për të vazhduar më pas potencialisht në Tërbuq, Labovë dhe Fushe Çajup (jashtë territorit të Bashkisë Tepelenë).
- Forcimi i rrjetit te itinerareve kulturore, duke lidhur Kalanë e Tepelenës, Matohasanaj, Nivicës, Leklit etj, me destinacionet natyrore.
- Parku Rajonal Bencë – Kurvelesh, si dhe hapësira e mbrojtjes nga prerja e pyjeve apo ndërtimi i Hec-eve.
- Brezi i Vjosës si pjesë Parkut Rajonal (propozuar nga Plani i Përgjithshëm Kombëtar).



Në këtë kontekst u hap diskutimi me publikun, ku u shprehën mendime, sugjerime dhe komente në lidhje me strategjine e zhvillimit te Bashkise Tepelene. Në diskutim u ngritën pyetje dhe sugjerime si më poshtë:

- Sigurimi i transportit dhe përmirësimi i infrastrukturës rrugore për lidhjen me qytetin, (aksi i papërfunduar i rrugës Skaran – Lekdush. Lidha me zonën e bregdetit sikurse është folur edhe në planet qeveritare.
- Mënyrat dhe format e stilit arkitekturor të ndërtimit të banesave, distancat, zonat, dhe lartësia e kateve.
- Sistemi i ujmbledhësave dhe kanaleve të vaditjes për tokat bujqësore si dhe bagëtitë si baza e ekonomisë aktuale
- Sistemi i menaxhimit të mbetjeve urbane, eleminimi i plasikës dhe pika grubullimi për fshatrat e thella si zona e Kurveleshit apo Lopësit.
- Sistemi i rrjetit elektrik dhe atij të ujit të pijshëm, si problematikë emergjente që ndikon në zhvillimin e zonës.
- Qëndrat shëndetosore, mbulimi me shërbim, ndërtimi i godinave të reja pasi në disa fshatra ka mungesë të tyre.
- Menaxhimi i ujraleve të zeza
- Mbrojtja dhe kultivimi i bimëce medicinale, piakt e grumbullimit dhe menaxhimit.
- Mbështetja me shërbime në infrastrukturë dhe pajisje për aktivitetet e agro – turizmit
- Sinjalistikat turistike zyra të informimit nevoja për ekspertizë dhe kurse kualifikimi

AKPT

AGJENCIA KOMBËTARE E
PLANIFIKIMIT TERRITORIT



REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA TEPELENE

P.P.V. TEPELENE



DEGJESE PUBLIKE NR 2 / PISEMARJA / 26 MARS 2019

Nr	EMER IMBIEMER	NR. TEL	E-MAIL	INSTITUCIONI	FIRM
1	Aleksandar Hemon	069 542 5703		M.-A. Kavrelash	
2	Ergo Boçiqi	069 5855604		Kingator, Tegor, Kozet	
3	Ibrahim Shukiqi	069 69 883 082		A. K. S. Tepci	
4	Pellumb Kermal	068 52 71107		Kryekari Proqnoza Rrogoz	
5	Sadam meha	069 42 59101		Salvator	
6	Edmund Dholaj	069 61 18021		Perit Vilt	
7	Armondo Isufi	069 24 69550		SMR2	
8	Shaqef Demaj	069 6905372		Reverat	
9	Edure Baki	069 4114032		Private	
10	Rejza	069 5638832		Private	
11	Gjergj Boçiqi	06 85 306 088			
12	Georgi Stojko	069 57 81281		Burgine	
13	Hidim Ahmeti	069 430 2401		Murit ne qendrini	
14	Janez Juhaca	069 22 88269		Republikë e Shqipërisë	

Degjeza Publike | Plani Pergithshem Vendur Tepelene 1





AKPT AGJENCIJA KOMBËTARE E
PLANifikimitë TERRITORIT



DEGESE PUBLIKE NR 2 / PJESEMARRJA / 26 MARS 2019

Nr	EMER MBIEMER	NE .TEL	E-MAIL	INSTITUCIONI	FIRM
15	Marsela Böhl	068 72 46 833	Marsela Böhl, agroökonom Meeser.		
16	Bettie Bamsl.	069 67 16 132	-		
17	Piaola Demidò	069 33 30 804	Pado Domini societatis M. H. H. Kundesh.		
18	Tonniellu Kurze	069 882 6504	-		
19	Esterika Gakell	069 57 05260	-		
20	Theresa Fey	069 6164 574	Geburtsklinik St. K. Kurshed		
21	Annelie + Rudi	068 486 8022	G. P. Patel		
22					
23					
24					
25					
26					
27					
28					

Degjesa Publike | Planit Pergjithshem Vendor Tepelene 2

1.4. Analiza SWOT Bashkia Tepelenë

1.4.1. Pikit e fortë

- **Pasurite Natyrore** - Bashkia Tepelenë identifikohet si një nga territorret më të pasura me monumente të natyres ne Rajonin e Gjirokastres. Konkrektisht, në të gjithë territorin e Bashkisë Tepelenë identifikohen **18** monumente të natyres, falë kjo reliefit karakteristik si dhe pozicionit gjeografik.
- **Atraksione kulturore** - në territorin e Bashkisë Tepelenë identifikohen 6 kala antike mesjetare si dhe 3 ura te klasifikuara monument kulture, karakteristike për nga historia dhe arkitektura e tyre. Keto pasuri te rendesishme ofrojnë mundesi per zhvillimin dhe mbeshtetjen e turizmit kulturor ne Tepelene, si një komponent I rendesishem I zhvillimit potencial ekonomik te zones.
- **Burime Natyrore** – ku mund të permenden depozitimet e gurëve dekorativë, gurë për industrinë e ndertimit, si mundesi per zhvillimin ekonomik
- **Klimate favorshme** – nga vleresimi I karakteristikave klimatike, territori I Baashkise Tepelene ofron një klime te pershtatshme per akomodimin e funksioneve te banimit, zhvillimit ekonomik si dhe aktiviteteve turistike, kulturore apo sportive
- **Pasuri të konsiderueshme ujore** - përmes territorit të Bashkisë Tepelenë rrjedh lumi i Vjosës së bashku me dy degëzimet e tij kryesore, lumi i Drinosit, lumi i Bënçës, si dhe gjarpërojnë dhe shumë përrenj të tjera të përhershëm e sezionale
- **Sipërfaqe të konsiderueshme tokë kullotë** – ekzitenca e masivit malor te Gribes, Kendrevices, si dhe maleve te Golikut apo Shendellise ofrojnë hapesira te konsiderueshme kullosore, te cilat, nepermjet një plani menaxhimi dhe administrimi te kujdeshem, mbeshtesin zhvillimin e një ekonomie te fuqishme blegtorelle.
- **Tradita blegtorele** – pasurite natyrore kullosore te Tepelenes kane krijuar gjate brezave një tradite te konsoliduar pastorale, te trasheguar ndër vite. Kjo vlore dhe pasuri duhet te shfrytezohet sa me mire, duke kontribuar ne kete menyre zhvillimin ekonomik te zones, ne mbeshtetje te ekonomise se produkteve blegtorele si dhe te turizmit natyror dhe ta

1.4.2. Dobësitë

- **Tkurrja demografike** – (largimi i popullsisë, braktisja e fshatrave). Duke ju referuar Planit të Pergjithshëm Kombtar PPK, Bashkia Tepelenë është nën nivelin minimal demografik të bashkive të klasifikuara si terciare. Kjo perben edhe një nga sfidat me te medha ne kete njesi vendore, e cila duhet domosdoshmerisht te permbyset kete trend negativ demografik.
- **Aktivitet i ulët bujqësor** – e ndikuar kryesisht nga tkurrja demografike dhe braktisja e fshatrave, një pjese e mire e territoreve bujqësore nuk kultivoohen, ose kultivoohen nën kapacitetin e tyre ekzistues.
- **Dëmtimi i pasurive natyrore** – (djegia dhe shpellezimi) dhe mungesa e iniciativave për ripërtëritjen dhe rivitalizimin e zonave të dëmtuara. Fatkeqesish, Bashkia Tepelene ka mundesi mjaft te kufizuara per kontrollin e sistemeve natyrore, sidomos ne zonat periferike te saj. Eshte esenciale qe te kapercehet kjo sfide, duke marre ne konsiderate

vlerat dhe potencialin qe ka sistemi natyror per zhvillimin e degeve te ndryshme te ekonomise vendore.

- **Rrjeti infrastrukturor në zonat periferike** – Me gjithë investimet e viteve të fundit, akoma një pjesë e mire e zonave periferike të Bashkisë Tepelenë kanë mungesa të theksuara të rrjeteve të infrastruktureve, duke permendur ketu furnizimin me uje dhe kanalizimet.
- **Shtrirja e kufizuar e sherbimeve publike** – ketu mund te permendim ne menyre specifike problematikat me sherbimin shendetesor si dhe me grumbullimin dhe evakuimin e mbeturinave urbane. mungon ose ka mangësi në zonat periferike.

1.4.3. Mundësitë

- **Zhvillimi i turizmit kulturor** – nëpërmjet hartimit të një plani investimi të detajuar si dhe marrjen e masave konkrete përsa i përket rivitalizimit dhe shfrytezimit te monumenteve te kultures, duke ndihmuar keshtu ne gjenerimin e aktiviteteve si dhe te ardhurave financiare per Bashkine Tepelene si dhe per te gjithe aktoret e interesuar;
- **Zhvillimi i turizmit te aventures dhe hiking** – i favorizuar nga reliivi i thyer, peisazhet tërheqëse si dhe karakteristikat e veçanta natyrore, ky sektor relativisht i ri perballët me mundesi te mira zhvillimi si dhe burim të ardhurash për Bashkinë Tepelenë. Gjithsesi, ketu duhet marre ne konsiderate mungesa e eksperiencave se operatoreve vendore ne kete lloj akviteti turistik.
- **Zhvillimi i ekonomise blegtoriale** – e favorizuar nga sipërfaqe të konsiderueshme tokë kullotë si dhe nga traditat historike të zones, blegtoria dhe degët e saj përbëjnë shtyllen ekonomike kryesore te Bashkisë Tepelenë
- **Zhvillimi i agroturizmit** – identifikohet si një nga mundësitë më te favorshme për rivitalizimin dhe zhvillimin social-ekonomik të zonave rurale periferike të Bashkisë Tepelenë, duke kombinuar potencialet turistike me burimet natyrore.
- **Krijimi i korridoreve panoramike natyrore pergjate lumenjve Drinos, Vjosë dhe Bënçë**, - te konceptuar per te akomoduar normativat bashkekohore mjedisore si dhe të përshtatur për kembesoret, biçikletat, si dhe duke akomoduar stacione të dedikuara pushimi për udhëtarët;

1.4.4. Rezjet

- **Braktisja e vendbanimeve** – nëse nuk ndryshon trendi aktual i largimit të popullsisë, Bashkia Tepelene do te perballët me rënien te konsiderueshme te aktivitetave social-ekonomike. Nje skenar i tillë do te shoqerohet me veshtiresi nga ana e autoritetave vendore per te gjeneruar te ardhurat e nevojshme per realizimin e investimeve, ofrimin e e shërbimeve baze për një jetesë sa më cilësore per banoret.
- **Demtimi i pyjeve si pasoje e shpallezimit pa kriter nga dora e njjeriut** – mungesa e kontrollit efficient ndaj prerjes se pyjeve apo djegia e tyre do te demtonte potencialin per zhvillimin e turizmit te aventures si dhe te ekonomive pyjore ne territorin e Bashkise.

- **Dëmtimi i shtrateve të lumenjve** – Vjosa, Drinosi dhe Bença janë tre elementet thelbesore te Sistemit Ujor ne Bashkine Tepelene, dhe potencialet kryesore te turizmit natyror e të aventurës ne këtë Njesi Vendore. Dëmtimi i shtreterve të tyre, do të ndikonte negativisht në potencialin real që këto korridore lumore disponojnë.
- **Ndotja e trupave lumore nga mbeturinat dhe nga shkarkimi i ujerave te zeza** – mungesa e sherbimeve te konsoliduara te grumbullimit te mbetjeve, mungesa e një landfill teknologjik si dhe e impianteve te pastrimit të ujerave të zeza do të demtoje negativisht potencialin natyror turistik, jo vetem të trupave ujore, por edhe të korridoreve panoramike që përshtojnë këto trupa ujore.

1.5. Vizioni dhe Strategjia e zhvillimit të territorit

1.5.1 Vizioni i zhvillimit të territorit

Konceptimi i Vizonit të Zhvillimit të territorit për Bashkinë Tepelenë është rezultat i procesit të njoftes së thelluar të zonës, në kontekstin e pozicionit rajonal te njesise dhe karakteristikave morfollogjike të territorit, të nderthurjes se proceseve ekonomike dhe sociale si dhe vleresimit te nevojave per infrastruktura dhe sherbime.

Deklarata e Vizonit

Ne formulimin e **Vizonit te Zhvillimit Strategjik te Bashkise Tepelene** eshte marre per baze permbyrsa e situate aktuale te regresit ekonomik dhe social te kesaj njesie vendore, duke u mbeshtetur ne Objektivat dhe Percaktimet e Planit te Pergjithshem Kombtar si dhe kryesisht ne potencialet natyrore qe kjo njesi ofron.

Nisur nga situata aktuale e zhvillimit ekonomik dhe social, Strategjia koncepton një përqasje multi-dimensionale, e fokusuar ne potenciali njerëzor si dhe ne asetat natyrore. Dinamikat e reja territoriale dhe orientimet e sektorit turistik, si një nga përdoruesit kryesor të ofertës territoriale dhe humane të kësaj bashkie, janë parashikuar në shkallë rajonale.

“Bashkia Tepelene, e pozicionuar per gjate aksit jugor kombtar te komunikimit dhe transportit, me një potencial te madh te zhvillimit te ekonomise se turizmit malor dhe atë të aventurës, nxit zhvillimin ekonomik dhe social të njësive te saj urbane si dhe mirëqenien e banoreve, duke mbeshtetur diversifikimin ekonomik te degeve lokale te blegtorisë, agroturizmit dhe ekonomive pyjore”

Vizioni i Bashkise Tepelenë eshte i orientuar drejt ruajtjes dhe mire-administrimit sa më të mirë të këtyre potencialeve, duke i kthyer asetat natyrore në te ardhura dhe mireqenie per banoret e saj.






Fig. 25 -Harte e Vizionit te zhvillimit te Bashkise Tepelene

1.5.2. Prognoza demografike

Para percaktimit te masave dhe ndërhyrjeve strategjike te nevojshme per çdo Sistem Territorial, eshte e nevojshme qe te vleresohej ne menyre objektive ecuria e prognozes demografike te Bashkise Tepelene per 15 vitet ne vazhdim. Ky komponent merr nje ndjeshmeri te konsiderueshme ne rastin e kesaj njesie te vete-qeverisjes vendore, per shkak te numrit te ulet te popullsise ekzistuese si dhe nevojes per permbyjes se ketij trendi negativ. Konkrektisht, te dhenat e popullsise se Bashkise Tepelene jane analizuar sipas burimeve ne vazhdim:

- Sipas Censusit 2011 8,949 banore
- Sipas Regjistrit Civil 16,371 banore

- Regjistri Civil 2000 20,000 banore
- Regjistri Civil 2015 16,500 banore

Aktualisht verifikohet një rënie prej 16% e numrit te popullsise per periudhen 2000-2015. Nga diferenca e te dhenave evidentohet se regjistrimi i Censusit ne vitin 2011 ka percaktuar vlera te popullsise qe jane thuajse sa gjysma e vlerave te Regjistrat Civil. Kjo diferenca vjen per shkak te mungesës se çregjistrimit te personave qe jane larguar nga keto tre Bashki, duke bere te mundur qe te vazhdojne te figurojne si rezidente aktuale.

Per efekt planifikimi sa më të sakte e rigoroz, do te fokusohemi te të dhënët zyrtare të Censusit 2011, si një proces zyrtar konfirmimi dhe qe eshte kryer direkt ne terren (dere me dere). Gjithsesi duhet permendur fakti qe shifrat vazhdojne te jene subjektive, per shkak edhe te distances kohore midis Censusit 2011 dhe vitit 2018 qe kryhet vleresimi.

Duke qene se te dhenat statistikore te Censusit dhe regjistrat te Gjendjes Civile ndryshojne shume, eshte perdonur një faktor korrigjimi i prezantuar nga Ministria e Financave per te llogaritur numrin relativisht te sakte te popullsise se Bashkise Tepelene, te bazuar ne te dy burimet.

Census + (Zyra e Gjendjes Civile – Census) x 30%³

Sipas këtij koeficienti korrigjimi, popullsia aktuale e Bashkise Tepelene llogaritet ne 11,176 banore. Nderkohe, per Prognozen Demografike do te marrim paraprakisht ne konsiderate tendencat e ndryshimit te popullsise ne nivel Qarku te viteve 2012 dhe 2016, qe perkojne dhe me te dhenat zyrtare te publikuara nga INSTAT. Duke marre per baze një perqindje prej 0,022% te renies se popullsise se Qarkut Gjirokaster, ne tabelen ne vazhdim jepen prognoza e popullsise se Bashkise Tepelene, per periudhen 2019-2033.

2019	2020	2021	2022	2023	2024	2025	2026	2027	2028	2029	2030	2031	2032	2033
11176	10930	10689	10454	10224	9999	9779	9564	9353	9148	8946	8750	8557	8369	8185

Tabela 1 - Prognoza demografike ne Bashkien Tepelene sipas te dhenave demografike ne nivel Qarku 2012-2016

Panorama e krijuar sipas të dhënavë të Qarkut është negative, nderkohe qe vizioni i Strategjisë se Zhvillimit te Bashkise Tepelene synon pikerisht te ndërpresa trendin e uljes së numrit të popullsisë, nëpërmjet nxitjes së zhvillimit të sektoreve të ndryshëm ekonomik. Për këtë arsy, popullsia e parashikuar per territorin e Bashkise do te ruaje te njejtën vlerë te paraqitur si ne llogaritjen sipas faktorit korrigjues, pra 11,176 banore.

1.5.3. Propozime per Sistemin Urban

Lidhja me Prognozën Demografike - Bashkia Tepelenë, ashtu si edhe njesite e tjera vendore te Qarkut te Gjirokastres kane perjetuar një renie te konsiderueshme te popullsise gjate viteve te fundit. Duke u bazuar ne vleresimet qe marrin per baze edhe faktorin korrigjues midis vlerave te ndryshme te Censusit 2011 dhe Regjistrat Civil, popullsia aktuale e Bashkise Tepelene llogaritet te jete 11,176 banore.

Nderkohe, per sa i perket prognozes se popullsise, ne mungese të të dhënavë te detajuara krasimore me vitet e kaluara, eshte marre ne konsiderate trendi i levizjeve demografike ne

³ Vleresimi Strategjik Mjedisor per perqatitjen e "Studimit te Sektorit mbi nevojen per investime ne Menaxhimin e Integruar te Mbetjeve te Ngurta (MIMN) ne Shqiperi – Nentor 2018" – Parashikimi i Popullsise faqe 27

nivel Qarku Gjirokaster. Ky trend ka qene dhe eshte negativ per një periudhe kohe prej 20 vjetesh, per shkak te levizjeve migratore ne nivel kombetar dhe rajonal.

Per periudhen 2012-2016, Popullsia e Qarkut te Gjirokastres eshte ulur me nje ritem prej 2,2% ne vit. Nese vazhdojme te konsiderojme si te mireqene kete trend per Bashkine Tepelene, atehere popullsia e Bashkise per vitin 2033 do te llogaritet ne 8185 banore. Ne menyre qe te ruhet nje tendence pozitive, e motivuar edhe nga nderhyrjet permiresuese, Strategjia dhe Plani i Pergjithshem Vendor do te marrin ne konsiderate nje skenar rritjeje, dhe konkretisht ate te rritjes se totalit te popullsise me nje vlere prej 10% deri ne vitin 2033. Sipas ketij skenari, popullsia totale e Bashkise Tepelene ne fund te afatit te PPV do te jete **12,300 banore**.

Kjo popullsi do te vazhdoje te banoje ne qytetin e Tepelenes si dhe ne fshatrat e Njësive Administrative. Pa hyre ne shifrat specifike, Strategjia Territoriale propozon:

- rritjen e popullsise se qytetit te Tepelenes me 20% deri ne periudhen 2033
 - ruajtjen te pandryshuar te popullsise per fshatrat e Kurveleshit (qender e turizmit malor)
 - tkurjen graduale te popullsise se fshatrave te Lopesit dhe Njesise Administrative Qender drejt qytetit te Tepelenes.




Fig. 26 - Skema e riorganizimit sipas prognozes demografike te Bashkise Tepelene.

Ky propozim synon te rrite dhe mbeshtese ekonomine e shkalles se qytetit te Tepelezes

nepermjet rritjes se popullsise, si dhe te ekonomizoje kostot e sherbimeve per te gjitha zonat. PPK sugjeron vleren e 30,000 banoreve si nje prag te nevojshem qe nje zone urbane te funksionoje ne aspektin ekonomik si dhe per infrastrukturat dhe sherbimet

Sipas kesaj proguze, Strategja propozon edhe ri-organizimin e strukturave urbane te Bashkise Tepelene. Konkretisht propozohet:

- Rritje e siperfaqes urbane te qytetit, kryesisht ne pjesen veriore (zonen fushore) duke akomoduar rritjen e popullsise prej 20% te
- Ruajtjen dhe konsolidimin e njollave urbane te fshatrave te Njesise Kurvelesh, sipas kufijve ekzistues., duke shtuar elemente infrastrukturore qe kane te bejne me strukturat akomoduese potenciale per turizmin malor.
- Tkurrjen graduale te njollave urbane te zonave rurale periferike, duke garantuar nivelin e sherbimeve dhe infrastrukturave baze te nevojshme.




Fig. 27 - Zona veriore e qytetit te Tepelenes, e cila do te akomodoje rritjen e qytetit per periudhen 15 vjeçare te Planit.

1.5.4. Propozimet per Sistemin Natyror

Strategja Territoriale e Bashkise Tepelene per sistemin natyror, duke iu referuar karakteristikave ekzistuese, reliefit dhe potentialit njerezor ne funksion te sistemit natyror propozon evidentimin dhe menaxhimin e dy formave tipike funksionale

1. Zona natyrore perreth ishujve urbane – perkon me territorret uje-mbledhese te Bënçës dhe Vjosës si dhe nje pjese te Drinosit. Në kete zone propozohet intensifikimi i siperfaqeve pyjore, duke u kombinuar me parcelat frutore, ullishtet apo edhe parcelat e pakta buqesore prane korridorit te Vjosës dhe ne plajen e Kurveleshit.

Objktivi i kesaj nderhyrje eshte shfrytezimi i karakteristikave natyrore, dendetise se ulet urbane, reliefit etj, per rehabilitimin e zonave pyjore te demtuara si dhe zhvillimin e pyeve te rindj. E gjithe kjo do te ishte ne mbeshtetje te zhvillimit te sektorit te turizmit natyror dhe turizmit te aventures. Ne te njejten kohe, perparezi do ti jepet edhe zhvillimit dhe administrimit te ekonomive pyjore, si nje mundesi e madhe per zhvillimin e aktiviteve ekonomike perkatese te drurit.



2. Zonat malore ne lartesi – zona te dedikuara per kullota per blegtore, ne mbeshtetje te zhvillimit te sektorit perkates, si dhe i kombinuar mjaft mire me elementet e tjere te zhvillimit si agroturizmi dhe turizmi i aventure. Në këto zona duhet te evidentohen itineraret përkates natyrore si dhe stacionet e nevojshme per alpinistet apo te pasionuarit pas natyrës.




Fig. 28 -Njolla e Gjelber – Propozime per Ndryshim

Këto transformime duhet te mbeshteten me propozimet dhe nderhyrjet perkatese ne sistemin urban, sidomos ne zonat e banimit ne periferi (Kurvelesh, Lopës, Peshtan, Mezgoran, etj). Esenciale është që të mundesohet harmonia funksionale banim-natyre-ekonomi rurale, duke evitar efektet negative te aktivitetit njerezor.

1.5.5. Propozime për Sistemin Bujqësor

Per arsyte te reliefit te thyer dhe morfolojise se territorit, Bashkia Tepelene disponon pak siperfaqe toke bujqesore te kultivueshme. Ne total llogaritet siperfaqja bujqesore e punueshme perben rrith 4,4% te gjithe territorit te Bashkise, e cila, ne shume pjese te saj, shtrihet ne terrene të pjerreta.

Strategji territoriale e Bashkise Tepelene propozon konservimin maksimal te ketyre territoreve bujqesore, jo me shume per shkak te efiçencës ekonomike qe ato sigurojne ne terma makro, por kryesisht ne kuadrin e mbeshtetjes se sektorit te agro-turizmit.

Strategjia nuk propozon hapjen e tokave te reja bujqesore, per shkak te rentabilitetit te ulet si dhe mungeses se ekonomise se shkalles se ketij sektori ne kete njesi vendore. Ne kuadrin rajonal, Plani i Pergjithshem Kombtar propozon mbeshtetjen e proceseve te kultivimit te bimeve foragjere ne mbeshtetje te blegtorise, propozim ky qe duhet te gjeje zbatim ne territorin e Tepelenes.

Nderkohe, ne dokumentin e Strategjise Territoriale propozohet kombinimi i ketyre kulturave edhe me kultura konvencionale bujqesore (per konsum njerezor). Propozimet mbeshtesin aplikimin e teknikave te buqesise Bio, me produkte bujqesore te pastra dhe te cilesise se larte, në mbeshtetje të turizmit natyror.



Fig. 29 -Siperfaqe bujqesore perballë fshatit Turan, Bashkia Tepelene

Nje potencial i rendesishem buqesor, qe mbeshtetet ne karakteristikat natyrore eshte edhe kultivimi i bimeve medicinale apo çajit te malit, qe ka nje tradite ne zonen e Tepelenes. Keto parcela mund te kombinohen fare mire me terrenet e kullotave malore (Sistemi Natyror).

1.5.6. Propozim për Sistemin Ujor

Bashkia Tepelene disponon potenciale te rendesishme per sa i perket Sistemit Ujor, i cili perbehet nga tre trupa ujore te konsiderueshem si Lumi Vjose, Lumi Drinos dhe Lumi i Bënçës, si dhe nje numer jo i vogel perrenjsh tributare. Per shkak te reliefit dhe formacionit gjeologjik gelqeror ne territorin e Tepelenes evidentohen mjaft burime ujore te rendesishem.



Nderhyrjet aktuale me ndikim te konsiderueshem ne kete sistem mund te permendim:

- projektet e HeC'eve ne Lumin e Bënçës – te gjitha keto projekte jane te pajisura me vleresime te ndikimit ne mjedis, per te minimizuar apo eliminuar efektet negative ne mjedisin ujor. Ne kete kontest, Bashkia Tepelene duhet te monitoroje me rigorozitet zbatimin e kriterieve mbrojtese te trupave ujore te perfshire ne keto investime;
- ndotja nga ujerat e zeba te qytetit te Tepelenes – mungesa e nje impianti te pastrimit dhe purifikimit te ujrate te zeba eshte nje sfide e konsiderueshme per Bashkine Tepelene, e cila, perveç efekteve mjaft negative ne ekosistemin ujor te Vjosës, pengon zhvillimin dhe konsolidimin e potencialeve turistike ekzistues te sistemit territorial ujor. Nderkohe, efekti i ujrate te zeba te zonave rurale eshte relativisht i ulet dhe jo i konsiderueshem, per shkak te volumit te ulet te tyre qe vjen si rrjedhoje e numrit te ulet te popullsise.
- ndotja nga mbeturinat – eshte thelbesore eliminimi i tendencies per hedhjen e pakontrolluar te mbetjeve ne rrepirat natyrore, te cilat perfundojn ne rrepat ujore. Masat duhet te merren ne koordinim me projektet e dedikuara per menaxhimin, grumbullimin dhe depozitimin e mbetjeve urbane te Bashkise Tepelene;

Në kontekstin e pergjithshëm, Strategjia Territoriale e Bashkise Tepelene propozon ruajtjen e statusit aktual fizik te trupave ujore, si komponente mjaft te rendesishem natyrore ne nivel rajonal dhe kombetar. Pas Tepelenes, Lumi Vjose kalon edhe neper territorin e 4 Bashkive te tjera deri ne grykederdhjen e vet, keshtu qe eshte thelbesore eliminimi i ndotesve apo nnderhyrjeve demtuese ne shtratin e tyre.



Fig. 30 -Foto e lumit Drinos, prane ures se Leklit, si korridor me vlera panoramike dhe turistike

Eshte mjaft e rendesishme eliminimi i pikes se depozitimit te mbeturinave te Bashkise Tepelene, e cila gjendet ne buze te Lumit Vjose. Se bashku me ndertimin e impiantit te pastrimit te ujrate te zeba, keto jane nderhyrjet me esenciale ne mbrojtje te Vjosës, per periudhen aktuale.

Në aspektin e permiresimit te parametrave natyrore te Sistemit Ujor, propozon rikualifikimin e brigjeve te lumenjve, nepermjet mbjelljes se bimesise autentike. Brezi Drinos – Vjose qe

kalon pergjate territorit te Bashkise Tepelene karakterizohet nga dominimi i Rrapit si lloj mbizoteres. Kjo kulture, se bashku me kultura te tjera si Pisha e Bute (faqet kodrinore) apo Plepat e bardhe mund te ri-instalojen pergjate korridoreve lumore.

Nje tjeter lloj nderhyrje qe propozohet eshte krijimi dhe konsolidimi i korridoreve panoramike natyrore pergjate lumenjve, itinerareve per kembesore apo biçikleta, apo edhe i stacioneve te pushimit per udhetaret pergjate lumenjve Drinos dhe Vjose. Keto nderhyrje kombinohen mjaft mire me rrjetin ekzistues te transportit urban dhe interurban te Bashkise

1.5.7. Propozime për Sistemin Infrastrukturor

Përcaktimet për rrjetin rrugor

Skema e akseve rrugore e Bashkise Tepelene paraqitet e thjeshte, sipas nje sistemi te dallueshem radial, i cili graviton ne qytetin e Tepelenes. Aksi kryesor i rrjetit eshte ai interurban jugor Levan-Tepelene – Gjirokaster. Ky aks perben dhe boshtin kryesor te komunikimit te rajonit jugperendimor i cili mundeson lidhjen me Porten jugore kombëtare të Gjirokastrës.

Me këtë aks lidhen tre akset kryesore rrugore qe perbejne dhe skemen e komunikimit te Bashkise Tepelene

1. Aksi Tepelene – Bençe – Kurvelesh – eshte ne proces rikonstruksioni dhe lidh Tepelenen me fshatrat e Kurveleshit. Mjaft i rendesishem ne kontekstin e zhvillimit te sektorit te turizmit malor dhe agroturizmit ne kete zone. Ka nevoje te lidhet me Himaren, per te siguruar komunikimin me Perendimin dhe daljen ne bregdet.
2. Aksi Tepelene – Dukaj – Sinanaj – Sevaster: nje nga rruget me te vjetra ne Shqiperi. Seksioni Dukaj – Sinanaj ka nevoje urgjente per nderhyrje. Nuk paraqet rentabilitet ekonomik te konsiderueshem.
3. Aksi Kthese e Leklit – Dragot – Kelcyre: rruge nationale, me rendesi strategjike per Bashkine pasi konsiston ne lidhjen me Bashkite Lindore. Problematike eshte Ura e Dragotit (monument kulture) per shkak te rezikut te demtimit nga mbingarkesa e tonazhit te larte. Eshte e nevojsheme nje ure e re. Projekti i By-Passit te Tepelenes planifikon nje ure te re mbi lumin Vjose, duke devijuar uren e Dragotit.

Nderkohe per sa i perket rrugeve lokale dhe akseve te lidhjes te tyre me fshatrat, nje pjese e mire e tyre jane ne gjendje relativisht te mire; nderkohe nevojiten nderhyrje permiresuese per rrujen e Mezhgoranit, rrujen lidhese me fshatit Lekel si dhe thuajse te gjitha rruget e njësise administrative Lopës.

Nje tjeter propozim eshte lidhja (permiresimi) i konektivitetit midis fshatrave te Bashkisë Tepelenë apo dhe me fshatrat e tjerë. Konkretnisht propozohet permiresimi i lidhjes Gusmar – Golem (Bashkia Gjirokaster) ne mbeshtetje te turizmit malor dhe agroturizmit. Gjithashtu propozohet permiresimi i lidhjes midis Nivices dhe Salarise per te krijuar nje tjeter frymemarrje per zonat e Lopesit, duke i integruar gradualisht ne hapesiren agroturistike.

Rrjeti rrugor i qytetit Tepelene eshte ne gjendje relativisht te mire, mundësuar kryesisht nga ndërhyrjet permiresuese fizike te viteve te fundit. Ne kuader te integrimit te zones fushore ne veri te qytetit ne strukturen qendrore urbane, sipas edhe propozimeve te Planit Rregullues



te vitit 1990, eshte e nevojshme qe Plani i Pergjithshem Vendor te rikonceptoje nje skeme rrugore te re per kete hapesire.

Plani i Pergjithshem Kombetar parashikon shtrirjen e linjes hekurudhere edhe pergjate korridorit te Lumin Vjose, ne territorin e Bashkise Tepelene. Sipas PPK, hekurudha do te zgjatet drejt Gjirokastres, duke mundesuar lidhjen me Greqine. PPV i Bashkise duhet te parashikoje pozicionimin e stacionit te trenit prane qytetit, duke marre ne konsiderate edhe percaktimet e Planit Rregullues te vitit 1990.



Fig. 31 -Skeme e propozuar e integrimit te zones veriore, me strukturen ekzistuese te qytetit te Tepelenës

Percaktimet per rrjetin e furnizimit me uje dhe kanalizimet

Skema e furnizimit me uje te qytetit te Tepelenes, duhet te marre ne konsiderate ndarjen nga linja e furnizimit te perbashket me Memaliaj. Volumet e furnizimit duhet te projektohen ne menyre te tille qe tje akomodojnë një rritje të popullsisë të qytetit prej 20% per perspektiven 15 vjeçare te Planit te Pergjithshem Vendor

Linjat e furnizimit me uje te fshatrave duhet te rikonstruktohen sipas skemave ekzistuese, pa marre ne konsiderate shtim potencial te popullsise ekzistuese.

Per shkak te morfologjise se territorit, rrjeti i kanalizimeve te ujerave te zesa te qytetit te Tepelenes duhet te pajiset me impiant teknologjik te pastrimit te ujerave, duke shmangur derdhjen e ujerave ne Lumin Vjose. Pozicionimi i ketij Implanti do te mundesohet ne pjesen veriore te territorit te qytetit. Nderkohe per pjesen tjeter te zonave te banuara te Bashkise,

dhe konkretisht per fshatrat periferike propozohet instalimi i impianteve te vegjel teknologjike te depozitimit - filtrimit te ujerave, te cilet kane kosto te ulet instalimi, kohe te gjate perdorimi si dhe eliminojne teresisht ndotjen.




Fig. 32 -Skeme grafike e sistemeve te propozuara te filtrimit te ujerave ne zonat rurale

Furnizimi me energji elektrike.

Skema e Rrjetit te furnizimit me energji duhet te parashikoje nje rritje prej 20% te popullsise se qytetit te Tepelenes, brenda periudhes 15 vjeçare te Planit te Pergjithshem Vendor. Nderkohe skemat e furnizimit te fshatrave do te vazhdojne me projekte rikonstruksioni te rrjeteve ekzistues. Duke iu referuar nje progoze te ulet te rritjes demografike te Bashkise Tepelene, nuk parashikohen nderhyrje te konsiderueshme ne infrastrukturen e furnizimit me energji elektrike.

1.5.8. Propozimet per shërbimet

Zhvillimet social-ekonomike dhe demografike te viteve te fundit ne Bashkine Tepelene jane reflektuar ne nje renie te konsiderueshme te popullsise si dhe ne nje degradim te nivelit te sherbimeve. Kjo ka ardhur per shkak te mungeses se efiçiences ekonomike te ketyre sherbimeve, per shkak te renies demografike. Aktualisht ne shume zona periferike te Bashkise kemi mbyllje te shkollave apo te qendrave shendetesore.

Strategia propozon nje rigrupim te sherbimeve, e cila do te rezultoje ne uljen e numrit te per gjithshem te shkollave dhe qendrave shendetesore, por do te shkaktoje ne rritjen e cilesise. Megjithate ketu duhet pasur parasysh qe ky rigrupim, mund te shkaktoje nje devijim nga normativat urbanistike per sherbimet arsimore. Per percaktimin e distancave midis institucioneve arsimore dhe zonave te mbulimit jane marre ne konsiderate percaktimet urbanistike empirike, pasi as kuadri rregullator ne fuqi per planifikimin e territorit, dhe as Ligji Nr. 69/2012 "Për Sistemin Arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, nuk identifikojne percaktimet orientuese territoriale. Duke iu referuar ketyre vlerave bazë, distancat e shkollave ne territorin e Bashkise Tepelene duhet te jene:

- Shkolla fillore dhe 9-vjeçare ne vije ajrore eshte 500-600 metra ne zona urbane dhe 1,000-1,500 metra ne zona rurale
- Shkolla e mesme ne vije ajrore eshte 1,000-1,500 m ne zona urbane dhe 2000 – 4,500 m ne zona rurale

Strategja Territoriale e Bashkise Tepelenë propozon qenderzim te funksioneve te Shkolles se Mesme dhe spitalit qendror ne qender (sipas situates ekzistuese), nderkohe qe propozon konsolidimin e nuklev te sherbimeve arsimore dhe shendetesore si me poshte:

- Sinanaj – Njesia Lopës – Shkolla 9-vjeçare “Selam Musa” si dhe një Qender Shendetësore
- Progonat – Njesia Kurvelesh - Shkolla 9-vjeçare “Asim Zeneli” si dhe një Qender Shendetësore
- Dragot – Njesia Qender – Shkolla 9-vjeçare “Jaçe Banushi” si dhe një Qendër Shendetësore
- Dukaj – Njesia Qender – Shkolla 9-vjeçare “Memo Nexhipi” si dhe një Qender Shendetësore




Fig. 33-Skeme propozim per riorganizimin e strukturave arsimore ne Bashkine Tepelenë

1.6. Drejtimet kryesore strategjike të zhvillimit të Bashkisë Tepelenë

1.6.1. Drejtimi Strategjik 1 - Kualifikimi i parametrave territorialë të Bashkisë Tepelenë në funksion të orientimit të rritjes urbane dhe levizjeve demografike në të ardhmen;

Konteksti strategjik i propozuar

Synimi i pare kryesor i kesaj qasjeje strategjike eshte orientimi gradual i rritjes se ardhshme urbane te Bashkise drejt territoreve te qytetit te Tepelenes, nepermjet promovimit dhe mbeshtetjes se iniciativave te zhvendosjes se popullsise se zonave periferike drejt qendres. Ky synim bazohet ne principin e ekonomise se shkalles, percaktuar edhe ne Planin e

Pergjithshem Kombetar, sipas te cilit, popullsia minimale qe duhet te këtë një qendër urbane per te qene e vete-qendrueshme eshte 30,000 banore.


Koncepti i vete-qendrueshmerise ka të bëjë, në rradhë të parë, me aftësinë e një qëndre urbane për ti ofruar mundësi banoreve te saj qe te ndermarrin dhe te administrojnë sipermarrje private, financiarisht rentabël. Nga ana tjeter, administrata publike e një qendre urbane me një popullsi siper limitit te percakatuar prej 30,000 banorësh, ka mundësi qe te gjeneroje te ardhura te mjaftueshme fiskale qe te perballoje kërkësat për sherbime dhe infrastrukturë.

Megjithese mund te vleresohet si një proces disi radikal nga pikepamja e marredhenies se individit me vendbanimin, procesi i urbanizimit, i perkthyer ne terma praktike si zhvendosja e popullsise rurale drejt qendrave urbane, eshte provuar te jete e vetmja alternative ne kushtet aktuale e cila garanton mundesi te rritjes ekonomike dhe sociale. Një bashki e vogel, me një numer te ulet te popullsise dhe te shperndare ne shume nukle te vogla rurale, te vendosura keto ne distance te konsiderueshme nga njera tjetra, e ka praktikisht te pamundur qe te garantoje sherbime dhe infrastruktura me cilesi dhe rentabilitet nga pikepamja financiare. Sasia e te ardhurave vendore qe gjeneron një bashki e tille nga taksat vendore eshte potencialisht mjaft e vogel per te mbuluar nevojen e vazhdueshme per investime publike.

Kësisoj, një bashki e tille e vogël do te varet gjithnjë nga burimet alternative te financimit, qe ne shumicen e rasteve do te jene financimet e qeverise qendore. Kjo situate e vendos kete Njesi Vendore ne status **Jo-Rentabel**, duke bërë qe qarkullimi i parase publike dhe konkretisht i zbatimit te investimeve publike nga qeveria qendore, mjaft te domosdoshme per mireqenien e banoreve, te jete gjithnjë e ndikuar nga situata makro-ekonomike ne nivel kombetar si dhe nga balancat politike.

Megjithe numrin e ulet te popullsise ne nivel qyteti apo ne nivel Bashkie, Tepelena ka mundesi të mira qe te vendose një trend rrites demografik per vitet ne vazhdim, duke marre ne konsiderate pozicionin gjeografik mjaft favorizues te qytetit. Kësosoj, drejtimi i pare strategjik i propozuar në dokumentin e Strategjise Territoriale synon pikerisht që të orientoje tendencat afatgjata te levizjeve demografike ne kete Njësi Vendore, duke percaktuar projekte konkrete te cilat mund te japid forme dhe te orientojne keto tendencia. Gjithsesi, ajo qe duhet theksuar ne kete rast eshte fakti qe levizjet apo zhvendosjet demografike, jo vetem ne Bashkine Tepelene, jane dhe duhet te jene rezultat i iniciatives private te lire te banoreve. Pra, jane vete banoret ata qe do te vendosin nese duhet apo jo te qendrojne ne vendbanimin e tyre apo te zhvendosen drejt nje qendre te re. Ne kete logjike, Bashkia Tepelene si institucion ka një rol promovues dhe mbeshtetes, dhe kurrsesi detyrues.

Synimi i dytë nëpërmjet artikulimit të drejimit te pare strategjik të propozuar është që, përvëç rritjes fizike te territoreve dhe popullsise se qytetit të Tepelenës, të konsolidohen territoret e banuara të Njësise së Kurveleshit, duke evitar renien e metejshme te popullsise se kesaj krahine. Kjo qasje lidhet me potencialin qe ka krahina dhe fshatrat e Kurveleshit per zhvillimin e turizmit natyror malor si dhe turizmin e aventures. Ky potencial ka marre një dinamike te madhe kohet e fundit, kryesisht ne kuader te finalizimit te investimit nga ana e qeverise qendore per rikonstrukcionin e rruges Tepelene-Bënçë-Nivicë. Gjithashtu, sipas te



dhenave te Ministrise se Infrastruktures dhe Energjise, ky korridor i ri do te pasohet me zgjatimin e tij drejt fshatit Kuç, per te dale me pas ne bregdet.



Fig. 34 -Pamje e pllajes se Kurveleshit

Kësisoj, me përfundimin e ketij projekti të rendesishme rajonal, zona e Kurveleshit do te gjendet e pozicionuar përgjate një korridori me një potencial teresist të rivitalizuar, te konsideruar si nga me te bukurit dhe panoramiket e Shqiperise Jug-Perëndimore. Ne kete kontekst, Strategjia Territoriale e Bashkise Tepelene propozon ruajtjen dhe permiresimin e struktureve urbane ekzistuese te te gjithe fshatrave te kesaj krahine, per të mbeshtetur dhe motivuar kështu ruajtjen e numrit te popullsise ekzistuese.

Strategjia Territoriale e Bashkise Tepelene e vlereson si mjaft te rendesishme perfshirjen e strukturave urbane të fshatrave te Kurveleshit ne proceset e zhvillimit te programeve dhe projekteve turistike, ne sinkron me metodologjinë e perdorur ne Programin Kombtar "Akademja 100 Fshatrat". Eshte pikerisht kjo metodologji nderhyrjeje, e cila propozohet qe te replikohet ne menyre te sukseshme edhe ne fshatrat e tjere te krahinës së Kurveleshit.

1.6.1.1. Objktivi 1.1 – Riorganizimi i territoreve urbane të Bashkise ne funksion te rritjes graduale se qendres

Realizimi e ketij objktivi ka te beje me krijimin e incentivave te nevojshme qe do te sherbejne si katalizatore të rritjes urbane të qytetit te Tepelenes. Qasja e dokumentit te Strategjise Territoriale eshte ne rritjen e permasave dhe popullsise se qytetit ne perspektive, duke akomoduar popullsi migratore nga zonat rurale periferike te Bashkise dhe jo vetem, te cilat paraqiten aktualisht ne kushte dhe premisa jo te favorshme per te mbajtuar një trend demografik pozitiv. Ndërkohe, Strategjia propozon mbajtjen e pandryshur popullsine e Njësise Administrative Kurvelesh.




Fig. 35 - Pamje e fushes ne veri te qytetit te Tepelenes, e cila propozohet qe te akomodojo rritjen urbane kryesore te Bashkise ne 15 vitet ne vazhdim

Program 1.1.1.

Akomodimi dhe pershtatja e terreneve urbane periferike te qytetit, ne funksion te rritjes demografike ne perspektive

Projekti 1 - 1.1.1.1 Sistemimi i dy anëve te brigjeve veriore te lumbit Bënçë, pranë grykëderdhjes së saj në Vjosë – eliminim i rreziqeve të permbytjes apo erozionit. Projekti synon qe te konsolidojo territorin verior te qytetit nga pikepamja e sigurise fizike te tij, duke rritur kështu garancine e banoreve te rinj potenciale për investime në këtë zone te re dhe me perspektive te qytetit.

Projekti 2- 1.1.1.2 Hartimi i Projekteve të Detajuara Vendore per zonën veriore të Tepelenës, - duke u fokusuar fillimisht në identifikimin dhe konturimin e korridoreve te reja rrugore, te cilat do te jene edhe linjat kryesore orientuese per zhvillimin dhe transformimin urban te kesaj zone ne vitet ne vazhdim.

Projekti 3 - 1.1.1.3 Ndertimi dhe konsolidimi i rrjetave të infrastruktures fizike (rruge, ujesjelles-kanalizime si dhe furnizim me energji) ne zonën veriore të qytetit te Tepelenes– këtu duhet pasur parasysh qe projektimi dhe percaktimi i parametrave teknike te ketyre rrjetave duhet bere ne respektim te specifikave urbanistike qe përcakton Plani i Pergjithshem Vendor, dhe konkretisht, zonimi funksional i propozuar si dhe treguesit e zhvillimit.

Program 1.1.2

Konsolidimi i territorave te banuara te Njësisë Administrative Kurvelesh

Projekti 4 - 1.1.2.4 Rikualifikimi dhe rikonstrukioni i strukturave ndërtimore ne fshatrat e Kurveleshit, - duke u fokusuar ne prezantimin e teknikave te punimit artizanal të gurit, te kombinuara keto me detaje plotësuese dekorative prej druri dhe hekuri – kjo ndërhyrje synon në përmirësimin e elementeve estetike dhe urbanistike të zonave të banuara te Kurveleshit si dhe duke promovuar një tipologji te re nderhyrjeje urbane, e cila do te duhet te replikohet ne vazhdim per te gjitha fshatrat e kesaj zone

1.6.1.2 Objktivi 1.2 – Përshtatja e territorave jo-urbane përreth qendrave të banuara ne mbeshtetje te rritjes se qytetit te Tepelenes, konsolidim te Kurveleshit dhe migrimit gradual te zonave periferike drejt qendres

Per realizimin e këtij objktivi Strategjia propozon që të ndermerren nje sere projektesh te nevojshme, per gjithesish me karakter mjedor, në funksion te përmirësimin te kushteve fizike te territorave natyrore përreth qytetit te Tepelenes si dhe te zonave te banuara të



Kurveleshit. Keto projekte, se bashku me projektet permiresuese brenda territoreve te banuara synojne permiresimin final te

Program 1.2.1

Krijimi i rrjeteve te parqeve urbane të Bashkisë Tepelenë

Projekti 5 - 1.2.1.5 Krijimi i Parkut Malor te qytetit te Tepelenes – perfshin territoret përgjatë kurrit malor që ze fill ne pjesen e siperme te qytetit dhe vazhdon ne drejtim te jugut, e kufizuar nga te dy anet midis rruges nationale inter-ubane Levan – Tepelene – Gjirokaster si dhe rruges Tepelene – Bençë. Nje projekt i tille do te ndikoje pozitivisht ne permiresimin e imazhit dhe te parametrave urbane te jeteses ne qytetin e Tepelenes, duke permiresuar keshtu premisat dhe potencialin strategjik per sa i perket rritjes se synuar demografike ne perspektive.

Projekti 6 – 1.2.1.6 Krijimi i Parkut Lumor te qytetit te Tepelenes – ashtu si edhe propozimi per Parkun e madh malor, edhe ky projekt synon te permiresoje imazhin dhe treguesit jetesore te qytetit te Tepelenes, nepermjet krijimit te hapësirave të gjelbra rekreative, te kombinuara me panoramen e korridorit lumor të Vjosës. Propozohet te kriohet përgjatë pjesës lindore te qytetit, duke nisur nga zona e plepave ne jug dhe duke vazhduar si brez përgjate lumit të Vjosës, deri prane grykederdhjes së lumit të Bëncës.

Projekti 7 – 1.2.1.7 Krijimi i parkut “Kurora e Kurveleshit” – të radhitur pas njëri tjetrit në pllaje pergjate rruges komunikuese, fshatrat e kësaj krahine kufizohen ne pjesen jugore te tyre me kurrise kodrinore, te cilat propozohet te konvertohen ne menyre graduale ne terrene te pyllezuara. Një nderhyrje e tille do te permiresoje potencialisht treguesit natyrore dhe jetesore te krahines, me një ndikim te konsiderueshem per zhvillimin e turizmit malor si dhe turizmin e aventures.

1.6.2. Drejtimi Strategjik 2 - Zhvillimi Ekonomik i Bashkisë Tepelenë nëpërmjet shfrytëzimit në mënyrë efektive te kapaciteteve dhe potencialeve ekzistues të kesaj Njesie Vendore;

Konteksti strategjik i propozuar

Niveli i ulet i zhvillimit social ekonomik i Bashkise Tepelene eshte shkaku kryesor qe ka ndikuar ne rritjen e tendences migratore, e identifikuar kjo kryesisht ne zonat rurale dhe periferike të kësaj njësie vendore. Mungesa e vendeve te punës si dhe te ardhurat e uleta paraqiten si problematikat kryesore te zhvillimit te Bashkise Tepelenë ne te ardhmen. Situata paraqitet e mberthyer ne kontestin e nje rrathi vicioz, ku zhvillimi i ulet ekonomik stimulon migrimin e popullsise vendase, i cili nga ana e tij stimulon renien e metejshme te ekonomise per pasoje të mungesës se krahut te punës, tregut, etj.

Promovimin e ekonomise vendore, Strategjia Territoriale e Bashkise Tepelene e koncepton te strukturuar ne tre sektore te ndryshem, ku per secilin prej tyre eshte identifikuar objektivi perkates.

‘1.6.2.1. Objktivi 2.1 – Zhvillimi i ekonomisë urbane qytetëse, e orientuar drejt industrisë së lehtë dhe perpunuese

Ky objektiv lidhet dhe ka efekt edhe me percaktimet e Drejimit te pare Strategjik te Zhvillimit te Bashkise Tepelene, ku propozohet rritja hapesinore e qytetit, si nje qender e gravitetit ndaj levizjeve demografike ne perspektive, duke mbeshtetur në këtë menyre krijimin e ekonomise

se shkalles. Ai synon instalimin e strukturave te reja ekonomike rentabel te industrise se lehte dhe përpunimit, e cila ne menyre te domsodoshme duhet te vendosen prane qytetit, per shkak te nevojes dhe afersise me krahun e punes. Dhe pikerisht, zhvillimi dhe konsolidimi i ketyre strukturave te reja ekonomike do te mund te perkthehet ne me shume vende pune per banoret e qytetit te Tepelenes, duke e transformuar keshtu gradualisht ne nje zone te preferuar dhe têrheqëse per te ardhurit e rinj potenciale, nga zonat periferike te Bashkise.

Program 2.1.1

Zhvillimi i zones veriore te qytetit te Tepelenes si poli kryesor ekonomik i te gjithe territorit te Bashkise

Projekti 8 – 2.1.1.8 Projektimi, ndërtimi dhe venia ne shfrytezim i strukturave te magazinimit dhe përpunimit të produkteve blegtorale – në bashkëpunim me sektorin privat, Bashkia Tepelene mund te stimuloje dhe të zhvilloje iniciativat për ndertimin e ketyre strukturave, te pozicionuara prane qytetit. Nje projekt I tille do te jete nje mbeshtetje jo vetem ne aspektin e punesimit dhe te te ardhurave, por ne rradhe te pare do te ishte nje shtyse e rendeshishme promovuese per fermeret dhe blegtoret e te gjithe territorit te Tepelenes apo edhe te njesive te tjera fqinje.

Projekti 9 – 2.1.1.9 Projektimi dhe ndërtimi i zones së magazinimit dhe perpunimit të bimëve medicinale – e mbeshtetur nga karakteristikat fizike natyrore, potencialin e prodhimit te ketyre bimeve në territorin e Bashkise si dhe ne stimulin qe ky aktivitet mund te kete ne ekonomine vendore, ky projekt propozohet te zhvillohet ne pjesen veriore te qytetit;

Projekti 10 – 2.1.1.10 Ndërtimi i thertores se re të Tepelenës – nje projekt i tille mbeshtetet ne traditen lokale te blegtorisë, ku ekzistenza e nje hapesire te konsiderueshme te kullotave dhe te bagetive plotesoher me komponentin e fundit te zinxhirit ekonomik te prodhimit te mishit. Nje projekt i tille duhet shoqeruar me nje vleresim te kujdeshëm te ndikimit ne mjedis, per te evituar efektet negative ne korridoret lumore te Bençes dhe Vjosës.

Projekti 11 – 2.1.1.11 Ndertimin e impiantit eolik prane territorit te fshatit Mamaj (Majkosh) – projekt propozohet prane polit verior te zhvillimit te identifikuar ne qytetin e Tepelenes, dhe i referohet nje projekt i tashme te marre ne shqyrtim nga ana e Bashkise Tepelene.



Fig. 36 -Pamje e zones se propozuar per ndertimin e thertores se re – zona eshte e pozicionuar pergjate rruges Tepelene – Dukaj – Salari, ne krah te ures se Veligotit



1.6.2.2. Objektiv 2.2 - Zhvillimi i ekonomive bujqësore dhe blegtorale në zonat rurale të Bashkisë

Megjithese disponon një sipërfaqe të kufizuar të tokes bujqësore, Bashkia Tepelenë ka mundesi mjaft te mira qe te mbeshtese rritjen ekonomike te saj nepermjet promovimit te ekonomive bujqësore dhe blegtorale. Per shkak te terrenit malor si dhe burimeve ujore ekzistuese, pemëtaria identifikohet si një nga alternativat me te mira aktuale per rivitalizimin e buqesise ne territorin e Bashkise, e shprehur kjo ne menyre specifike ne tipologjine e propozuar te kulturave shumevjeçare. Këto kultura pershtaten mjaft mire edhe me orientimin strategjik per zhvillimin e degeve te ndryshme te turizmit natyror ne territorin e Bashkise, si agroturizmi, turizmi kulinar apo turizmi i aventureve, sektore te cilet nderthuren natyrshem me siperfaqet natyrore te gjelbra.

Nderkohe, krijimi dhe kultivimi i siperfaqeve te reja me peme frutore ne shkalle te gjere ne territorin e Bashkise, krijon mundesi te mira per bletarine, një tjeter mundesi e mire ekonomike, sidomos per zonat periferike te Tepelenes. Bletaria eshte gjithashtu një sipermarrje e cila kerkon pak investim, numer te ulet te krahut te punes, por qe gjeneron te ardhura te konsiderueshme, mjaft te nevojshme per fshatrat periferike te Tepelenes. Gjithashtu, duhet permendur se ky propozim shkon ne një linje edhe me traditen e bletarise qe tashme ushtrohet nga shume banore te fshatrave te Tepelenes.

Nje tjeter element potencial eshte zhvillimi i ekonomive te mbarshimit te peshkut te ujit te embel dhe konkretisht te troftes, e favorizuar kjo nga ekzistencë e burimeve ujore te shumta qe ka Tepelena.

Program 2.2.1

Zhvillimi i iniciativave pilot për zhvillimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale ne Bashkinë Tepelenë

Projekti 12 – 2.2.1.12 Zhvillimi i tre fermave blegorale pilot ne territoret midis fshatrave Progonat dhe Nivicë (Kurvelesh), Dhëmlan dhe Sinanaj (Lopës), Dukaj – Turan (Qender) – të tre zonat disponojne territor te konsiderueshme kullosore, të cilat mund të plotesojne kerkesat per ushqim per një numer te konsiderueshem bagetish, kryesisht te imta. Projekti synon te shfrytezoje kapacitetet ekzistuese te ketyre zonave, duke mundesuar krijimin e strukturave te specializuara per mbare-shtimin e bagëtive ne menyre sa me natyrore, te kombinuar me kullotat në natyrë. Ky propozim perben një nga elementet me te forte te propozimeve lidhur me zhvillimin ekonomik te Bashkise Tepelene, me ndikim si ne sektorin e blegtorise ashtu edhe në agroturizzem.

Shënim: Ky projekt është kompetencë e sektorit privat

Projekti 13 – 2.2.1.13 Zhvillimi i fermave te pemëtarisë tipike malore (rrorë, shëgë, mollë, etj) ne Kurvelesh dhe Lopes – një tjeter propozim eficient që mund të adoptohet në territorin e Bashkise Tepelene eshte edhe zhvillimi i plantacioneve te organizuara te pemeve, te pershtatshme per kultivim ne terrene te larta. Konkretisht, arra eshte një nga pemët frutore me te pershatshem dhe më me leverdi ekonomike per tu kultivuar ne territorin dhe klimen malore të Tepelenes, nderkohe qe mund te permenden edhe kultivare te tjere si sheget, ftonjte, mollët, thanat, etj. Fatkeqesish, këto kultura kultivoohen vetëm në mënyre sporadike dhe individuale nga ana e banoreve te zonave rurale, duke mos gjetur hapësire dhe iniciative per zhvillimin e ekonomive te mirefillta. Nje projekt i tille, nepermjet mbeshtetjes se Bashkise

si bashkefinancues apo garant, do te mund te krijonte mundesi te mira ekonomike per banoret, te ardhura si dhe shtyse per sektorin e turizmit malor apo dhe agroturizmit.

Shënim: Ky projekt është kompetencë e sektorit privat

Projekti 14 – 2.2.1.14 Zhvillimi i fermave per prodhimin e mjaltit në zonen e Kurveleshit, Salarisë, Lopësit, Beçishtit dhe brezit Koder-Lekël-Hormovë – tashme Tepelena ka krijuar një treg simbolik por te dallueshëm per tregëtimin e mjaltit, produkt i cili tregetohet ne menyre ambulatore dhe per gjate rruges nationale interurbane. Projekti synon ne mbeshtetjen dhe fuqizimin e prodhimit te ketij produkti me vlerë ekonomike, duke pasur ne konsiderate potentialin natyror te Tepelenes per prodhimin e mjaltit, nivelin e ulet te ndotjes si dhe siperfaqen e gjelber te nevojshme. Prodhimi i mjaltit kombinohet mjaft mire me siperfaqet natyrore dhe kullosore te Tepelenes, po edhe me territorret qe mund te akomodojne kultivare te rind potenciale te pemetarise si arrat apo mollet (propozuar ne kuadrin strategjik te dokumentit te zhvillimit).

Shënim: Ky projekt është kompetencë e sektorit privat



Fig. 37 -Brezi ujor per gjate Drinosit, prane ures se Leklit, i pershtatshme per ngritjen e vaskave per kultivimin e trofes

Projekti 15 – 2.2.1.15 Nderimi dhe venia ne shfrytezim e vaskave te kultivimit te peshkut te ujerave te embla (trofes) per gjate brezit te lumit Drinos– nje projekt i tillë do te shtoje një tjeter produkt në oferten ekonomike te Bashkise Tepelene. Aktualisht, ne territorin e Tepelenes trofta kultivohet vetem ne vaskat poshte fshatit Hormovë, nderkohe qe mund një prodhim i tillë mund te shtrihet edhe ne segmente te tjera per gjate ketij korridore. Territore te tillë mund te permendim tarracat e Ujit te Ftohte, si dhe brezin fushor te lumit Drinos prane ures se Leklit.

Shënim: Ky projekt është kompetencë e sektorit privat

Program 2.2.2

Përmirësimi i infrastruktures bujqësore dhe blegtorale ne mbeshtetje te zhvillimit te ketij sektori ekonomik

Projekti 16 – 2.2.2.16 Rikonstrukcion dhe rivendosje ne shfrytezim te rezervuarve te Nivices dhe Gusmarit, në mbeshtetje te zhvillimit dhe rivitalizimit te aktiviteteve te prodhimit bujqësor ne zonën e Kurveleshit;

Projekti 17 – 2.2.2.17 Rikualifikimi i parametrave teknike të rezervuarit të Turanit, në mbështetje të kultivimit dhe shfrytëzimit sa me eficjent te tokave bujqësore per gjate perroit të Turanit;



Projekti 18 – 2.2.2.18 Rikualifikimi i parametrave teknike, pastrimi dhe thellimi i rezervuareve ne Sinanaj dhe ne Dhëmblan, në mbështetje të kultivimit dhe shfrytezimit sa me eficient të tokave bujqësore;



Fig. 38 - Pamje e rezervuarit te Turanit, me kapacitet per ujiten e te gjitha territoreve bujqesore pergjate perroit te Turanit

‘1.6.2.3. Objektiv 2.3 - Zhvillimi i Sektoreve të Turizmit kulturor, natyror dhe aventurës

Zhvillimi i turizmit natyror dhe ai i aventure po gjen një terren mjaft te pershtatshem ne hapesirën e Bashkisë Tepelenë. E favorizuar nga karakteristikat natyrore mjaft te përshtatshme, natyra unike, pozicioni gjeografik pranë aksit krysore jugor kombëtar si dhe nga rritja e tendences dhe kerkeses globale per kete kete lloj turizmi, Bashkia Tepelene mund te mbeshtese me sukses një sere projektesh strategjike per mbeshtetjen e ketij sektori.

Një potencial i konsiderueshem per tu shfrytezuar ne Bashkine Tepelene ne kuader te zhvillimit te sektorit te turizmit eshte trashegimia kulturore. Aktualisht, ne territorin e kesaj Njesie Vendore evidentohen disa objekte me vlera te spikatura kulturore, te cilat mund te integrohen ne menyre te suksesshme ne paketen turistike kulturore, duke ofruar keshtu mundesi te medha ekonomike per operatoret lokale, per banoret si dhe per institucionin e Bashkise.

Per kete arsy, Strategjia Territoriale e Zhvillimit propozon projektet në vazhdim si mundësi e mirë për zhvillimin dhe konsolidimin e sektorit turistik në Bashkine Tepelenë. Këto projekte propozohen të mbeshteten dhe promovohen nga ana e Bashkisë, ndërkohe që zbatimi ne terren i tyre eshte subjekt i institacioneve ne nivel qendror.

Program 2.3.1

Rikonstruksioni dhe rikualifikimi i objekteve të trashegimise kulturore – në funksion te përmirësimit të ofertës së turizmit kulturor në Bashkinë Tepelenë;

Projekti 19 – 2.3.1.19 Restaurimi dhe hartimi i planit te menaxhimit te kalase se Tepelenes – përbën ndoshta një nga projektet me ambicioze ne territorin e Bashkise, per shkak te permasave të kalasë, pozicionit dhe rolit te saj ndaj skemes funksionale te qytetit si dhe ndikimit të madh potencial që ka në ekonomine turistike të Bashkisë. Projekti i propozuar eshte një nderhyrje komplekse, me iniciative te Bashkise por me monitorim te plete te institacioneve përgjegjese shteterore, ne kete rast nga Instituti i Monumenteve te Kultures.

Projekti propozohet ne vazhdim te iniciatives se fundit te ndermarre nga Bashkia Tepelene dhe te mbeshtetur nga qeveria qendrore per rivitalizimin e sheshit qendror te qytetit, duke permiresuar dhe sistemuar strukturen e murit te jashtem te kalase.

Shënim: Ky projekt është kompetencë e Ministrisë së Kulturës




Fig. 39 -Pamje e kalasë se Tepelenës, ne qendër te qytetit

Projekti 20 – 2.3.1.20 Restaurimi pjesor i rrenojave te kalave te Matohasanaj, Leklit dhe Nivicës; - te tre objektet mund te përfshihen potencialisht ne paketen turistike te Tepelenës, pas nderhyrjeve permiresuese fizike si dhe promovimit ne itineraret turistike nga ana e Bashkise apo operatoret turistike vendore. Paketat turistike ne kete rast mund te kombinojne turizmin kulturor me atë të aventurës.

Shënim: Ky projekt është kompetencë e Ministrisë së Kulturës

Projekti 21 – 2.3.1.21 Rikonstruksioni dhe rikualifikimi i pote i muzeut të Tepelenës – evidentuar edhe nga ana e institucionit te Bashkise si një nevoje imediate, projekti synon permiresimin e parametrave fizike te muzeut ekzistues te qytetit, riorganizimin e ambienteve te brendshme te ekspozimit, si dhe kualifikimin e mjediseve te jashtme. Qellimi final i projektit eshte perfshirja e sukseshme e ketij objekti ne paketen turistike kulturore të Tepelenës, të kombinuar me Kalane e qytetit si dhe me destinacionet e spikatura kulturore;



Fig. 40 -Pamje ballore e muzeut të qytetit të Tepelenës të propozuar për ristrukturim



Projekti 22 – 2.3.1.22 Ndertim i muzeut etnografik te Kurveleshit – bazuar ne historine e fshatrave te kesaj krahine si dhe ne kuader te propozimit strategjik per zhvillimin e turizmit ne kete zone, qellimi final i projektit eshte te rrise numrin e destinacioneve turistike per vizitoret e zones, dhe si rrjedhim, te ardhurat per komunitetin lokal dhe Bashkise.

Projekti 23 – 2.3.1.23 Restaurim i shtepise se Ali Pashe Tepelenes ne fshatin Beçisht – projekti synon te perfshije ne paketen turistike te Tepelenes shtepine e lindjes se personazhit me te shqar te historise se trevave te Tepelenes.

Shënim: Ky projekt është kompetencë e Ministrisë së Kulturës

Projekti 24 – 2.3.1.24 Restaurim i kishave te Leklit – projekti integrohet me se miri edhe me propozimin per zhvillimin e itinerarit turistik fshat Koder, Lekel, Hormove, te propozuar ne vazhdim ne dokumentin strategjik.

Shënim: Ky projekt është kompetencë e Ministrisë së Kulturës

Projekti 25 – 2.3.1.25 Restaurim i shtepise se Selam Musait ne fshatin Salari – perben ndoshta te vetmin element potencial kulturore per zonen e Salarise, dhe propozohet te perfshihet ne paketen e zhvillimit te produkteve turistike te Tepelenes

Shënim: Ky projekt është kompetencë e Ministrisë së Kulturës




Fig. 41 -Panje e gjendjes se shkatteruar te shtepise se Selam Musait ne fshatin Salari

Program 2.3.2

Përmiresimi i hapësirave publike të zonave rurale në mbështetje të zhvillimit të turizmit të aventurës

Projekt 26 – 2.3.2.26 Rikonstruksion i qendres se fshatit Dukaj – fshati eshte i pozicionuar pergjate rruges se vjetër Tepelene – Sevester – Vlore dhe aktualisht funksionon si stacion i pare për qarkullimin midis Tepelenes dhe zonave te thella te Njesise Administrative Lopes. I pozicionuar relativisht afer qytetit te Tepelenes, ai perben nje destinacion te mundshem dhe interesant per turistet e aventures, te cilet synojne eksplorimin e territorave rurale dhe natyrore ne veri-perendim te qytetit te Tepelenes. Per kete arsy, projekti i propozuar ka per qellim te permiresoje parametrat fizike urbanistike te qendres se fshatit, e cila ne gjendjen ekzistuese eshte teresisht jashtë standartit.





Fig. 42 -Pamje e gjendjes ekzistues te qendres se fshatit Dukaj

Projekti 27– 2.3.2.27 Rikonstruksion dhe rikualifikim i qendrës së fshatit Progonat; - projekt i synon të ri-adoptojë modelin e nderhyrjes rikualifikuese, te zbatuar ne qendren e fshatit Nivicë, në kuader te programit “Akademia 100 Fshatrat”, ne funksion te permiresimit te imazhit urban te fshatit me te madh te Krahines se Kurveleshit.

Projekti 28 – 2.3.2.28 Rikonstruksion i hapesirave të brendshme të kater fshatrave të Lopësit (Dhëmblan, Matohasanaj, Sinanaj dhe Lab-Martalloz) – në kuadër të përmirësimit te kushteve baze të jetesës për zonat periferike të Bashkisë Tepelenë, të cilat po perjetojne një largim gradual te popullsise vendase. Projekt i synon te garantoje kushtet normale të struktura urbane te fshatrave, te nevojshme per banoret qe vazhdojne te jetojne ne keto zona.



Fig. 43 -Pamje e gjendjes ekzistues te fshatit Matohasanaj – Njësia Administrative Lopës

Projekti 29 – 2.3.2.29 Rikonstruksion i hapesirave të brendshme të fshatrave Peshtan, Dragot, Luadh dhe Mezhgoran – të katër keto vendbanime jane te pozicionuar ne shpatet e malit te Shendellise, dhe kane probleme te medha ne cilesine e hapesirave te brendshme te banimit. Aktualisht, me perjashtim te fshatit Dragot, ne te cilin jane kryer disa permiresime te aksit rrugor, ne asnje nga fshatrat e tjere nuk jane kryer nderhyrje rehabilituese fizike. Projekt i synon te ofroje kushtet baze te hapesirave per banoret e ketyre zonave te cilet po zhvendosen gradualisht drejt qendres se Tepelenes apo edhe ne zona te tjera.






Fig. 44 - Pamje te hapesirave te brendshme te fshatit Beçisht

Programi 2.3.3

Krijimi dhe promovimi i itinerareve turistike natyrore, në mbeshtetje të turizmit të aventurës

E favorizuar nga karakteristikat natyrore, reliivi i thyer malor qe ofron panorama mjaft terheqese, si dhe nga ekzistencë e vendbanimeve rurale prane njeri tjetrit, ne Bashkine Tepelene mund te akomodohen itinerare turistike malore, te pershtatshem per te pasionuarit pas "hiking". Ky lloj turizmi, fatmiresisht po gjen një terren te favorshem ne te gjithe zonat periferike kodrinore dhe malore te Shqiperise, gje qe eshte marre ne konsiderate edhe ne dokumentin strategjik te Bashkise Tepelene. Zhvillimi i ketij lloj turizmi konsiderohet te jete hapi i pare per te promovuar elementet baze te industrise turistike malore ne zonat periferike veriore te Tepelenes, per te stimuluar me pas zhvillimin e pikave te akomodimit, bujtinat, perpunimin e produkteve autentike te zones, etj. Koncepti i itinerareve konsiston ne krijimin e materialeve te nevojshme informuese, hartografike, ngritjen e pikave te informacionit, instalimin e sinjalistikes, si dhe stacioneve te nevojshme.

Projekti 30 – 2.3.3.30 Krijimi i itinerarit turistik midis fshatrave Koder, Lekël dhe Hormove – te pozicionuar ne shpatin e malit te Golikut dhe perjgjate grykes se Drinosit, te tre fshatrat ofrojnë mundesine e zhvillimit te një itinerari malor panoramik, ne te cilin mund te vizitohen tre fshatrat, kishat e Leklit, kalaja, qendra e Hormoves, etj. Ky itinerar mund te zhvillohet edhe me tej, duke perfshire Laboven (Bashkia Gjirokaster) dhe per te perfunduar ne fushe Çajup (Bashkia Libohove).

Projekti 31 – 2.3.3.31 Krijimi i itinerarit turistik Mezhgoran - Luadh - Peshtan – te pozicionuar ne te dy anet e Grykes se Mezhgoranit, ky itinerar propozohet si një aventure eksplorimi e grykes se thyer malore, e cila kulmon me dy fshatrat ne kufirin lindor te Bashkise Tepelene. Ky itinerar mund te vazhdoje ne menyre graduale ne pjesen veriore te Mezhgoranit, dhe pikerisht perjgjate kurrizeve malore te Shendellise dhe Trebeshines, per te arritur me pas ne fsharat Arrëz dhe Maricaj, pjesë te Bashkise Memaliaj.

Projekti 32 – 2.3.3.32 Krijimi i itinerarit turistik Tepelene – Lopës – eshte një nga itineraret me sfidues te propozuar ne territorin e Bashkise per shkak te distances se konsiderueshme midis destinacioneve te tij. Itinerari propozon te kaloje perjgjate rruges ekzistuese Tepelene – Selenice, duke pershkuar fsharat Veliqot, Turan, Dukaj, per te vazhduar me pas drejt Lopesit

me fshatrat Lab-Martaloz, Dhemblan, Matohasanaj, dhe Sinanaj. Ky itinerar panoramik pergjate shpateve lindore te Tresenikut dhe Komtirit mund te zgjatet me tej, duke zbritur poshte drejt Dorëzit, për të kaluar lumen Vjosë dhe per te dale me pas ne Kalivaç (Bashkia Memaliaj).



Fig. 45 -Pamje e lagjes se poshtme të fshatit Dhemblan, pjese e itinerarit turistik Tepelene - Lopës

Projekti 33 – 2.3.3.33 Krijimi i itinerarit turistik Bënçë- Kurvelesh – duke përfshire akuaduktin e Ali Pashës si dhe kanionet e Progonatit dhe te Nivicës – Zona e Kurveleshit propozohet si zona prioritare e zhvillimit te turizmit malor dhe aventureve ne territorin e Bashkise Tepelene. Finalizimi i projektit te rruges Tepelenë – Nivice do te perbeje elementin me te rendesishem promovues dhe mbeshtetes per te zhvillimin e pese fshatrave te Krahines. Projekti i itinerarit turistik “hiking” propozon te zhvilloje një alternative plotesuese ndaj rruges se re, duke perfshire ne te elemente te forte panoramike si ballkonet lumore te Bençes, zona pushimi te gjelbra, zona campingu, etj.

Projekti 34 – 2.3.3.34 Krijimi i itinerareve vertikale te Kurveleshit – lidhja e fshatrave te Kurveleshit me kanionet, nepermjet monopateve te pershtatura, shkallareve, etj, per te mberritur ne kanionet e famshme te Progonatit dhe Nivices. Aktualisht, keto destinacione jane mjaft te veshtra per tu arriut per shumicen e udhetareve, duke bere qe zona te mos arrije te shfrytezoje potencialin me te madh turistik qe disponon. Keto itinerare jane te perfshira si një komponent metodologjik te zhvillimit per fshatin Nivice, ne kuader te programit “Akademia 100 Fshatrat”;





Fig. 46 -Pamje e kanioneve pergjate rruges Bençë - Lekdush

Projekti 35 – 2.3.3.35 Zhvillimi dhe promovimimi i itinerarit Tepelene - kurrizi malor te majes se Fajkoit – duke marre shkas nga pozicioni i qytetit ne fund te kurrit malor, propozohet itinerari I cili pershkoni te gjithe kreshten, per te perfunduar ne majen e Barit. Pllaja Karstike e Buzes se Derrit eshte nje nga elementet natyrore me te spikatur te territorit te Bashkise Tepelenë, me lartesi qe luhatet midis 1400-1500 metra, dhe me valëzime te buta te cilat shtrihen deri prane pllajes se Kurveleshit.





Fig. 47 -Paraqitje skematike e itinerarit Teperele – Maja e Fajkoit

Projekti 36 – 2.3.3.36 Krijimi i itinerarit turistik Nivice – Salari – propozohet pergjate monopatit ekzistues qe lidh dy fshatrat, qe kalon pergjate qafës se Kreshës, e pozicionuar midis Trezenikut dhe Kendrevices. Paraqitet si nje itinerar interesant dhe me vlore per shkak se kalon ne nje gryke te panjohur dhe me bukuri natyrore, por edhe sepse lidh krahinen e Kurveleshit me itinerarin tjeter te turizmit te aventures Tepelene Lopës. Per shkak te largesise se konsiderueshme nga qendra e Bashkise, propozohet qe ne fshatin Salari te krijohet nje strukture e posacme, e specializuarper rastet e dhenies se ndihmes per udhetaret.



1.6.3. Drejtimi Strategjik 3 - Përmirësimi i rrjeteve te infrastrukturave dhe shërbimeve në mbështetje te transformimeve strategjike territorial:

Permiresimi i infrastrukturave dhe sherbimeve perben dhe paketen kryesore te nderhyrjeve strategjike qe propozon dokumenti, qe ka lidhje te drejtperdrejte dhe ndikim te madh ne zhvillimin perspektiv te treguesve social ekonomike te Bashkise Tepelene. Per shkak te pozicionit te veçuar gjeografik te shumices se vendbanimeve rurale, tendences së largimit te popullsise se fshatrave, por edhe asaj te qytetit, si dhe mungeses se investimeve nga ana e autoriteteteve, thuajse ne te gjitha fshatrat e kesaj Njesie Vendore evidentohen probleme te theksuara per sa i perket rrjeteteve te infrastrukturave dhe sherbimeve. Situata paraqitet mjaft me e mire ne qytetin e Tepelenes, fale investimeve relativisht te konsiderueshme qe jane kryer vitet e fundit nga ana e Bashkise dhe qeverise.

Ne perfundim te analizes se per gjithshme te territorit, thuajse ne te gjitha hapesirat rurale te Bashkise Tepelene jane evidentuar mungesa dhe problematika ne treguesit standarte te furnizimit me uje, kanalizimeve te ujerave, rrjeteteve te furnizimit me energji elektrike, etj. Po ashtu problematike per kete njesi vendore mbeten çeshtjet qe kane te bejne me grumbullimin dhe depozitimin e mbetjeve urbane, si dhe ato qe kane te bejne me sherbimet shendetesore dhe arsimore.

1.6.2.4. Objektiv 3.1 – Përmirësimi dhe rikualifikimi i rrjetit te komunikimit te Bashkisë Tepelenë

Program 3.1.1

Hapja e rrugeve te reja dhe plotesimi i rrugeve ekzistuese Tepelenës – programi synon që të finalizojë ndërhyrjet përmirësuese te ndermarra vitet e fundit në qytet për rikualifikimin e rrjetit te rrugeve si dhe korridoreve te komunikimit.


Projekti 37 – 3.1.1.37 Ndertimi i rruges se re Kisha e Shen Thomait – bypassi i Tepelenës. E planifikuar prej kohesh nga ana e Bashkise, kjo rruga synon qe te permiresoje komunikimin e brendshem te qytetit.

Projekti 38 – 3.1.1.38 Zgjatimi ne veri i rruges Elmaz Teme Bilbili dhe bashkimi i saj me rrugën Tafil Buzi, prane Spitalit Bashkiak të qytetit – kjo rruga propozohet te kthehet si unaza lindore e qytetit, e cila do te permiresoje akoma me shume lidhjen e spitalit me rrjetin e qytetit si dhe shfryrjen e rrugeve te brendshme.

Projekti 39 – 3.1.1.39 Krijimi i shkallareve lidhëse midis zonave urbane te pozicionuara ne disnivele. Konkretnisht propozohen shkallare panoramike qe lidhin rrugen veriore Elmaz Teme Bilbili me fushen poshte Tepelenes. Gjithashtu propozohen shkallare te cilat lidhin kryqezimin jugor te qytetit me lagjen poshte te lumenit. Keto shkallare mund te orientohen edhe ne drejtim te ures se Ali Pashes, per te lehtesuar levizjen e kembesoreve drejt fshatit Beçisht, ne faqen malore perballë Tepelenes.

Program 3.1.2

Kompletimi i rrjetit te rrugëve lidhëse të fshatrave te Bashkise Tepelene – ashtu siç eshte trajtuar edhe ne analizen e per gjithshme te Bashkise, eshte e nevojshme ndermarrja e nderhyrjeve permiresuese ne shume nga akset e rrugeve rurale.



Projekt 40 – 3.1.2.40 Rikonstruksioni dhe shtrimi i rrugës Luadh – Mezhgoran

Projekti 41 – 3.1.2.41 Rikonstruksioni i rruges se Beçishtit

Projekti 42 – 3.1.2.42 Rikonstruksioni i rrugëve lidhëse të fshatrave të Golikut – Kodër, Lekël dhe Hormovë, me rruget kryesore interurbane Tepelenë – Gjirokastër si dhe Tepelenë – Përmet.

Projekti 43 – 3.1.2.43 Rikonstruksioni i rruges se Lopesit – konkretisht behet fjale per aksin Dukaj – Sinanaj, dhe përbën një nga sfidat më të medha per sa i perket rikonstrukcionit te rrjetit rrugor te Bashkise Tepelene, duke zgjidhur perfundimisht problematiken e komunikimit me Salarine dhe fshatrat periferike te Lopesit.

Projekti 44 – 3.1.2.44 Rikonstruksioni i rrugës Dukaj – Memaliaj – ky aks do te mundesoje përmirësimin e lidhjes me lagjen Kordhaj, per te vazhduar me pas me daljen ne aksin interurban Tepelene Levan, prane Memaliaj fshat. Kjo dalje do te permiresoje komunikueshmerine te zonave te banuara te zones.

Projekti 45 – 3.1.2.45 Rikonstruksioni i rruges Sinanaj – Dorëz – behet fjale per aksin me periferik te Bashkise Tepelene, e cila kalon permes fshatit, tashme thuajse te braktisur, te Dorezit per te dale deri ne breg te lumbrit te Vjosës. Projekti propozohet ne sinergji me projektin per plotesimin e ures se pambaruar mbi Vjose. Kjo rruga, si dhe lidhja e saj permes ures se re me fshatin Leshnje te Bashkise Memaliaj, do te mundesoje një komunikim shume te shpejte dhe te favorshem per fshatrat e Lopesit me aksin interurban Tepelene Levan.

Program 3.1.3

Përmirësimi dhe konsolidimi i rrjetit të urave ne territorin e Bashkise Tepelene -

Aktualisht, per shkak te karakteristikave natyrore si dhe ekzistences se lumenjve dhe perrenjve, ne territorin e Bashkise Tepelene funksionojne kater ura, te cilat mundesojne komunikimin e qendrave te banuara me njera tjetren. Nga analiza e gjendjes ekzistuese mund te veçojme:




Fig. 48 - Pamje e ures se Leklit mbi lumin Drinos

- Ura e qytetit te Tepelenes – pjese e aksit rrugor Levan – Tepelene – Gjirokaster ndodhet ne pjesen veriore te qytetit, mbi lumin e Bençes, prane grykederdhjes ne lumin Vjose. Eshte ure e re dhe ne gjendje shume te mire teknike.
- Ura e Leklit – ure me strukture metalike kapriate, prodhim francez, e montuar ne vitin 1928 mbi lumin Drinos.



- Ura e Dragotit – ure me strukture metalike, ndertuar ne vitin 1936 – lumi Vjose
- Ura e Bençes – lidh Tepelenën me Dukaj dhe fshatrat e Njesise Administrative Lopes – lumi I Bençes
- Ura e Peshtanit – ure e re me strukture betonarme qe lidh fshatin Peshtan me rrugen interurbane Tepelene Kelcyre – lumi Vjose
- Ura e Hormoves – ure e varur mbi lumin Drinos qe lidh fshatin Hormove me rrugën Tepelene Gjirokaster.
- Ura e Ali Pashes – poshte kalase se qytetit, mbi lumin Vjose. Eshte ura me e madhe ne Bashkine Tepelene, me strukture te varur dhe e pershtatshme vetem per kembesoret qe shkojne ne Beçisht apo ne Dragot
- Pasarela e Bençes – ure me funksion blegtoral, sherben per kalimin e bagetive ne kullotat përballë fshatit të Bençes.

Ndërkohe ne kete liste nuk permenden disa ura te vogla qe gjinden per gjate rruges Tepelene Lopës si ura poshte fshatit Turan, ura ne Sinanaj etj. Ne baze te perfundimeve te analizes si dhe kontekstit strategjik te zhvillimit te Bashkise, propozohen ndërhyrjet si me vazhdim;

Projekti 46 – 3.1.3.46 Ndertimi i ures se re te Dragotit – propozimi synon ruajtjen e ures ekzistuese te Dragotit, monument kulture, nga trafiku i rende dhe shhangjen e ketij trafiku mbi një ure te re strukture beton-armej. Kjo ure propozohet te ndertohej shume prane ures ekzistuese metalike.

Projekti 47 – 3.1.3.47 Ndertimi i ures se re te Leklit – ashtu si edhe ne rastin e ures së Dragotit, propozohet ndertimi i një ure te re, prane urës se vjeter, me qellim ruajtjen e struktura metalike monument kulture.

Projekti 48 – 3.1.3.48 Ndertimi i një ure te re mbi perroin e Rapeve. Propozimi lidhet me projektin per rikostrucionin e rruges Sinanaj-Dorëz-Vjosë, e cila do te shërbejë edhe si shkurtim i rruges qe lidh fshatrat e Lopesit me rrugen Levan Tepelene.



Fig. 49 - Pamje e ures se paperfunduar mbi lumin Vjose, prane grykes se Kalivaçit

Projekti 49 – 3.1.3.49 Ndertimi (plotesimi) i urës mbi Vjosë që lidh Dorezin me fshatin Leshnje te Bashkise Memaliaj. Duhet thene qe ky projekt do te varet nga ecuria e zhvillimit te projektit te hidrocentralit te Kalivaçit, ku pritet te krijohet një ligen artificial.

Program 3.1.4

Konsolidimi i rrjetit të transportit publik ne te gjitha zonat e banuara te Bashkise – aktualisht lidhja e qytetit te Tepelenes me zonat e saj rurale periferike kryhet nepermjet automjeteve private apo mikrobuseve qe nisen nga qendra Ali Pashe Tepelena. Nuk funksionon nje sistem i strukturuar transporti publik per zonat periferike, problematike kjo qe perkeqeson akoma me tej situaten social ekonomike te fshatrave te Bashkise. Situata veshtiresohet kryesisht nga gjendja e veshtire e akseve rrugore lidhese si edhe nga numri i ulet i banoreve te ngelur ne keto fshatra.

Ndërkohe, transporti publik nderqytetes eshte funksional, nepermjet linjave te autobuseve qe lidhin qytetin e Tepelenes me qytetet fqinje. Qyjeti I Tepelenes, per shkak te permasave te vogla nuk disponon transport publik qytetes. Po ashtu nuk ekziston linja hekurudhore, edhe pse ne Planin e Pergjithshem Kombetar parashikohet shtrirja e linjes hekurudhore Fier – Gjirokaster – Greqi.

Ajo qe duhet theksuar ne vleresimin e transporrit publik eshte mungesa e nje stacioni multimodal gjitheperfshire, si per transportin nderqytetes ashtu edhe per ate rural. Projektimi dhe zhvillimi i nje stacioni te tille eshte prerogative e percaktuar ne Planin e Pergjithshem Kombetar dhe ne Strategjine Sektoriale te Transportit dhe Planit te Veprimit 2016-2020

NR	Linja Kryesore	Nr. Orareve	Nr. Autobusave
1	TEPELENE – VLORË – TEPELENË	1 (një)	2 (dy)
NR	Linja ushqyese		
1	TEPELENË - MEMALIAJ – TEPELENË	6 (gjashtë)	3 (tre)
2	TEPELENË – GJIROKASTËR- TEPELENË	3 (tre)	3 (tre)
3	TEPELENË – PËRMET – TEPELENË	1 (një)	2 (dy)

Fig. 50 -Rrjeti i linjave nderqytetese te Bashkise Tepelene – miratuar nga Ministria e Infrastruktures dhe Energise

Projekti 50 – 3.1.4.50 Ndërtimi i stacionit multimodal te transportit ne Tepelene – perben nderhyrjen kryesore per riorganizmin e te gjithe sistemit te transportit publik ne Bashkine Tepelene. Propozohet tё ndertohet nё pjesën veriore te qytetit, duke akomoduar hapesirat e nevojshme edhe pёr ndertimin ne perspektive te stacionin e trenit.

Projekti 51 – 3.1.4.51 Krijimi dhe konsolidimi i linjave te transportit lokal, - dhe konkretisht lidhjeve te qytetit me fshatrat periferike. Aktualisht propozohet percaktimi dhe venia ne funksionim i kater linjave te transportit publik;

- Linja Mamaj – Tepelene (stacion) – Luzat – Hormove – nje pike qendrimi sekondare (ura e Leklit) si dhe dy pika qendrimi terciare (kthese e Luzatit dhe kthese e Hormoves)
- Linja Lekel – Dragot – Luadh - Mezhgoran. Kjo linjë ndërkohë perfshin edhe "devijimet" Peshtan dhe Beçisht – parashikohet nje pike qendrimi

sekondare (Dragot) si dhe katër pika qendrimi terciare (Beçisht, kthesa e Mezgoranit, kthesa e Peshtanit, kthesa Kodër)

- **Linja Tepelenë (stacion) - Nivicë** – përfshin 5 pika qendrimi terciare (Bënçë, Lekdush, Progonat, Gusmar dhe Nivicë)

- **Linja Tepelenë (stacion) – Lopës** – përfshin të gjitha fshatrat qe kalojne per gjate rruges Tepelene – Lopes si Veliqot, Turan, Dukaj, Salari, Lap- Martallov, Dhembilan, Matohasanaj, Sinanaj. Gjithashtu parashikohen edhe 6 pika qendrimi terciare.

‘1.6.2.5. Objektiv 3.2 – Permiresimi i rrjetit te furnizimit me uje në qytetin e Tepelenës dhe në zonat rurale

Program 3.2.1

Ristrukturimi i pote i rrjetave të ujesjellesave te fshatrave - Aktualisht, sipas te dhenave zyrtare te Bashkise Tepelene, ne inventarin e ndermarrjes se Ujesjelles-Kanalizime Tepelene SHA rezultojne 22 sisteme furnizimi me uje per qytetin dhe fshatrat. Nderkohe te dhenat teknike per sa i perket furnizmit me uje te zonave urbane paraqesin një situate problematike per sa i perket orarit te furnizimit si dhe sasive. Gjate viteve te fundit, ne saje te riorganizimit te punes nga ana e ndermarrjes jane kryer një sere permiresimesh fizike ne shume nga zonat e Tepelenes. Aktualisht, lidhur me kete element te rendesishem te infrastrukture, Strategjia propozon:

Projekti 52 – 3.2.1.52 Rikonstruksioni i rrjetit te brendshem te furnizimit me uje te fshatrave Lekdush, Progonat dhe Gusmar, Njesia Administrative Kurvelesh

Projekti 53 – 3.2.1.53 Rikonstruksioni i rrjetit te furnizimit me uje te fshatrave Sinanaj, Matohasanaj dhe Dhëmblan te Njesise Administrative Lopes.

Projekti 54 – 3.2.1.54 Rikonstruksioni i rrjetit te furnizimit me uje te fshatrave Hormove, Koder dhe Lekel

Projekti 55 – 3.2.1.55 Rikonstruksion i rrjetit te furnizimit me uje te fshatrave Beçisht, Mezgoran dhe Dragot

‘1.6.2.6. Objektiv 3.3 – Permiresimi i rrjetit te kanalizimeve te ujerave në qytetin e Tepelenës dhe në zonat rurale

Problemi kryesor qe lidhet me rrjetet e kanalizimeve te ujerave te zeza ne Bashkine Tepelene Jane mungesa e strukturave/impianteve te posaçme per trajtimin e ujerave te perdonura. Aktualisht, asnjë nga zonat e banuara ne kete njesi vendore nuk disponon linja apo infrastrukturre perkatese per trajtimin dhe purifikimin e ujerave. Situata eshte mjaft problematike ne qytetin e Tepelenes, ku ujërat e zeza derdhen direkt në lumin Vjosë. Propozimet strategjike për këtë komponent të rendësishem të infrastrukturës synojnë permiresimin e situates se rrjetave ne qendrat e banuara qe ndodhen prane trupave ujore, me qellim shhangjen e ndotjes. Konkretnisht, propozohen:



Program 3.3.1

Krijimi i rrjetit te impianteve te pastrimit dhe purifikimit te ujerave te zeza

Projekti 56 – 3.3.1.56 Ndertimi i impiantit te pastrimit te ujerave te zeza urbane te qytetit të Tepelenës – propozohet te instalohet ne pjesen veriore te qytetit, dhe pikerisht ne zonen fushore ne krah të lumbit te Vjoses. Ne kete impiant mund te akomodohet edhe trajtimi i ujerave te zeza te fshatrave Veliqot dhe Mamaj

Projekti 57 – 3.3.1.57 Rikonstruksioni i rrjetit te kanalizimeve si dhe impianti septik teknologjik ne fshatin Dragot.

Projekti 58 – 3.3.1.58 Rikonstruksioni i rrjetit te kanalizimeve si dhe impianti septik teknologjik ne fshatin Bënçë.

Projekti 59 – 3.3.1.59 Rikonstruksioni i rrjeteve te kanalizimeve dhe impiantet septike teknologjike te fshatrave te krahines se Kurveleshit.

'1.6.2.7. Objektiv 3.4 – Përmirësim i sistemit të grumbullimit dhe depozitimit të mbetjeve urbane

Duke iu referuar percaktimeve strategjike ne nivel kombtar, mbeturinat e Bashkise Tepelene do te kene si destinacion final landfillin rajonal te Bajkaj në Bashkine Delvine. Ky landfill eshte ne shfrytezim, por shfrytezimi i tij nga ana e Bashkise Tepelene do te mundesohet vetem pas finalizimit te aksit te ri interurban Kardhiq – Delvine, i cili do te shkurtoje ne menyre te ndjeshme distancen e zhvendosjes se mbetjeve. Ndërkokë, nje skenar i tillë do te kerkoje ne menyre te domosdoshme uljen e konsiderueshme te sasive te mbetjeve te gjeneruara ne territorin e Bashkise Tepelene, dhe si rrjedhim uljen e kostove te transportit dhe te depozitimit ne landfillin rajonal.

Dumpsite'i aktual ne Bashkine Tepelene eshte mjaft problematik per shkak te pozicionit te tij prane lumbit te Vjoses, si dhe mungeses se parametrave teknike per mbrojtjen e zonave përreth tij nga ndotja. Mungesa e këtyre parametrave bën që shumë mbeturina plastike, kryesisht qese, te përfundojne ne zonat perreth si dhe ne lumin Vjose. Po ashtu problematike mbetet mungesa e masave teknike ndaj ndotjes se ujerave nga filtrimet qe shkaktohen gjate periudhes se shirave.

Strategja propozon eliminimin e plote te ketij dumpsite'i si dhe ndërtimin e një pike te re depozitimi për të gjithe Bashkinë Tepelenë, në distance nga trupat ujore si dhe e mbrojtur nga korrentet ajrore te forta, karakteristike për gryken e Vjosës.

Ndërkohe propozohet ndertimi i nje serie pikash tranzit te depozitimit te mbetjeve, ne te cilat do te grumbullohen mbetjet e gjeneruara nga grupet e fshatrave, në varësi të afersise midis tyre dhe skemes se grumbullimit. Me pas, mbeturinat nga keto pika do te transportohen drejt pikes qëndrore te re te depozitimit, dhe me pas ne drejtim te landfillit rajonal te Bajkaj,

Program 3.4.1

Ristrukturimi i pikës qëndrore të depozitimit të mbetjeve (dumpsite) në Bashkinë Tepelenë.

Projekti 60 – 3.4.1.60 Ndërtimi i pikës së re qëndrore te depozitimit te mbetjeve – pika e re propozohet qe te pozicionohet në gryken e perroit te Turanit. Pika është në një pozicion qendror referuar strukturës hapësinore te Bashkise, afër akseve qendrore të komunikimit si dhe e mbrojtur ndaj korrenteve te ererave te grykes se Vjosës. Propozimi konsiston ne krijimin e nje pike depozitimi te mbuluar me strukture te lehte, duke penguar depertimin e ujerave te shiut si dhe me hapesirat dhe infrastrukturen e posaçme per ndarjen dhe riciklimin e mbetjeve.

Projekti 61 – 3.4.1.61 Eliminimi i pikës aktuale të depozitimit të mbetjeve të Bashkisë Tepelenë, pranë lumit Vjosë. - Projekti ka rendësi specifike duke i vene fokusin pastrimit te plete te terrenit te dumpsite'it ekzistues si dhe zonave te ndotura. Gjithashtu projekti duhet te kete ne konsiderate rivitalizimin mjedisor te terrenit, dhe sidomos nëpermjet pyllëzimit.


Projekt 62 – 3.4.1.62 Ndërtimi i pese pikave tranzit te depozitimit te mbetjeve per zonat rurale – konkretisht propozohet ndertimi i pikave ne territoret

- 62.1 Pllajën e Kurveleshit – zonen midis fshatrave Progonat dhe Gusmar. Ne kete pike do te depozitohen mbetjet e fshatrave te Njesise Administrative Kurvelesh;
- 62.2 Pergjate korridorit midis fshatrave Dragot dhe Luadh – propozohet prane rruges kryesore, prane fshatit Luadh. Pika do te sherbeje per depozitim e mbetjeve te fshatrave Mezhgoran, Luadh, Peshtan, Beçisht dhe Dragot.
- 62.3 Prane ures se Leklit – ne kete pike do te depozitohen mbeturinat e fshatrave Koder, Lekël, Hormove dhe Luzat.
- 62.4 Përgjatë korridorit midis Dukaj dhe Salarise – propozohet pranë rrugës se vjetër Tepelenë – Lopës dhe do të depozitohen mbeturinat e fshatrave Salari, Dukaj si dhe territoreve te banuara midis fshatit Dukaj dhe lagjes Kordhë.
- 62.5 Ne gryken e Lopësit – propozohet midis fshatrave Dhemblan dhe Matohasanaj dhe do të shërbejë per depozitim e mbetjeve te fshatrave Dhemblan, Matohasanaj, Lap-Martalloz dhe Sinanaj.

1.6.2.8. Objektiv 3.5 – Ristrukturim i rrjetit të shërbimeve publike ne te gjithe territorin e Bashkise, në koherencë me propozimet strategjike

Ne kontekstin e vleresimit strategjik lidhur me riorientimin e zhvillimit demografik social dhe infrastrukturor të Bashkise Tepelenë, synohet rishpërndarja e strukturave arsimore dhe shendetesore ne qendren e Bashkise dhe në zonat rurale. Rishpërndarja bazohet në skemën ekzistuese të strukturave, duke propozuar ri-grupimin e tyre në funksion të rritjes së eficiëncës së punës dhe shërbimit ndaj komunitetit.

Qyteti Tepelene si dhe ish-komunat, tashme pjese administrative te Bashkise, te perfshira ne te ne saj te Reformes se re Administrative Territoriale, kanë trashëguar një infrastrukturë shkolllore te plete, per sa i perket numrit te shkollave, shtrirjes se tyre si dhe hapësirave mesimore. Nderkohe, renia e konsiderueshme e numrit te nxenesve per shkak te migrimit të banoreve te fshatrave ka rezultuar ne shume raste ne shkolla thuajse te boshatisura, me shume pak nxenës dhe mesues.



Ne kete konstekst propozohet rigrupimi i shkollave funksionale, nepermjet orientimit te nxenesve drejt shkollave te perqendruara, duke rritur ne kete menyre numrin e nxenesve neper klasa, eficiencen e mesimdheneve si dhe uljen e kostove administrative. Me pak shkolla nenkupton me pak mesues te nevojshem, me pak kosto administrative si dhe mirembajtje.



Fig. 51 - Pamje e shkollës 9-vjeçare "Selam Musa" ne fshatin Sinanaj në Njësinë Administrative Lopës.

Program 3.5.1

Konsolidimi i rrjetit te shkollave sipas një skeme me te përbledhur të shpërndarjes hapësinore.

Projekti 63 – 3.5.1.63 Konsolidimi i shkollës "Selam Musa" ne fshatin Sinanaj si shkolla e vetme 9-vjeçare ne Lopës, duke akomoduar edhe nxenesit e shkollave "Halim Ramo" ne Dhemblan si dhe "Sali Beqiri" ne Matohasanaj.

Projekti 64 – 3.5.1.64 Konsolidimi i shkolles 9-vjeçare "Memo Nexhipi" në fshatin Dukaj si strukture qendrore, duke akomoduar nxenesit e shkolles "Kordhaj" ne lagjen Kordhaj prane Vjosës, shkolles "Ferit Çela" në fshatin Turan dhe shkollen "Mustafa Zoto" ne fshatin Salari.

Projekti 65 – 3.5.1.65 Konsolidimi i shkolles 9-vjeçare "Asim Zeneli" në fshatin Progonat, duke akomoduar edhe nxenesit e shkollës "Çobo Mërkuri" ne fshatin Gusmar, shkolles "Shuko Dalipi" ne fshatin Nivice si dhe shkolles "Sinan Kërpi" ne Lekdush

Projekt 66 – 3.5.1.66 Konsolidimi I shkolles 9-vjeçare "Polo Bezhani" ne Lekel duke akomoduar nxenesit e shkollave "Misto Shumeli" ne Koder dhe "Nevro Selimi" ne Hormove

Projekti 67 – 3.5.1.67 Konsolidimi i shkolles 9-vjeçare "Jaçe Banushi" ne Dragot duke akomoduar nxenesit e shkollave "Llukan Ceka" ne Peshtan, "Xhaferri Bani" ne Mezgoran dhe "Anashor Halimi" ne Beçisht.

Ndërkohe shkollat "Fato Kuçi" ne Bënçë, "Brahim Mama" ne Mamaj dhe "Seit Demiri" ne Luzat mund te akomodohen ne shkollat "7 Marsi" dhe "Avni Rustemi" ne qytetin e Tepelenes.

Program 3.5.2

Permiresimi i rrjetit te infrastruktures shendetesore

Projekti 68 – 3.5.2.68 Rikonstruksioni I pote i Q.SH. Lopës, në fshatin Sinanaj – kjo qender mbulon nevojat per fshatrat e Lopësit

Projekti 69 – 3.5.2.69 Ndertimi i nje qendre tё re shendetesore ne fshatin Dragot – per te siguruar shërbimin per popullsine e fshatrave Dragot, Beçisht, Luadh, Mezgoran, Peshtan, Koder dhe Lekel

Projekti 70– 3.5.2.70 Ndertimi i nje qendre tё re shendetesore ne Dukaj – praktikisht ndertesa e qendres është terësisht jashtë funksionit. Kjo qendër mund te sherbeje per fshatrat Dukaj, Kordhaj (Dukaj), Turan dhe Salari.



Fig. 52 -Panje e ish qendres shendetesore ne fshatin Dukaj – Njesia Qender

Propozimet strategjike marrin parasysh faktin që Q.SH. Tepelenë, Q.SH. Qendër si dhe Q.SH. Kurvelesh janë rikonstruktuar së fundmi me investim te qeverise shqiptare.




Fig. 53 -Harta e Projekteve Strategjike te Zhvillimit te Bashkise Tepelene




1.7. Konvertimi i Sistemeve Territoriale


Projektet e propozuara ne kuader te Strategjise Territoriale te Bashkise Tepelene kane ndikim ne ndryshimin e klasifikimit te nje pjese te vogel te territoreve te kesaj Njësie Vendore, sipas organizimit ne Sisteme Territoriale, te percaktuara sipas Ligjit Nr. 104/2014 "Per Planifikimin e Territorit", te ndryshuar.

Ketu duhet permendur fakti qe vetem 11 projekte, nga totali i projekteve strategjike te propozuara per Bashkine Tepelene, kane ndikim ne konvertimin e territoreve ne sisteme te ndryshme. Nderkohe pjesa tjeter e tyre jane projekte te cilat adresojne permiresime te parametrave teknike te objekteve ekzistuese apo te territoreve te ndryshme, brenda sistemit te tyre ekzistues.

Sistemet	Sipërfaqja ekzistuese (ha)	Përqindja (%)	Sipërfaqja e propozuar (ha)	Përqindja (%)	Ndryshimet në përqindje të Sistemeve
(B) Bujqesor	2051.76	4.59	2734.13	6.11	1.52
(IN) Infrastrukturor	258.57	0.58	112.62	0.25	-0.33
(N) Natyror	40623.45	90.81	39929.96	89.26	-1.55
(U) Ujor	1002.61	2.24	1254.45	2.8	0.56
(UB) Urban	795.56	1.78	700.79	1.58	-0.2
Total	44731.95	100	44731.95	100	0

Figure 54 Tabela e konvitimeve te Sistemeve Territoriale per efekt te zbatimit te projekteve Strategjike ne Bashkine Tepelene





Nevojat per nderhyrje strategjike ne territorin e Bashkise Tepelene, te cilat kane ndikuar ne ndryshim te klasifikimit te sistemeve te parcelave, jane gjykuar si te domosdoshme dhe esenciale ne aspektin e rigjenerimit te jetes social-ekonomike te kesaj Njesie Vendore. Referuar analizes territoriale, dhe konkretisht marredhenies midis siperfaqes se konsiderueshme hapesinore te Bashkise Tepelene me gjurmen se vogel urbane qe ka kjo Njesi si dhe domosdoshmerise se rivitalizimit te kontekstit aktual social ekonomik, eshte arritur ne perfundimin qe propozimet strategjike nuk duhet te gjejne kufizim ne aspektin e shtrirjes hapesinore apo nevojes per transformimin e territoreve sipas klasifikimit te sistemeve.

Riorganizimi i propozuar i struktura urbane te Bashkise Tepelene, dhe konkretisht per hapesira te reja banimi, nuk ka impakt domethenes ne transformimin e klasifikimit te sistemeve territoriale. Kjo vjen kryesisht per shkak te numrit mjaft te ulet te popullsise si dhe largimi gradual i popullsise ekzistuese, si pasoje e migracionit. Per kete arsy, struktura ekzistuese urbane karakterizohet nga hapesira te lira si dhe nje dendesi e ulet, duke mos e bere te nevojshme transformimin e territoreve natyrore apo bujqesore ne territor te reja



banimi. Një kategori e veçantë e banimit në territori është kategoria Bujqësi-Banim (BA) e cila ndonëse nuk ka nevojë për konvertim, ka domosdoshmëri për shërbime dhe struktura ndihmëse. Në vendbanimet kryesore është domosdoshmëri plotësimi i zonave me shërbimeve tregtare, aktivitete dhe shërbime sociale.

Ne kontestin ekzistues, pjesa me e madhe e rritjes se territoreve te Sistemit Urban ne Bashkine Tepelene vjen si pasoje e transformimit te zones veriore te qytetit, e cila kthehet ne një zone me prioritet zhvillimi urban, ekonomik dhe social per te gjithe territorin e Bashkise. Kjo hapesire eshte konceptuar te transformohet ne zonen kryesore te rritjes urbane dhe ekonomike të Bashkise Tepelene. Perveç zonave te reja urbane, ne kete hapesire, dokumenti I Strategjise Territoriale propozon:

- Ndërtimin dhe vënien ne shfrytezim te strukturave te magazinimit dhe përpunimit të produkteve blegtorale;
- Ndërtimin e zones së magazinimit dhe përpunimit të bimëve medicinale;
- Ndërtimin e thertores se re të Tepelenës;
- Ndertimi I stacionit multimodal te transportit per qytetin e Tepelenes: Propozohet të ndertohet në pjesën veriore te qytetit, duke akomoduar hapesirat e nevojshme edhe për ndërtimin ne perspektive te stacionin e trenit.
- Ndertimi I impiantit qendror te depurimit te ujerave te zeza te qytetit te Tepelenes. Ky projekt transfomon një pjese te territoreve bujesore ne sistemin e klasifikimit te infrastrukturove.

E gjithe kjo, do te paraprihet nga hartimi i Planeve te Detajuara Vendore, duke nderthurur ne kete menyre strukturimin e hapesirave urbane me rrjetet e infrastrukturave dhe te sherbimeve.

Nderkohe, nderhyrje te tjera qe kane ndikim ne transformimin e territoreve sipas klasifikimit te Sistemeve Territoriale jane:

- Zhvillimi i tre fermave blegorale pilot midis fshatrave Progonat dhe Nivicë (Kurvelesh), Dhëmlan dhe Sinanaj (Lopës), Dukaj – Turan (Qender); Projekti ka per qellim qe te mundesoje krijimin e strukturave te specializuara per mbare-shtimin e bagëtive ne keto territore, duke u bazuar ne traditen ekzistuese blegtorale te zonave. Ky propozim perben një nga elementet e forte te propozimeve lidhur me zhvillimin ekonomik te Bashkise Tepelene, me ndikim si ne sektorin e blegtorise ashtu edhe në agroturizem. Projekti ndikon ne transformimin e disa hapesirave natyrore ne territor te klasifikuara ne sistemin bujqësor.
- Ndertimi i urave te reja te Dragotit, Leklit, Dorezit si dhe ures qe lidh fshatrat Sinanaj dhe Dorez. Keto projekte kane ndikim ne transformimin e territoreve te klasifikuara ne Sistemin Natyror dhe Bujqesor ne territor qe perfshihen ne Sistemin territorial te Infrastrukturove.
- Ndertimi I impianteve septike te trajtimit teknologjik te ujerave te zeza per fshatrat e Kurveleshit, fshatin Dragot dhe fshatin Bençë. Permes ketyre propozimeve kemi transformim te territoreve natyrore dhe bujqesore ne territor te klasifikuara ne Sistemin territorial te Infrastrukturove.
- Ndertimi i pese pikave tranzit te depozitimit te mbetjeve ne pllajen e Kurveleshit, dhe konkretisht midis fshatrave Progonat dhe Gusmar, midis fshatrave Dragot dhe Luadh, midis fshatrave Dukaj dhe Salari, prane ures se Leklit si dhe ne pllajen e Lopesit. Keto propozime nenkuptojojnë transformimin e territoreve natyrore ne territoreve te klasifikuara ne Sistemin territorial te Infrastrukturove.

1.8. Skedat e Projekteve Pilot

SKEDA E PROJEKTIT - 2	
Lloji i Projektit	PILOT
Emri i Projektit	1.1.1.2 Hartimi i Projekteve të Detajuara Vendore per zonën veriore të Tepelenës
Objektivi Strategjik	Objektivi 1.1 Riorganizimi i territoreve urbane të Bashkise ne funksion te rritjes graduale se qendres
Vendndodhja	Zona fushore ne pjesen veriore te qytetit te Tepelenes, e cila kulmon me grykederdhjen e lumit te Bënçës, ne te dy anet e rruges interurbane Levan – Tepelenë – Gjirokastër
Harta	
Sektori	01_Shërbime të Përgjithshme Publike
Programi	013_Shërbime të Pergjithshme Publike
Faza	Afatshkurtër (1 vit)
Kohezgjatja	1 vit.
Qellimi kryesor dhe Rendesia	<p>Krijimi dhe miratimi i instrumenteve te nevojshem planifikues per zhvillimin e hapesirave fushore ne veri te qytetit te Tepelenes, ne te cilin identifikohen ndarjet e reja hapësinore, perdomitet e tokes, treguesit urbanistike si dhe shperndarja e rrjeteve te reja te infrastrukturies plotesuese. Keto PDV do te miratohen ne nivel vendor, duke respektuar kufijtë dhe treguesit urbane te percaktuar per Njesite Strukturore te PPV si dhe ne Rregulloren e Planit.</p> <p>Nëpermjet ketyre Planeve te reja, Bashkia Tepelenë do te kete mundesi te orientoje dhe te mbikqyre proceset e hartimit dhe te zbatimit te projekteve teknike qe kane te bejne me hapjen e hapesirave te reja rrugore si dhe me instalimin e te gjitha rrjeteve te infrastrukturave si furnizimi me uje, kanalizimet si dhe furnizimi me energji elektrike. Po ashtu, PDV'te e detajuara do të percaktojnë shpërndarjen e hapësirave publike ne zonen ne fjale, duke respektuar treguesit</p>

	për hapesire të gjelber, kalime kembesoresh dhe hapesira parkimi.
	Po ashtu, zbatimi i ketij projekti do te orientoje te gjithe subjektet private te interesuara per llojin e zhvillimeve te mundshme ne zone, treguesit urbanistike te lejuar si dhe kufizimet. Me miratimin e ketyre Planeve, subjektet do te kene mundesi qe te aplikojne per lejet perkatese te zhvillimit dhe të ndertimit.
Përgjegjës	Bashkia Tepelene
Kosto e perafert	3,000,000 leke
Burimet e mundshme te financimit	Bashkia Tepelene Dhe/Ose Investitorë Privatë të interesuar
Veprimet e nevojshme per zbatimin e projektit	Projekti do te ndjeke fazat perkatese te hartimit te PDV've percaktuar ne Rregulloren e Planit te Pergjithshem Vendor te Bashkise Tepelene, dhe konkretisht: <ul style="list-style-type: none"> - Hartimi dhe miratimi i Nismës – nisma miratohet në Keshillin Bashkiak te Tepelenes, pas kerkese syrtare te Kryetarit te Bashkise - Hartimi dhe miratimi i relacioneve perkates te PDV've - Hartimi dhe miratimi i rregulloreve te PDV've - Hartimi dhe miratimi i materialeve hartografike - Prezantimi, diskutimi dhe konsultimi i Planeve me publikun dhe aktoret e interesuar per zonen - Miratimi perfundimtar I PDV've ne Keshillin Bashkiak te Tepelenes.
Tregues i Monitorimit	Finalizimi dhe miratimi i PDV ne zonen e percaktuar ne veri te qytetit te Tepelenes

SKEDA E PROJEKTIT - 3	
Lloji i Projektit	PILOT
Emri i Projektit	1.1.1.3 Ndertimi dhe konsolidimi i rrjeteve të infrastruktures fizike (rruge, ujeselles-kanalizime si dhe furnizim me energji) ne zonën veriore të qytetit te Tepelenes
Objktivi Strategjik	Objktivi 1.1 Riorganizimi i territoreve urbane të Bashkise ne funksion te rritjes graduale se qendres
Vendndodhja	Zona fushore ne pjesen veriore te qytetit te Tepelenes, e cila kulmon me grykederdhjen e lumit te Bënçës, ne te dy anet e rruges interurbane Levan – Tepelene – Gjirokaster



Harta	
Sektori	01_Sherbime te Pergjithshme Publike
Programi	045_Transporti 063_Furnizimi me uje
Faza	Afatmesem (1 -3 vjet)
Kohezgjatja	2 vjet
Qellimi kryesor dhe rendesia	<p>Permiresimi i parametrave teknike dhe urbane te zones se propozuar ne very te qytetit, me qellim promovimin e projekteve te investimeve nga ana e subjekteve te ndryshme private, individive apo aktoreve te tjere te interesuar.</p> <p>Orientimi i investorëve potenciale drejt zones veriore të qytetit te Tepelenës, si një zone me infrastrukturre te kompletuar dhe me standarde bashkekohore</p> <p>Nepermjet ketij projekti do te mundesohet krijimi i hapesirave te reja te komunikimit, hapesirave publike, parkimit si dhe te gjitha lehtesirave te tjera ne zonen ne propozim. Nje investim i tillë pritet te stimuloje investitoret private, banore te qytetit te Tepelenës apo te zonave periferike qe te ndermarrin projekte zhvillimi, sipas llojit te perdorimeve te tokes te specifikuara ne Planin e Pergjithshem Vendor.</p> <p>Në këtë mënyrë, zona do te kthehet ne një pol te rendesishem urban, ekonomik dhe infrastrukturor per qytetin por edhe per te gjithe Bashkinë Tepelene</p>
Përgjegjës	Bashkia Tepelene
Kosto e perafert	150,000,000 leke
Burimet e mundshme te financimit	Bashkia Tepelene, Ministria e Infrastruktures dhe Energjisë, Fondi Shqiptar i Zhvillimit
Veprimet e nevojshme per zbatimin e projektit	<p>Ne baze te percaktiveve teknike, kritereve urbanistike si dhe parametrave te infrastruktureve, te identifikuar ne PDV'te perkatese te miratuara nga Keshilli Bashkiak Tepelene, do te ndiqen veprimet si ne vazhdim:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Hartimi dhe miratimi i Detyrave te Projektimit per ndertimin e - Rrjetit rrugor te zones se percaktuara, sipas kritereve te percaktuara ne Rregulloren e Planit te Pergjithshem Vendor



	<ul style="list-style-type: none"> - Rrjetit te furnizimit me uje - Rrjetit te kanalizimeve te ujerave te zeza dhe te bardha - Rrjetit te furnizimit me energji elektrike - Hartimi i projekteve teknike të rrjeteve të sipërpermendura - Tenderimi nga ana e Bashkise Tepelene i projekteve publike per ndertimin e rrjeteve te siperpermendura - Koalidimi dhe marrja ne zbatim i rrjeteve te reja infrastrukturore te ndertuara
Tregues i Monitorimit	Finalizimi i projekteve te ndertimit te rrjeteve, dhe marrja ne dorezim nga ana e Bashkise Tepelene

SKEDA E PROJEKTIT - 8	
Lloji i Projektit	PILOT
Emri i Projektit	2.1.1.8 Projektimi, ndërtimi dhe venia ne shfrytezim i strukturave te magazinimit dhe përpunimit të produkteve blegtorale
Objektivi Strategjik	Objektivi 2.1 – Zhvillimi i ekonomisë urbane qytetëse, e orientuar drejt industrisë së lehtë dhe perpunuase
Vendndodhja	Zona fushore në pjesën veriore të qytetit të Tepelenës, e cila kulmon me grykederdhjen e lumit te Bënçës, ne te dy anet e rruges interurbane Levan – Tepelene – Gjirokaster
Harta	
Sektori	04_Çeshtjet Ekonomike
Programi	041_Çështjet e Përgjithshme Ekonomike, Tregtare dhe te Punës
Faza	Afatmesem (1 -3 vjet)
Kohezgjatja	2 vjet
Qellimi kryesor dhe rendesia	<p>Konsolidimi i infrastruktures magazinuese dhe perpunuase te produkteve blegtorale me origjine territoret rurale te Tepelenes, duke synuar krijimin e markave autentike te produkteve bio te zonës. Nje iniciative e tille perkon me objektivin per zhvillimin dhe mbeshtetjen e turizmit natyror apo agroturizmit ne territoret periferike te Bashkisë.</p> <p>Nje projekt i tille synon ne gjallerimin e jetes ekonomike dhe permiresimin e nivelit te punesimit ne kete Njesi Vendore. Ekzistenza e nje infrastrukturre te konsoliduar,</p>

	e cila eshte e afte te grumbulloje dhe te perpunoje produktin blegtoral te Tepelenes, do te sherbeje si një stimul I konsiderueshem per popullsine rurale per zhvillimin e blegtorisë. Nga ana tjeter, ky interes potencial do te sherbeje si motivim per popullsine rurale qe te mos braktise vendbanimet periferike, një problem ky mjaft evident per Bashkine Tepelene.
Përgjegjës	Bashkia Tepelene do te jetë përgjegjëse për të monitoruar procesin e ndertimit dhe venies ne shfrytezim te struktura se re ekonomike te propozuar.
Kosto e perafert	100,000,000 leke
Burimet e mundshme te financimit	Bashkia Tepelene – mund te angazhohet si bashkepunetore dhe bashkefinancuese ne kete projekt, nepermjet mbeshtetjes se qeverise qendrore. Ne kete menyre, projekti do te sherbeje edhe per gjenerimin e te ardhurave financiare per institucionin e Bashkise, te nevojshme per kostot administrative, funksionimin e sherbimeve vendore dhe mirembajtjen e infrastrukturave Investitorë private te interesuar per projektin ekonomik
Veprimet e nevojshme per zbatimin e projektit	Projekti do te ndjeke te gjitha hapat ligjore teknike te parashikuar ne Ligjin Nr.107/2014 "Per Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", i ndryshuar, VKM Nr. 686 date 22.11.2017 "Per miratimin e Rregullores se Planifikimit te Territorit", e ndryshuar si dhe VKM Nr.408 "Per Miratimin e Rregullores se Zhvillimit te Territorit" e ndryshuar, dhe konkretisht per hapat ligjore dhe teknike qe duhet te ndiqen per miratimin e lejes se zhvillimit, miratimin e lejes se ndertimit si dhe marrjes se çertifikates finale te perdonimit te objektit
Tregues i Monitorimit	Struktura e re e propozuar ekonomike te jetë e ndertuar dhe e vene ne shfrytezim

SKEDA E PROJEKTIT -10	
Lloji i Projektit	PILOT
Emri i Projektit	2.1.1.10 Ndërtimi i thertores se re të Tepelenës
Objektivi Strategjik	Objktivi 2.1 – Zhvillimi i ekonomisë urbane qytetëse, e orientuar drejt industrisë së lehtë dhe perpnuuese
Vendndodhja	Prane urës së Bënçës, në krah të rrugës Tepelenë - Veliqot



Harta	
Sektori	04_Çeshtjet Ekonomike
Programi	041_Çeshtjet e Përgjithshme Ekonomike, Tregetare dhe te Punës
Faza	Afatmesem (1 -3 vjet)
Kohezgjatja	2 vjet
Qellimi kryesor dhe rendesia	<p>Finalizimi i zinxhirit te ekonomise blegtorale ne Bashkine Tepelene, duke mundesuar keshtu nje funksionim te standartuar dhe te kontrolluar te industrise se mishit, si nje produkt kryesor i territoreve te kesaj njesie vendore. Pra, Tepelena si vend i origjines e mishit dhe produkteve cilesore</p> <p>Ashtu si edhe projekt per ndertimin e strukturave per grumbullimin dhe perpunimin e produkteve blegtorale, edhe ky projekt synon ne gjallerimin e jetes ekonomike dhe permiresimin e nivelit te punesimit ne Bashkine Tepelene. Ndertimi I kesaj strukture do te lethesoje blegtoret e zones, duke ofruar nje hapesire thertore te dedikuar per bagetine, brenda standarteve dhe kriterieve ligjore per higijenën dhe mjedisin.</p> <p>Gjithashtu, zbatimi I nje projekti te tille eshte ne favor te konsumatorit te mishit ne Tepelene por edhe me gjere ne nivel rajonal apo kombatar, duke garantuar produkt te kontrolluar dhe te sigurt per konsum.</p> <p>Ne perfundim, konsolidimi i proceseve te prodhimit te mishit te garantuar per konsum, do te mbeshtese potencialisht edhe zhvillimin e aktiviteve te tjera sekondare qe lidhen me perpunimin e mishit, sallameve, proshutes, etj. Po ashtu, projekt do te rrise nivelin e punesimit per banoret e zones se Tepelenes, si dhe do te gjeneroje te ardhura per Bashkine.</p>
Përgjegjës	Bashkia Tepelene do te jete përgjegjëse per te monitoruar procesin e ndertimit dhe venies ne shfrytezim te struktura se re ekonomike te propozuar.
Kosto e perafert	100,000,000 leke
Burimet e mundshme te	Investitorë private te interesuar per projektin ekonomik

financimit	Bashkia Tepelene – mund te angazhohet si bashkepunetore dhe bashkefinancuese ne kete projekt, nepermjet mbeshtetjes se qeverise qendrore. Ne kete menyre, projekti do te sherbeje edhe per gjenerimin e te ardhurave financiare per institucionin e Bashkise, te nevojshme per kostot administrative, funksionimin e sherbimeve vendore dhe mirembajtjen e infrastrukturave
Veprimet e nevojshme per zbatimin e projektit	Projekti do te ndjeke te gjitha hapat ligjore teknike te parashikuar ne Ligji Nr.107/2014 "Per Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", i ndryshuar, VKM Nr. 686 date 22.11.2017 "Per miratimin e Rregullores se Planifikimit te Territorit", e ndryshuar si dhe VKM Nr.408 "Per Miratimin e Rregullores se Zhvillimit te Territorit" e ndryshuar, dhe konkretisht per hapat ligjore dhe teknike qe duhet te ndiqen per miratimin e lejes se zhvillimit, miratimin e lejes se ndertimit si dhe marrjes se certifikates finale te perdonimit te objektit
Tregues i Monitorimit	Struktura e re e propozuar ekonomike te jete e ndertuar dhe e vene ne shfrytezim

SKEDA E PROJEKTIT -12	
Lloji i Projektit	PILOT
Emri i Projektit	2.2.1.12 Zhvillimi i tre fermave blegorale pilot ne territoret midis fshatrave Progonat dhe Nivicë (Kurvelesh), Dhëmblan dhe Sinanaj (Lopës), Dukaj – Turan (Qender)
Objktivi Strategjik	Objktivi 2.2 - Zhvillimi i ekonomive bujqësore dhe blegtorale në zonat rurale të Bashkisë
Vendndodhja	Territoriet rurale kullosore <ul style="list-style-type: none"> - midis fshatrave Progonat, Gusmar dhe Nivicë - midis fshatrave Dhëmblan dhe Sinanaj - territoret kodrinore midis fshatrave Dukaj dhe Turan.
Harta	



		
		
Sektori	04_Çeshtjet Ekonomike	
Programi	041_Çështjet e Përgjithshme Ekonomike, Tregtare dhe të Punës	
Faza	Afatmesem (1 -3 vjet)	
Kohezgatja	2 vjet	
Qellimi kryesor dhe rendesia	<p>Krijimi i modeleve te suksesshme, te kontrolluara dhe me rentabilitet ekonomik te mbareshtimit te bagetive ne territorin e Bashkise Tepelene. Ky model i propozuar per tu zhvilluar ne zonat e permendura, do te mund te replikohet potencialisht edhe ne territoret e tjera, nepermjet shfrytezimit te qendrueshem te potencialeve natyrore qe disponon kjo Njesi Vendore.</p> <p>Ne kuader te tradites blegtorale te zonave rurale te Bashkise Tepelene si dhe hapesirave te gjera kullosora, projekt ka per qellim krijimin e strukturave te mbareshtimit te blegtorise, ne funksion te rritjes se prodhimit te per gjithshem. Keto struktura do te kombinojne kullotjen ne natyre si dhe akomodimin e bagetise ne stalla te miremenaxhuara. Nje cikel i tillë eshte provuar te jetë me rentabilitet afatgjate, per shkak te krijimit te kushteve te pershtatshme per bagetine edhe ne stinen e dimrit, duke garantuar keshtu rritjen e numrit te bagetise, ofrimin e shërbimeve cilësore veterinar si dhe permiresimin e cilesise se produktive te prodhua.</p> <p>Projekti I propozuar lidhet ne menyre racionale me projektet strategjike te propozuara per ndertimin e strukturave te perpunimit te produktive blegtorale si dhe te thertores se re te Tepelenes. Pra, nepermjet ketij projekti mundeshet potencialisht rritja e numrit te krereve te bagetise dhe si rrjedhim, rritja e produktive blegtorale per perpunim dhe tregetim.</p> <p>Projekti gjithashtu ndihmon ne ruajtjen dhe mire-menaxhimin e territoreve te kullotave dhe te pyjeve te zonave te propozuar, duke stimuluar rritjen e prodhimit te lendet se pare foragjere nga ana e fermereve te zonave, si dhe duke eliminuar kulloten e pakontrolluar edhe ne territoret te cilat janë destinuar te ripyllezohen. Konkrektisht, tradita aktuale e kullotës, shpeshhere e pakontrolluar, ka efekte negative ne territoret natyrore pasi pengon riperteritjen natyrale te</p>	

	<p>vegjetacionit, dhe sidomos te pyjeve. Dhe pikerisht keto te fundit identifikohen si potencial i rendesishem per zhvillimin e ardhshem te turizmit natyror dhe te aventures ne Bashkine Tepelene.</p> <p>Ne perfundim, projekti I propozuar ka rendesi te konsiderueshme ne krijimin e vendeve te punes per banoret e zonave, duke pasur keshtu nje efekt frenues kunder migrimit te popullsise rurale</p>
Përgjegjës	<p>Investitorë private te interesura</p> <p><i>Shënim:</i> Bashkia Tepelene do te jete përgjegjese per te monitoruar procesin e ndertimit dhe venies ne shfrytezim te strukturave te reja blegtore</p>
Kosto e perafert	40,000,000 leke
Burimet e mundshme te financimit	<p>Investitorë private te interesuar per projektin ekonomik</p> <p>Ashtu si edhe ne projektet e tjera te perfshira ne Sektorin e Çeshtjeve ekonomike, Bashkia Tepelene mund te angazhohet si bashkepunetore dhe bashkefinancuese ne kete projekt, I cili do te mund te gjeneroje te ardhura financiare, te nevojshme per kostot administrative, funksionimin e sherbimeve vendore dhe mirembajtjen e infrastrukturave</p>
Veprimet e nevojshme per zbatimin e projektit	Projekti do te ndjeke te gjitha hapat ligjore teknike te parashikuar ne Ligjin Nr.107/2014 "Per Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", i ndryshuar, VKM Nr. 686 date 22.11.2017 "Per miratimin e Rregullores se Planifikimit te Territorit", e ndryshuar, dhe konkretisht per hapat ligjore dhe teknike qe duhet te ndiqen per miratimin e lejes se zhvillimit, miratimin e lejes se ndertimit si dhe marrjes se çertifikates finale te perdonimit te objekteve te reja te propozuara
Tregues i Monitorimit	Strukturat e reja te propozuara ekonomike te jene te ndertuara dhe te vena ne shfrytezim

SKEDA E PROJEKTIT - 15	
Lloji i Projektit	PILOT
Emri i Projektit	2.2.1.15 Nderimi dhe venia ne shfrytezim e vaskave te kultivimit te peshkut te ujerave te embla (troftes) pergjate brezit te lumbrit Drinos
Objektivi Strategjik	Objektivi 2.2 - Zhvillimi i ekonomive bujqësore dhe blegtoreale në zonat rurale të Bashkisë
Vendndodhja	Brezi i territoreve pergjate korridorit te lumbrit Drinos, brenda hapesires administrative te Bashkise Tepelene, te cilat perkojne edhe me derdhjen e burimeve te Ujit te Ftohte



Harta	
Sektori	04_Çështjet Ekonomike
Programi	041_Çështjet e Përgjithshme Ekonomike, Tregëtare dhe të Punës
Faza	Afatmesem (1 -3 vjet)
Kohezgjatja	3 vjet
Qëllimi kryesor dhe rëndësia	<p>Zhvillimi I strukturave te mbareshtimit artificial te troftes ne territorin e Tepelenes, duke krijuar keshtu një produkt te ri dhe cilesor, te afte per tu tregetuar ne tregun e brendshem dhe rajonal.</p> <p>Transformimin gradual te ketyre strukturave ne pikë interesante te itinerareve turistike ne Tepelene, me mundësi potenciale per zhvillimin edhe te strukturave te reja te sherbimit restoran ne perspektive</p> <p>Gjithashtu, projekti i propozuar ka rendesi te konsiderueshme ne krijimin e vendeve te punes per banoret e fshatrave te Leklit, Hormoves apo Luzatit, duke pasur keshtu një efekt frenues kunder migrimit te popullsise rurale.</p>
Përgjegjës	<p>Investitorë private te interesura</p> <p><i>Shënim:</i> Bashkia Tepelene do te jete përgjegjese per te monitoruar procesin e ndertimit dhe venies ne shfrytezim te strukturave te reja blegtoreale</p>
Kosto e perafert	25,000,000 leke
Burimet e mundshme te financimit	<p>Investitorë private te interesuar per projektin ekonomik</p> <p>Ashtu si edhe ne projektet e tjera te perfshira ne Sektorin e Çeshtjeve ekonomike, Bashkia Tepelene mund te angazhohet si bashkepunetore dhe bashkefinancuese ne kete projekt, I cili do te mund te gjeneroje te ardhura financiare, te nevojshme per kostot administrative, funksionimin e sherbimeve vendore dhe mirembajtjen e infrastrukturave</p>
Veprimet e nevojshme per zbatimin e projektit	Projekti do te ndjeke te gjitha hapat ligjore teknike te parashikuar ne Ligji Nr.107/2014 "Per Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", i ndryshuar, VKM Nr. 686 date 22.11.2017 "Per miratimin e Rregullores se Planifikimit te Territorit", e ndryshuar si dhe VKM Nr.408 "Per Miratimin e Rregullores se Zhvillimit te

	Territorit" e ndryshuar, dhe konkretisht per hapat ligjore dhe teknike qe duhet te ndiqen per miratimin e lejes se zhvillimit, miratimin e lejes se ndertimit si dhe marrjes se çertifikates finale te perdonimit te objekteve te reja te propozuara
Tregues i Monitorimit	Strukturat e reja te propozuara ekonomike te jene te ndertuara dhe te vena ne shfrytezim

SKEDA E PROJEKTIT - 19	
Lloji i Projektit	PILOT
Emri i Projektit	2.3.1.19 Restaurimi dhe hartimi i planit te menaxhimit te kalase se Tepelenes
Objektivi Strategjik	Objktivi 2.3 - Zhvillimi i Sektoreve të Turizmit kulturor, natyror dhe aventurës
Vendndodhja	Territoret e brendshme te Kalase se Tepelenes, duke perfshire muret rrethuese si dhe shpatet poshte mureve
Harta	
Sektori	08_Argëtimi, Kultura dhe Feja
Programi	082_Shërbimet Kulturore
Faza	Afatshkurter (1 vit)
Kohezgjatja	1 vit
Qëllimi kryesor dhe rëndësia	Kalaja e Tepelenes perben elementin ngjizes historik te gjithe struktura urbane dhe sociale te territoreve te banuara ne kete Bashki. E favorizuar edhe nga pozicioni dominues ne qender te qytetit dhe prane rruges kryesore interurbane, ky monument historik evidentohet si elementi urban më me rendesi dhe me ndikim te padiskutueshem ne ecurine afatgjate te jetes ekonomike dhe sociale



	<p>te Tepelenës.</p> <p>Projekti synon te finalizoje instrumentin shkencor dhe teknik, i cili do te orientoje me pas te gjitha projektet e nderhyrjeve restauruese dhe rehabilituese ne kete strukture historike. E perballur me nje numer te madh te ndertimeve urbane në brendesi te saj ne dy dekadat e fundit, monumenti ka nevoje urgjente per nderhyrje te brendshme, ne funksion te evidentimit dhe nxjerjes ne pah te vlerave historike dhe kulturore.</p> <p>Plani I propozuar do të adresojë te gjitha problematikat e kalase duke ofruar zgjidhje mbi kontekstin e ri të krijuar me ligjin e trashëgimisë. Plani i ri i menaxhimit do të ofrojë udhëzime dhe politika, bazuar në praktikat më të mira për menaxhimin e integruar të vlerave kulturore dhe natyrore; të bëjë propozime për mundësitetë e zhvillimit ekonomik në kala dhe përreth tij (zona tampon) duke përfshirë aktivitetet e turizmit dhe kohës së lirë; të propozojë një strukturë menaxhimi për funksionimin e sitit dhe të rrisë kapacitetet e stafit perqejges per mirembajtjen.</p> <p>Plani i menaxhimit i propozuar si një nga rezultatet e ketij projekt synon te zhvilloje, perveç programeve nderhyrese restauratore, edhe një metodologji per gjenerimin e te ardhurave nga shfrytezimi I qendrueshem i monumentit si një destinacion historik.</p>
Përgjegjës	Ministria e Kultures
Kosto e perafert	10,000,000 leke
Burimet e mundshme te financimit	Qeveria shqiptare, Fondacione te ndryshme
Veprimet e nevojshme per zbatimin e projektit	Per zbatimin e projektit do te ndiqen te gjitha hapat ligjore te specifikuar ne Ligjin Nr. 27/2018. "Për Trashëgiminë Kulturore Dhe Muzetë"
Tregues i Monitorimit	Miratimi i Planit te Menaxhimit nga Keshilli Kombtar I Restaurimit

SKEDA E PROJEKTIT - 21	
Lloji i Projektit	PILOT
Emri i Projektit	2.3.1.21 Rikonstruksioni dhe rikualifikimi i plotë i muzeut të Tepelenës
Objktivi Strategjik	Objktivi 2.3 - Zhvillimi i Sektoreve të Turizmit kulturor, natyrore dhe aventurës
Vendndodhja	Prane hyrjes jugore te qytetit, prane sheshit "Ali Pashe Tepelena"

Harta	
Sektori	08_Argëtimi, Kultura dhe Feja
Programi	082_Shërbimet Kulturore
Faza	Afatshkurtër (1 vit)
Kohezgjatja	1 vit
Qëllimi kryesor dhe rëndësia	Projekti synon te rinoje gjithe parametrat teknike te struktura ekzistuese te muzeut, nepermjet perdorimit te teknologjisë dhe komponenteve bashkekohore. Synohet permiresimi fizik i hapesirave te brendshme te ekzpozitimit, hapesirave te sherbimit, permiresimi i regjimit termik nepermjet aplikimit te shtresave izoluese, meremetimi apo zevendesimi i detajeve te demtuara, etj.
	<p>Pamje ballore e hyrjes se muzeut etnografik te Tepelenës</p> <p>Ne aspektin funksional muzeal, projekti do te rivleresoje skemen e organizimit te ekspositoreve si dhe pozicionin e vendosjes se objekteve muzeale, duke marre parasysh krijimin e hapesirave per objekte te reja qe mund ti shtohen</p>



	<p>muzeut. Ne funksion te programit te ri te muzealizimit do te rikonceptohet edhe skema e ndriçimit te brendshem, një element thelbesor ne projektimin e strukturave muzeale.</p> <p>Nje tjeter element qe duhet trajtuar eshte krimi I infrastruktures se levizjes edhe per personat me aftesi te kufizuar, tashme nje kriter ligjor ne projektimin e objekteve publike.</p> <p>Perveç promovimit te kultures dhe trashegimise se zones se Tepelenes, projekt synon te rrise numrin e vizitoreve vendas apo te huaj, duke ndikuar ne rritjen e te ardhurave per Bashkine</p>
Përgjegjës	Bashkia Tepelene
Kosto e perafert	35,000,000 leke
Burimet e mundshme te financimit	Qeveria shqiptare, Bashkia Tepelene Fondacione te ndryshme
Veprimet e nevojshme per zbatimin e projektit	Per zbatimin e projektit do te ndiqen te gjitha hapat ligjore te specifikuar ne Ligjin Nr. 27/2018. "Për Trashëgiminë Kulturore Dhe Muzetë"
Tregues i Monitorimit	Finalizimi I projektit dhe venia ne shfrytezim I objektit te muzeut, teresisht te rikonstruktuar.

SKEDA E PROJEKTIT - 27	
Lloji i Projektit	PILOT
Emri i Projektit	2.3.2.27 Rikonstruksion dhe rikualifikim i qendrës së fshatit Progonat
Objektivi Strategjik	Objektivi 2.3 - Zhvillimi i Sektoreve të Turizmit kulturor, natyror dhe aventurës
Vendndodhja	Qëndra e fshatit Progonat, Njesia Administrative Kurvelesh
Harta	

Sektori	01_Sherbime te Pergjithshme Publike
Programi	013_Sherbime te pergjithshme publike
Faza	Afatshkurter (1 vit)
Kohezgjatja	1 vit
Qëllimi kryesor dhe rëndësia	<p>Projekti ka per qellim qe te permiresoje hapesirat publike qe perkojne me qendren e fshatit Progonat, nepermjet rikonceptimit te plote te elementeve perberes te hapesire, detajeve te dekorit urban, ndriçimit si dhe duke shtuar elemente argetues per grup mosha te ndryshme.</p> <p>I pozicionuar ne qender te Krahines se Kurveleshit, fshati Progonat ka nje rol kyç per sa i perket zbatimit me sukses te orientimit strategjik per konsolidimin e krahines si zone me perparesti turizmin malor dhe ate te aventure. Ne kete kontest, projekti I propozuar ka nje rendesi strategjike, pasi nepermjet tij synohet te permiresohet imazhi urban si dhe te stimulohen aktivitetet sociale dhe ekonomike te fshatit.</p> <p>Pra, koncepti eshte menduar te funksionoje ne zinxhir, ku me permiresimin e imazhit te qendres si dhe te parametrave funksionale urbane, përfshohet nje hapesire me e jetueshme, me sociale dhe me vlera turistike, duke rritur ne kete menyre interesin e banoreve per investime ne sherbime. Me perfundimin e rruges Bençe Nivice pritet nje rritje e flusit te vizitorave ne fshatrat e kesaj zone, keshtu qe qendra e Progonatit do te duhet te transformohet potencialisht ne nje stacion te rendesishem turistik, te pajisur me hapesirat e nevojshme si dhe sherbimet kryesore.</p> <p>Projekti propozohet te ndjeke metodologjine e perdorur edhe ne qendren e fshatit Nivice, teresisht te rikonstruktuar ne kuader te Programit "Akademja 100 Fshatrat".</p>
Përgjegjës	Bashkia Tepelene
Kosto e perafert	30,000,000 leke
Burimet e mundshme te financimit	Qeveria shqiptare, Bashkia Tepelene Fondacione te ndryshme
Veprimet e nevojshme per zbatimin e projektit	Projekti do te ndjeke te gjitha hapat ligjore teknike te parashikuar ne Ligji Nr.107/2014 "Per Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", i ndryshuar, VKM Nr. 686 date 22.11.2017 "Per miratimin e Rregullores se Planifikimit te Territorit", e ndryshuar si dhe VKM Nr.408 "Per Miratimin e Rregullores se Zhvillimit te Territorit" e ndryshuardhe konkretisht per hapat ligjore dhe teknike qe duhet te ndiqen per miratimin e lejes se zhvillimit, miratimin e lejes se ndertimit si dhe marrjes se çertifikates finale te perdonimit te sheshit.
Tregues i Monitorimit	Finalizimi i projektit te rikonstrukzionit te sheshit te fshatit

SKEDA E PROJEKTIT - 34	
Lloji i Projektit	PILOT
Emri i Projektit	2.3.3.34 Krijimi i itinerareve vertikale te Kurveleshit
Objektivi Strategjik	Objektivi 2.3 - Zhvillimi i Sektoreve të Turizmit kulturor, natyror dhe aventurës
Vendndodhja	Kanionet e Lekdushit, Progonatit dhe Nivices, Njësia Administrative Kurvelesh
Harta	
Sektori	08_Argetimi, Kultura dhe Feja
Programi	081_Sherbimet rekreative dhe Sportive
Faza	Afatmesem (1 -3 vjet)
Kohezgjatja	2 vjet
Qëllimi kryesor dhe rëndësiati	<p>Projekti ka per qellim identifikimin, projektimin dhe ndertimin e monopateve te mundshme per levizjen e kembesoreve qe duan te vizitojne kanionet e krahinës se Kurveleshit. Per shkak te reliefit teper te thyer, keto kanione jane te aksesueshme me shume veshtiresi, dhe shpeshhere me rrezikshmeri per levizjen e udhetareve, duke bere qe ky destinacion i rendesishem turistik i krahines te mos vizitohet rregullsiht nga ata pak vizitor qe udhetojne ne krahine.</p> <p>Kanionet perbejne elementi me potencial me te rendesishem turistik te Kurveleshit, dhe per kete arsy, projekti i propozuar ka nje rendesi shume te madhe per strategjine afatgjate te zhvillimit te turizmit natyror dhe ate aventures ne kete zone.</p> <p>Eshte thelbesore ne kete rast ruajtja ne maksimum te elementeve peisazhistike si dhe reduktimi i nderhyrjes fizike ne shpatet malore apo ne vegetacionin ekzistues.</p>
Përgjegjës	Bashkia Tepelene
Kosto e perafert	10,000,000 leke
Burimet e mundshme te financimit	Qeveria shqiptare; Bashkia Tepelene; Fondacione te ndryshme

Veprimet e nevojshme per zbatimin e projektit	Projekti do te ndjeke te gjitha hapat ligjore teknike te parashikuar ne Ligji Nr.107/2014 "Per Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", i ndryshuar, VKM Nr. 686 date 22.11.2017 "Per miratimin e Rregullores se Planifikimit te Territorit", e ndryshuar si dhe VKM Nr.408 "Per Miratimin e Rregullores se Zhvillimit te Territorit" e ndryshuar, dhe konkretisht per hapat ligjore dhe teknike qe duhet te ndiqen per miratimin e lejes se zhvillimit, miratimin e lejes se ndertimit si dhe marrjes se certifikates finale te perdonimit te akseve komunikuese.
Tregues i Monitorimit	Finalizimi i projektit te ndertimit te monopateve lidhese me kanionet.

SKEDA E PROJEKTIT - 38	
Lloji i Projektit	PILOT
Emri i Projektit	3.1.1.38 Zgjatimi ne veri i rruges Elmaz Teme Bilbili dhe bashkimi i saj me rrugën Tafil Buzi
Objektivi Strategjik	Objektiv 3.1 – Përmirësimi dhe rikualifikimi i rrjetit te komunikimit te Bashkisë Tepelenë
Vendndodhja	Qyteti i Tepelenes, berthama qendrore urbane e tiji
Harta	
Sektori	04_Çeshtjet Ekonomike
Programi	045_Transporti
Faza	Afatmesem (1 -3 vjet)
Kohezgjatja	1 vjet
Qëllimi kryesor dhe rëndësia	Projekti ka per qellim konsolidimin e një "unaze" te brendshme qe qarkon berthamen e banuar te qytetit te Tepelenes. Kjo unaze perbehet prej aksit te rruges "Batalioni Baba Abaz", rruges "Tafil Buzi", segmentit te rruges "Shullaz" qe shkon deri ne

	<p>spitalin si dhe rruges ne veri te qytetit "Elmaz Teme Bilbili".</p> <p>Nderhyrja do te konsistoje kryesisht ne zgjatimin e rruges "Elmaz Teme Bilbili", e cila do te vazhdoje siper, me drejtim perendimor, duke u bashkuar keshtu me rrugen "Shullaz" qe kalon para spitalit.</p> <p>Projekti mundeson nje qarkullim me te mire ne pjesen perendimore te qytetit te Tepelenes, duke permiresuar keshtu mundesite per strukturimin e hapesires urbane ne periferine veri-perendimor te qytetit, e cila paraqitet ne formen e nje ballkoni natyror me pamje nga fusha poshte qytetit si dhe nga perroi i Turanit.</p>
Përgjegjës	Bashkia Tepelene
Kosto e perafert	45,000,000 leke
Burimet e mundshme te financimit	Qeveria shqiptare; Bashkia Tepelene;
Veprimet e nevojshme per zbatimin e projektit	Projekti do te ndjeke te gjitha hapat ligjore teknike te parashikuar ne Ligji Nr.107/2014 "Per Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", i ndryshuar, VKM Nr. 686 date 22.11.2017 "Per miratimin e Rregullores se Planifikimit te Territorit", e ndryshuar si dhe VKM Nr.408 "Per Miratimin e Rregullores se Zhvillimit te Territorit" e ndryshuar dhe konkretisht per hapat ligjore dhe teknike qe duhet te ndiqen per miratimin e lejes se zhvillimit, miratimin e lejes se ndertimit si dhe marrjes se çertifikates finale te dorezimit dhe perdorimit te segmentit te shtuar rrugor te rruges "Elmaz Teme Bilbili"
Tregues i Monitorimit	Finalizimi i projektit te ndërtimit të segmentit rrugor te propozuar.



SKEDA E PROJEKTIT - 42	
Lloji i Projektit	PILOT
Emri i Projektit	3.1.2.42 Rikonstruksioni i rrugëve lidhëse të fshatrave të Golikut
Objektivi Strategjik	Objektiv 3.1 – Përmirësimi dhe rikualifikimi i rrjetit te komunikimit te Bashkisë Tepelenë
Vendndodhja	Segmentet ekzistuese rrugore lidhese te fshatrave Kodër, Lekël dhe Hormovë, të cilat komunikojnë me akset interurbane Tepelenë-Gjirokastër dhe Tepelenë Kelcyrë-Përmet



Harta	
Sektori	04_Çeshtjet Ekonomike
Programi	045_Transporti
Faza	Afatmesem (1 - 3 vjet)
Kohezgjatja	2 vjet
Qëllimi kryesor dhe rëndësia	<p>Projekti synon te rikonstruktoje akset ekzistuese rrugore te tre fshatrave te pozicionuar ne shpatin perendimor te malit te Golikut. Ne total propozohet ristrukturimi i 9.1 km segmente rrugore, te ndara si me poshte:</p> <ul style="list-style-type: none"> - segmenti lidhes i fshatit Koder - 1.3 km - segmenti lidhes i fshatit Lekël – 3.4 km - segmenti lidhes i fshatit Hormove – 4.4 km <p>Aktualisht keto segmente rrugore kane një gjeresi qe luhatet nga 3.5 deri ne 5 m e cila duhet te sistemohet ne gjithe gjatesine e tyre. Segementet e fshatrave Koder dhe Lekel jane te pasfaltuar, keshtu qe nevojitet ndertimi i pote i tyre sipas parametrave teknike te ndertimit te rrugeve. Duke iu referuar kategorizimit te rrugeve sipas Kodit Rrugor, do te te tre segementet rrugore kategorizohen si Rruga Interurbane Dytësore C3, me një karrexitë, me dy korsi me gjeresi 3 metra secila si dhe me bankina 0.75 metra ne te dy anet. Ne pikat te veçanta duhet te percaktohen vende per shkembim mjetesh.</p> <p>Projekti do t'ë hartohet në përpunhje me të gjitha normat dhe standartet për projektin që parashikon legjislacioni në fuqi per projektimin dhe ndertimin e rrugeve. Ky projekt ka një rendësi te konsiderueshme pasi synon te jape stimulin kryesor te rivitalizimit social ekonomik te jetes komunitare te tre fshatrave te perzgjedhur.</p>
Përgjegjës	Bashkia Tepelenë
Kosto e perafert	170,000,000 leke
Burimet e mundshme te financimit	Qeveria shqiptare;
Veprimet e nevojshme per zbatimin e projektit	Projekti do te ndjeke te gjitha hapat ligjore teknike te parashikuar ne Ligji Nr.107/2014 "Per Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", i ndryshuar, VKM Nr. 686 date 22.11.2017 "Per miratimin e Rregullores se Planifikimit te Territorit", e ndryshuar si dhe VKM Nr.408 "Per Miratimin e Rregullores se Zhvillimit te Territorit" e ndryshuar, dhe konkretisht per hapat ligjore dhe teknike qe duhet te




	ndiqen per miratimin e lejes se zhvillimit, miratimin e lejes se ndertimit si dhe marrjes se çertifikates finale te dorezimit dhe perdonimit te segmenteve te tre rrugeve te perfshira ne projekt.
Tregues i Monitorimit	Finalizimi i projektit te rikonstrukzionit të segmenteve rrugore te propozuara.


SKEDA E PROJEKTIT - 46	
Lloji i Projektit	PILOT
Emri i Projektit	3.1.3.46 Ndertimi i ures se re te Dragotit
Objektivi Strategjik	Objektiv 3.1 – Përmirësimi dhe rikualifikimi i rrjetit te komunikimit te Bashkisë Tepelenë
Vendndodhja	Ne dalje te Grykes se Mezhgoranit, prane fshatit Dragot,
Harta	
Sektori	04 _Çeshtjet Ekonomike
Programi	045_Transporti
Faza	Afatmesem (1 -3 vjet)
Kohezgjatja	3 vjet
Qëllimi kryesor dhe rëndësia	Ura e Dragotit eshe ndërtuar në vitin 1936 nga një kompani italiane nga Genoa, Itali. Aktualisht, eshte ura e vetme qe lidh Rajonin Jug-Perendimor me ate Jug-Lindor. Mbi te kalojne çdo dite nje numer i konsiderueshme mjetesh te tonazheve te ndryshem, ku problem mbeten kamionet e rende te ngarkuar me gure qe vijne nga zona e Permetit. Ka nje gjatesi rrreth 105 metra dhe gjeresi te profilit terthor prej 7 metrash.

	<p>Sipas kushteve teknike te ures, mbi te duhet te kalojne ngarkesa jo me te medha se 24 ton, nderkohe qe raportohet se uren e pershkojne rregullisht kamione me pesha deri ne 60 ton.</p> <p>Ne kontestin e Bashkise Tepelene, ura mundeson komunikimin e automjeteve dhe pasagjereve qe vijnë ne qytet nga fshatrat Mezgoran, Luadh, Peshtan, Dragot dhe Beçisht. Per kete arsy, projekt i propozuar synon qe te garantoje komunikimin e vazhdueshem dhe afatgjate te ketyre fshatrave me qendren e Bashkise.</p> <p>Po ashtu, ndertimi i ures se re do te garantoje sigurine dhe vazhdueshmerine e shkembimeve ekonomike midis Bashkise Tepelene dhe Bashkive Kelcyre, Permet po ashtu edhe Erseke.</p> <p>Duhet marre ne konsiderate fakti qe ndertimi i kesaj ure konceptohet si nje nderhyrje strategjike ne nivel rajonal apo dhe kombtar, pa u kufizuar vetem ne profilin e Strategjise se Bashkise Tepelene.</p>
Përgjegjës	ARRSH
Kosto e perafert	300,000,000 leke
Burimet e mundshme te financimit	Qeveria shqiptare;
Veprimet e nevojshme per zbatimin e projektit	Projekti do te ndjeke te gjitha hapat ligjore teknike te parashikuar ne Ligji Nr.107/2014 "Per Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", i ndryshuar, VKM Nr. 686 date 22.11.2017 "Per miratimin e Rregullores se Planifikimit te Territorit", e ndryshuar si dhe VKM Nr.408 "Per Miratimin e Rregullores se Zhvillimit te Territorit" e ndryshuar, dhe konkretisht per hapat ligjore dhe teknike qe duhet te ndiqen per miratimin e lejes se zhvillimit, miratimin e lejes se ndertimit si dhe marrjes se çertifikates finale te dorezimit dhe perdonimit te ures se re te propozuar ne projekt.
Tregues i Monitorimit	Finalizimi i projektit te ures se re mbi lumin Vjose, prane fshatit Dragot.
SKEDA E PROJEKTIT - 52	
Lloji i Projektit	PILOT
Emri i Projektit	3.2.1.52 Rikonstruksioni i rrjetit te brendshem te furnizimit me uje te fshatrave Lekdush, Progonat dhe Gusmar, Njesia Administrative Kurvelesh
Objektivi Strategjik	Objektiv 3.2 – Permiresimi i rrjetit te furnizimit me ujë në qytetin e Tepelenës dhe në zonat rurale
Vendndodhja	Te 5 fshatrat gjenden ne pllajen e Kurveleshit, pergjate rruges Bençe - Nivice



Harta	
Sektori	06_Strukturat e Strehimit dhe Komunitetit
Programi	063_Furnizimi me Uje
Faza	Afatmesem (1 -3 vjet)
Kohezgjatja	3 vjet
Qëllimi kryesor dhe rëndësia	<p>Per shkak te ecurise demografike negative, rrjetet e ujesjellesve ne 5 fshatrat e Njesise Administrative Kurvelesh nuk jane perballur me kerkesen per zgjerimin e rrjetit apo rritjen e sasise se ujit te furnizuar. Duhet thene se rrjeti ekzistues i furnizimit te fshatrave te krahines eshte i amortizuar dhe arrin te garantoje furnizimin me uje per vetem 2 ore ne dite.</p> <p>Konkretnisht projekti synon ne projektimin dhe ndertimin e pikave te marrjes dhe depozitimit te ujit per:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Pika 1 – fshatrat Nivice, Rexhin dhe Gusmar – pike e furnizimit dhe depo prane perroit te Miroxixes dhe Perroit te Madh - Pika 2 – fshatrat Progonat dhe Lekdush – pike furnizimi dhe depo prane perroit te Shkzes. <p>Pikat e propozuara tё marrjes se ujit si dhe depot kane nje kuote te konsiderueshme nga fshatrat, duke garantuar furnizim me rrjedhje te lire dhe te qendrueshem me uje te te 5 fshatrave. Ndërkohë propozohet rikonstruksioni i plete i rrjetit tё brendshem, duke siguruar nje fluks furnizimi rreth 25% me shume te kapacitetit te nevojshem, kjo per efekt te pritshmerise se rritjes se konsumit ne periudhen turistike te vitit</p> <p>Nje projekt i tille eshte thelbesor ne kontestin e zhvillimit potencial te zones se Kurveleshit si nje zone atraktive per turizmin malor dhe ate te aventures. Eshte praktikisht e pamundur qe te diskutohet per turizem cilesor dhe te qendrueshem nese ka furnizim te kufizuar te ujit.</p>
Përgjegjës	UK sha Tepelenë
Kosto e perafert	250,000,000 leke

Burimet e mundshme te financimit	Qeveria shqiptare;
Veprimet e nevojshme per zbatimin e projektit	Projekti do t� ndjeke te gjitha hapat ligjore teknike te parashikuar ne Ligji Nr.107/2014 "P�r Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", i ndryshuar, VKM Nr. 686 date 22.11.2017 "Per miratimin e Rregullores se Planifikimit te Territorit", e ndryshuar si dhe VKM Nr.408 "Per Miratimin e Rregullores se Zhvillimit te Territorit" e ndryshuar, dhe konkretisht per hapat ligjore dhe teknike qe duhet te ndiqen per miratimin e lejes se zhvillimit, miratimin e lejes se ndertimit si dhe marrjes se certifikates finale te dorezimit dhe perdorimit te 2 rrjeteteve te reja te furnizimit me uje per krahinen e Kurveleshit.
Tregues i Monitorimit	Finalizimi i projektit te rrjeteteve te furnizimit me uje per pese fshatrat e krahines se Kurveleshit

SKEDA E PROJEKTIT - 56	
Lloji i Projektit	PILOT
Emri i Projektit	3.3.1.56 Ndertimi i impiantit te pastrimit te ujerave te zeza urbane te qytetit t� Tepelen�s.
Objektivi Strategjik	Objektivi 3.3 – Permiresimi i rrjetit te kanalizimeve te ujerave n� qytetin e Tepelen�s dhe n� zonat rurale
Vendndodhja	Territori fushor ne veri te qytetit te Tepelenes.
Harta	
Sektori	05_Mbrojtja e Mjedisit
Programi	052_Menaxhimi I Ujrate te Zeza



Faza	Afatmesem (1 -3 vjet)
Kohezgjatja	3 vjet
Qëllimi kryesor dhe rëndësia	<p>Vitet e fundit ne shume zona urbane ne Shqiperi po instalohen impiante te pastrimit te ujerave te zeza, te konsideruara si nje element i domosdoshem i infrastruktures kunder ndotjes mjedisore. Praktikisht, ndertimi i impiantit te pastrimit te ujrave te ndotura urbane eshte detyrim i institucioneve qendrore dhe vendore, bazuar ne Nenin 11, pika 1-d te Ligjt Nr. 9115, date 24.7.2003 "Per Trajtimin Mjedisor te Ujerave Te Ndotura", te ndryshuar.</p> <p>Qellimi i projektit eshte pikerisht ndertimi i infrastruktures se nevojshme te pastrimit te ujerave te ndotura urbane per qytetin e Tepelenes, ne kontekstin e nje nje detyrimi ligjor per institucionin e Bashkise. Pertej ketij detyrimi, projekti ka nje rendesi mjaft te madhe pasi eliminon ndotjen e ujerave te lumiit te Vjoses, I konsideruar si nje nga lumenjte e pakte te eger te Europez.</p> <p>Zona e percaktuar per ndertimin e impiantit eshte ndoshta hapesira e vetme e mundshme prane territorit te qytetit, duke marre ne konsiderate fizionomine e rrjetit ekzistues te kanalizimeve te ujerave te zeza, terrenin e pjerret si dhe ekzistencen e dy trupave ujore qe veprojne si kufi natyror te "gadishullit" te Tepelenes.</p> <p>Normativa mesatare popullsi/siperfaqe impianti, qe eshte konsideruar ne rastin e qytetit te Tepelenes eshte nje 10,000 banore/2-3 Ha. Ne rastin e Tepelenes, zona e propozuar ka hapesiren e nevojshme per ndertimin e ketij impianti. Kjo vlere popullsie perkon me gjendjen ekzistuese demografike si dhe me prognozen e rritjes per 15 vitet ne vazhdim.</p>  <p>Pamje te impiantit te pastrimit te ujerave te ndotura urbane ne Gjirin e Lalezit.</p>
Përgjegjës	Uk sha Tepelenë
Kosto e perafert	300,000,000 leke
Burimet e mundshme te	Qeveria shqiptare;

financimit	
Veprimet e nevojshme per zbatimin e projektit	Projekti do të ndjeke te gjitha hapat ligjore teknike te parashikuar ne Ligji Nr.107/2014 "Per Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", i ndryshuar, VKM Nr. 686 date 22.11.2017 "Per miratimin e Rregullores se Planifikimit te Territorit", e ndryshuar si dhe VKM Nr.408 "Per Miratimin e Rregullores se Zhvillimit te Territorit" e ndryshuardhe konkretisht per hapat ligjore dhe teknike qe duhet te ndiqen per miratimin e lejes se zhvillimit, miratimin e lejes se ndertimit si dhe marrjes se çertifikates finale te dorezimit dhe perdonimit te impiantit te ri te pastrimit te ujerave te zeza te qytetit te Tepelenes.
Tregues i Monitorimit	Finalizimi i projektit dhe venia ne shfrytezim te impiantit te pastrimit te ujerave te zeza te qytetit te Tepelenes.

SKEDA E PROJEKTIT - 60	
Lloji i Projektit	PILOT
Emri i Projektit	3.4.1.60 Ndërtimi i pikës së re qëndrore te depozitimit te mbetjeve
Objektivi Strategjik	Objektiv 3.4 – Përmirësim i sistemit të grumbullimit dhe depozitimit të mbetjeve urbane
Vendndodhja	Ne pjesen veriperendimore te qytetit te Tepelenes, poshte fshatit Veliqot, pergjate grykes se perroit te Turanit.
Harta	
Sektori	05_Mbrojtja e Mjedisit
Programi	051_Menxhimi i Mbetjeve
Faza	Afatmesem (1 -3 vjet)
Kohezgjatja	2 vjet
Qëllimi kryesor dhe rëndësia	Projekti synon ti jape fund ndotjes qe shkaktohet nga dumpsite'i aktual prane lumit te Vjosës, duke ofruar një alternative teknologjike dhe të menaxhuar sipas parametrave teknike. Dumpsite'i aktual i Bashkise Tepelene ka një pozicionim mijtë



	<p>problematik, per shkak te aferise me lumin e Vjosës si dhe te ekspozimit ndaj ererave te forta qe jane karakteristike per gryken e Tepelenes.</p> <p>Projekti propozon ngritjen e nje strukture te re teknologjike, sipas parametrave teknike te pranuar, dhe te mbrojtur nga ererat. Gjithashtu pozicioni i propozuar eshte bere duke u bazuar skemen e kombinuar te grumbullimit te mbetjeve urbane ne te gjithe Bashkine, ne te cilen propozohet ndertimi i pikave tranzitore te depozitimit. Aktualisht Landfilli i propozuar ka nje pozicion qendror ndaj skemes se shperndarjes se pikave tranzitore, duke reduktuar keshtu kostot totale te sherbimit.</p> <p>Perveç elementeve pozitive qe lidhen me skemen e pikave tranzitore, ndertimi i Landfillit te ri do te mundesoje pastrimin dhe rehabilitimin e mevonshem te Dumpsite'it ekzistues, i identifikuar si nje hot-spot mjedisor ne territorin e Bashkise Tepelene.</p>
Përgjegjës	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Mjedisit Bashkia Tepelenë
Kosto e perafert	100,000,000 leke
Burimet e mundshme te financimit	Qeveria shqiptare;
Veprimet e nevojshme per zbatimin e projektit	Projekti do të ndjeke te gjitha hapat ligjore teknike te parashikuar ne Ligji Nr.107/2014 "Per Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", i ndryshuar, VKM Nr. 686 date 22.11.2017 "Per miratimin e Rregullores se Planifikimit te Territorit", e ndryshuar si dhe VKM Nr.408 "Per Miratimin e Rregullores se Zhvillimit te Territorit" e ndryshuar, dhe konkretisht per hapat ligjore dhe teknike qe duhet te ndiqen per miratimin e lejes se zhvillimit, miratimin e lejes se ndertimit si dhe marrjes se çertifikates finale te dorezimit dhe perdonimit te Landfillit te Ri Teknologjik të Bashkise Tepelene.
Tregues i Monitorimit	Finalizimi i projektit dhe venia ne shfrytezim i Landfillit.



SKEDA E PROJEKTIT - 65	
Lloji i Projektit	PILOT
Emri i Projektit	3.5.1.65 Konsolidimi i shkolles 9-vjeçare "Asim Zeneli" në fshatin Progonat
Objektivi Strategjik	Objektiv 3.5 – Ristrukturim i rrjetit të shërbimeve publike ne te gjithe territorin e Bashkise, në koherencë me propozimet strategjike
Vendndodhja	Shkolla ekzistuese 9 vjeçare "Asim Zeneli" ne fshatin Progonat, Njesia Administrative Kurvelesh.



Harta	
Sektori	09_Arsimi
Programi	091_Arsimi baze dhe Parashkollar
Faza	Afatshkurtër (1 vit)
Kohezgjatja	1 vit
